



FAQE 3



FAQE 4




FAQE 4



FAQE 6

Koha

www.koha.mk



KOHA për
enigma

FAQE 11-14

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3225 • E shtunë/e diel 18-19 nëntor 2017

15 DEN



Teatrot shqiptare në gjysmë të rrugës

Shkup, 17 nëntor - Financimi i punimeve për rikonstruktimin e Teatrit Shqiptar të Shkupit dhe për ndërtimin e Teatrit dhe Bibliotekës në Tetovë vazhdojnë të figurojnë si projekte që duhet të realizohen edhe në buxhetin e vitit të ardhshëm. Me të vetmin dallim se, për këto dy projekte, shu-

mat që planifikohen të akordohen për vitin 2018 janë më të mëdha sesa ato të vitit të kaluar. Dallimi është drastik, sidomos për Teatrin e Shkupit, për të cilin Ministria e Kulturës planifikon t'i akordojë 250 milionë denarë, ose 150 milionë më shumë sesa viti i kaluar. Që do të thotë se punimet

për përfundimin e këtij projekti janë në gjysmë të rrugës, po të kihet parasysh kostotja e përgjithshme e deklaruar disa vjet më parë, rreth 500 milionë denarë. Nga Teatri bëjnë me dije se kjo shumë nuk lidhet me likuidimin e faturave të prapambetura, borxheve eventuale...

FAQE 5

Partnerët e koalicionit mbeten të njëjtë

Qeveria afër rikonstruimit



Se në fillim të javës së ardhshme mund të përfundohet gjithçka rreth Qeverisë, flet dhe takimi që kryeministri Zoran Zaev ka mbajtur mbrëmjen e së enjtes me kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti, ndërkaq mbrëmjen e së premtes Zaev është pritur të takohet serish me liderin e ASH-së, Ziadin Sela

FAQE 3

GLABI

Libi, aty ku emigrantët shiten sikurse delet



Në një kamp emigrantësh në Libi ku zhvillohet një ankand i mirëfilltë për blerjen e emigrantëve, sikur në kohërat e tregtisë së sklevërve. Blerësit kërkojnë kryesisht djem të rinj, të fortë e të aftë për të punuar tokën. Dy të rinj shiten për 400 dollarë secili. Ishte rrjeti...

FAQE 17

RAJON

EULEX, misioni i korruptuar evropian

FAQE 16

RAJON

Holandë, mijëra shqiptarë të përfshirë në botën e krimit

FAQE 16

Takimi më 11 dhe 12 dhjetor, i mundshëm kompromisi



Shkup, 17 nëntor - Ndërmjetësi i Kombeve të Bashkuara në bisedimet për çështjen e emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë, Methju Nimic caktoi takim me përfaqësuesit e dy vendeve në Bruksel më 11 dhe 12 dhjetor. "Takimi është pjesë e angazhimeve të KB-së që t'u ndihmohet të dyja palëve të gjejnë zgjidhje

të përbashkët e të pranueshme për çështjen e emrit", thuhet në kumtesën e zyrës së Nimicit. Fillimisht bisedimet u planifikuan për javën e ardhshme, por u anuluan dhe u ricaktuan për në dhjetor. Raundi i ri i bisedimeve vjen në periudhën e klimës së përmirësuar politike midis Maqedonisë dhe Greqisë, si dhe

pritjeve optimiste nga Shkupi, Athina dhe Uashingtoni për t'i dhënë fund kontestit shumëvjeçar. Ndërkohë, kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim Ali Ahmeti ka pritur të enjten mbrëmë në takim kryebashkiakun e Selanikut, Janis Butaris. Ahmeti dhe Butaris kanë diskutuar...

FAQE 2

AKTUALE

UEJL shënon 16 vjetorin



FAQE 9



Nimic caktoi takim e delegacioneve në Bruksel

Takimi më 11 dhe 12 dhjetor, i mundshëm kompromisi

"Takimi i 11 dhe 12 dhjetorit është pjesë e angazhimeve të KB-së që t'u ndihmohet të dyja palëve të gjejnë zgjidhje të përbashkët e të pranueshme për çështjen e emrit", thuhet në kumtesën e zyrës së Nimitit

Shkup, 17 nëntor - Ndërmjetësi i Kombeve të Bashkuara në bisedimet për çështjen e emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë, Methju Nimic caktoi takim me përfaqësuesit e dy vendeve në Bruksel më 11 dhe 12 dhjetor. "Takimi është pjesë e angazhimeve të KB-së që t'u ndihmohet të dyja palëve të gjejnë zgjidhje të përbashkët e të pranueshme për çështjen e emrit", thuhet në kumtesën e zyrës së Nimitit. Fillimisht bisedimet u planifikuan për javën e ardhshme, por u anuluan dhe u ricaktuan për në dhjetor. Raundi i ri i bisedimeve vjen në periudhën e klimës së përmirësuar politike midis Maqedonisë dhe Greqisë, si dhe pritjeve optimiste nga Shkupi, Athina dhe Uashingtoni për t'i dhënë fund kontestit shumëvjeçar. Ndërkohë, kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim Ali Ahmeti ka pritur të enjten mbrëma në takim kryebashkiakun e Selanikut, Janis Butaris. Ahmeti dhe Butaris kanë diskutuar shumë hapur dhe miqësisht për çështje të interesit të ndërsjellë, shkëmbime kulturore, arsimore, bashkëpunim ndërkufitar të komunave por edhe për kontestin e emrit dhe integrimet euroatlantike. "Butaris mbështeti të gjitha idetë për bashkëpunim midis komunave të udhëhequra nga Bashkimi Demokratik për Integrim me Selanikun dhe mirëpriti gatishmërinë e Butaris për ta



MEDIAT GREKE: BUTARIS E QUAJTI "MAQEDONI"

Kryebashkiaku i Selanikut, Janis Butaris gjatë vizitës në Shkup sërish e përdori emrin "Maqedoni", duke emëruar vendin fqinj, komentojnë sot mediat greke. Duke folur në gjuhën angleze para gazetarëve Butaris pas takimit me kryeministrin Zoran Zaev, propozoi takim i ardhshëm i kryeministrave të Greqisë dhe "Maqedonisë" të mbahet në Selanik, theksojnë mediat greke. Përkujtojnë se Butaris edhe gjatë vizitës së vitit të kaluar e ka përdorur emrin Maqedoni në një intervistë për një stacion televiziv. Butaris dje qëndroi në Shkup në suaza të tentimeve për implementim të masave të besimit mes të dy vendeve dhe gjatë kësaj realizoi takim me kryeministrin Zoran Zaev, presidentin Gjorge Ivanov dhe me ministrin e Punëve të Jashtme Nikolla Dimitrov. Mediat greke sot mes të tjerash informojnë edhe për takimin e ndërmjetësuesit të KB-së në negociatat për çështjen e emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë Methju Nimic, i cili është caktuar për më 11-të dhe 12-të dhjetor në Bruksel.

thelluar komunikimin midis qyteteve tona. Ahmeti dhe Butaris diskutuan edhe për integrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE, me ç'rast u pajtuan që duhet të arrihet kompromis për kontestin e emrit sa më shpejt duke respektuar veçoritë e palëve dhe duke men- duar për të ardhmen e përbashkët në familjen euroatlantike", thuhet në njof- timin e BDI-së. Edhe ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë, Nikolla Dimitrov, realizoi

takeim me prefektin e Selanikut Janis Butaris, në të cilin bise- duan për modalitetet për avan- cimin e bashkëpunimit në më shumë fusha, përfshirë edhe atë në nivel lokal. Bashkëbi- seduesit, siç informojnë nga MPJ, janë dakorduar se komu- nikimi mes qytetarëve të të dy vendeve është me rëndësi të jashtëzakonshme në drejtim të përforsimit të besimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Në takim, mes tjerash, është bise- duar edhe për bashkëpunimin

tëjkufitar, si dhe për përdori- min e bashkëveprimi të përforsuar me fokus mbi kul- turën, arsimin dhe organiza- tat joqeveritare. Ky është taki- mi i dytë mes ministrit Dimitrov dhe prefektit Butaris për më pak se dy muaj në të ci- lin i vazhduan bisedimet nga Selaniku, për çështje me inte- res të përbashkët, si dhe për kontributin e mundshëm të autoriteteve lokale në suaza të Masave për ndërtim të besimit dhe afimit të qytetarëve të të dy vendeve, thuhet në kumte- sën e MPJ-së.

Ndryshe, edhe zëvendës- dihmësi i sekretarit amerikan, Hojt Ji javën e kaluar në një debat në Uashington tha se çështja e emrit deri më tani është në nivelin më të lartë dhe më afër gjetjes së zgjidhjes. Shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias, nga ana tjetër, deklaroi se pret çështja të mbyllet në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm, ndërsa kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev, se duhet të bëhet një hap dhe se tani ekzistojnë mundësi më të mëdha se më parë që të gjen- det zgjidhje me Greqinë.

Zaevi për Televizionin Kombëtar Bullgar



Me Bullgarinë nuk jemi vetëm miq, por edhe aleatë

Sofje, 17 nëntor - Me Bullgarinë nuk jemi vetëm miq, por u bëmë edhe aleatë, deklaroi kryeministri Zoran Zaev në një intervistë për Televizionin Kombëtar Bullgar - BTV. "Maqedonia fitoi me Marrëveshjen për fqinjësi të mirë me Bullgarinë, ndërsa nuk humbi asgjë. Ne flasim në gjuhën në të cilën kuptohemi. Vetëm së bashku mund të ndihmohemi mes vete dhe të shkojmë përpara", deklaroi Zaev. Ai tha se edhe Marrëveshja për fqinjësi të mirë dhe miqësi me Bullgarinë do të ratifikohet deri në fund të vitit. Shefi i Qeverisë së Maqedonisë i dha mbështetje të fuqishme Korridorit 8. "Na nevojitet lidhshmëri ekonomike nga Durrësi përmes Shkupit deri në Bullgari", thotë Zaev. Lidhur me çështjet historike të cilat i prekin të dyja vendet, Zaev tha se në tekstet shkollore më nuk flitet për "okupatorin fashist bullgar" dhe se shoqëria e Maqedonisë e ka dënuar shkatërrimin e përmendores së Kajmakalanit pasi që kjo ka shkaktuar vuajtje tek bullgarët. "Personalitet e historisë tonë të përbashkët duhet të na lidhin. Mospajtimet nuk sjellin perspektivë, por sjellin të këqija. Maqedonia dhe Bullgaria janë miq të sinqertë dhe duhet ta ndërtojnë këtë miqësi", potencoi Zaev. Ai theksoi se kurrë më në Republikën e Maqedonisë nuk do të përsëritet kriza politike e cila i ndodhi vendit viteve të fundit kur nuk pati liri, ndërsa shumë persona të pafajshëm u dërguan në burg. "Duam të shohim përpara drejt së ardhmes dhe jo të kthehemi mbrapa", tha Zaev. Ai e tregoi edhe qëndrimin e tij lidhur me kontestin shumëvjeçar me Greqinë me emrin. "Unë jam politikan i cili dëshiron ta zgjidhë problemin me Greqinë për emrin. Me siguri të dyja palët duhet të bëjnë kompromis", theksoi kryeministri Zoran Zaev në intervistën për BTV.

Ligji për shqipen në pajtim me Kushtetutën

Shkup, 16 nëntor - VMRO-DPMNE vazhdon me politikën e ndarjeve dhe izolimit, Ligji për përdorimin e gjuhëve është në pajtim me Kushtetutën, thuhet në reagimin e LSDM-së drejtuar partisë së Gruevskit, e cila së fundmi kërkoi debat publik për Ligjin e shqipes. "Edhe krahas poro-

sisë së qartë nga qytetarët për ndryshime dhe një shoqëri për të gjithë, VMRO vazhdon me politikën e saj të izolimit, ndarje dhe konflikte me çka punojnë kundër interesave të qytetarëve dhe të shtetit. Ndryshimet e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, thuhet më tej, janë në pajtim me Kusht-

tutën e Republikës së Maqedonisë dhe Amendamentin 5 që është sjell para 16 viteve. Përmes këtij Ligji do të avancohet përparimi i të gjitha gjuhëve dhe të gjitha komuniteteve dhe do t'i jepet fund autoriteteve dhe do t'i jepet fund autokracisë dhe kaosit të përdorimit të gjuhëve të komuniteteve joshumicë", shtohet

në kumtesë. Nuk është e saktë, thuhet më tej, se do të vendoset dygjuhësi në tërë territorin, e as se do të dërgo- jë përdorimi dhe pozita kushtetuese e gjuhës maqedonase dhe letra e tij cilike si gjuhë zyrtare në tërë terri- torin dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Lika takoi oficerin politik të BE-së, Antun Herceg

Një shoqëri multietnike, prioritet i Qeverisë

Shkup, 17 nëntor - Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe sistemit politik, Hazbi Lika, të premtën në takim priti Oficerin politik përgjegjës për Ballkanin Perëndimor në shërbim të Bashkimit Evropian, Antun Herceg. Në këtë takim, siç njoftojnë nga zyra për informim e SIMO, oficeri politik Herceg dhe

zëvendëskryeministri Lika diskutuan rreth dinamikës së madhe pas formimit të qeverisë dhe përparimeve të marrëveshjeve bilaterale me shtetet fqinje që janë formuar në përputhshmëri me prioritetet e partinerëve të koalicionit. Her-

ceg theksoi se hapat e para të kësaj strukture qeveritare tregojnë shtytje pozitive për vendin në rrugën evropiane. Zëvendëskryeministri Lika në takim ka theksuar edhe se janë ndërmarrë hapa pozitive drejt konsolidimit të prioritetëve për

të krijuar një shoqëri multietnike, edhe pse, siç sh- ton, ekziston një konglomerat kërkeshash në përpjekje të avancimit të të drejtave të grupeve et- nike që jetojnë në Repu- blikën e Maqedonisë. Bashkëbiseduesit gjithashtu kanë diskutuar rreth pro-

cesit të ligjit për përdori- min e gjuhëve në Kuvend, si një hap konkret i cili gjithashtu është në për- puthje me Analizën e MO- së për kohezion social. "Do të jetë tejet sfiduese periudha e implementimit të këtij ligji, ku njëkohësi- sht do të punohet në kon-

solidimin e dy institucio- neve përgjegjëse për im- plementimin, respektimin dhe mbarëvajtjen e tij", ka theksuar Lika.

Oficeri politik i BE-së përgjegjës për Ballkanin perëndimor, Herceg inkurajoi fuqishëm Likën për vazhdimësinë e reforma- ve qeveritare, në cilat do të ndihmojnë në integri- min e Republikës së Ma- qedonisë në rrugën euroat- lantike.



Se në fillim të javës së ardhshme mund të përfundohet gjithçka rreth Qeverisë, flet dhe takimi që kryeministri Zoran Zaev ka mbajtur mbrëmjen e së enjtes me kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti, ndërkaq mbrëmjen e së premtes Zaev është pritur të takohet serish me liderin e ASH-së, Ziadin Sela

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 17 nëntor - Plotësim i vendeve vakante në Ministrinë pa Resor, Ministrinë e Shëndetësisë dhe zëvendësministër për Arsimi apo do të ketë lëvizje në ministri mes partnerëve të koalicionit LSDM-BDI-Aleanca për Shqiptarët, për këto dy opsione ende nuk asgjë zyrtare deri më tani. Por në rrugë jozyrtare opsioni i dytë duke më i mundur me atë që Ministria e Shëndetësisë ti takojë ose BDI-së, ose LSDM-së, ndërkaq ASH të marrë një tjetër dikaster të rëndësishëm ministror, kjo sipas burimeve anonime partiake të partive në pushtet. Deri më tani pati vonesa që të plotësohen vendet vakante në Qeveri pas fitores së Ramiz Merkos në Strugë, ish-ministër pa Resor i caktuar për tërheqjen e investimeve të huaja, zgjedhjes së ish-ministrit të Shëndetësisë, Arbën Taravari, për kryetar të Gostivarit dhe zgjedhjes së ish-zëvendësministrit të Arsimit, Visar Ganiu për kryetar të Çairit. Se në fillim të javës së ardhshme mund të përfundohet gjithçka rreth qeverisë, flet dhe takimi që kryeministri Zoran Zaev ka mbajtur mbrëmjen e së enjtes me kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti, ndërkaq mbrëmjen e së premtes Zaev është pritur të takohet për së dyti me liderin e ASH-së, Ziadin Sela, kjo sipas burimeve anonime partiake më shumë për të definuar ministrinë që do të marrë partia e Selës. Po sipas këtyre burimeve, deri të hënën mund të ketë edhe takim të përbashkët Zaevi-Ahmeti-Sela për të konfirmuar gjithçka në rreth rikonstruimit të Qeverisë dhe njëkohësisht për të konfirmuar mbështetjen për reformat e nisura të Qeverisë së kryeministrit Zoran

Partnerët e koalicionit mbeten të njëjtë

Qeveria afër rikonstruimit të vogël



Zaev. Ky koalicion do të vazhdojë kështu mes tre partive deri në kohën kur do të vijë në shprehje ndërrimi i emrit të shtetit e që me gjasë - Qeveria mund plotësohet me parti tjera konkretisht - Lëvizjen BESA dhe PDSH-në, pa mos përfshiruar as grupin e deputetëve të pavarur që do të dalin nga koalicioni me VMRO-në. Për këtë opsion ka pasur zëra në opinion se është e më se e mundur të ndodh meqë BE është e interesuar të mos rickiklohen zgjedhjet e parakohshme, ndërkaq për kursin euroatlantik të Qeverisë nevojitet mbështetje e gjerë parlamentare. Ndërkaq nga burime tjera të afërta me ASH-në, gazeta KOAH mere vesh se kjo parti në këmbim të asaj që të lëshojë Shëndetësinë të marrë një ministri tjetër të rëndësishme - atë të Transportit dhe Lidhjeve ose Ministrinë e Ekonomisë. Nga ana tjetër, nga prononcimet e tyre për gazetën KOAH, si Elmi Azir nga ASH dhe Bujar

Osmani nga BDI lënë të kuptohet se rikonstruimi i Qeverisë është opsion i mundur të ndodh këto ditë. "Gjithçka është e hapur për të plotësuar vendet në Qeveri, por ende nuk kemi një vendim përfundimtar, të dyja opsionet janë të mundshme - edhe ai për rikonstruim të Qeverisë", tha Bujar Osmani nga BDI.

Ndërkaq, nënkryetari i ASH-së, Elmi Aziri, tha se deri më tani - kjo parti ende zyrtarisht nuk ka propozuar deri tek kryeministri Zoran Zaev emrin për ministër të Shëndetësisë, ndërsa në pyetjen nëse janë pro rikonstruimit të Qeverisë, Aziri kujtoi deklaratën e kryeministrit Zaev se është i hapur edhe për këtë opsion. "Zyrtarisht ende si parti nuk kemi propozuar deri tek kryeministri emrin për ministër të Shëndetësisë ndonëse Zoran Zev dhe kryetari Sela kanë pasur të njëjtin mendim kur u takuan që Shëndetësia të na takojë përsëri neve si parti. Nëse flasim për rikon-

struim të Qeverisë, atë nuk e përjashtoi as vetë kryeministri Zaev kur tha se është i hapur për këtë opsion", tha Aziri. Pas zgjedhjeve lokale, gjegjësisht pas koalicionit që pati ASH me Lëvizjen BESA, parti kjo që hasi në rezistencë të fortë nga BDI që mos të bëhet pjesë e koalicionit qeveritar pas zgjedhjeve parlamentare të vitit të kaluar, pati konfrontime të ashpra mes BDI-së dhe ASH-së, ndërsa partia e Ahmetit - siç merret vesh, ka kundërshtuar që ASH të vazhdojë të jetë pjesë e Qeverisë dhe që ajo të zëvendësohet me PDSH-në, parti kjo që e mbështeti partinë e Ahmetit në rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale. Mes Ahmetit dhe Zaevit si kompromis duket që është arritur që ASH të mos e marrë Shëndetësinë, por atë ta marrë BDI. Andaj, Zaevi, sipas burimeve partiake, përmendi rikonstruimin e Qeverisë, ndërsa nuk e vuri theksin tek plotësimi i vendeve vakante në Qeveri.



Zhbogar: Maqedonia në drejtim të mirë

Shkup, 17 nëntor - BE shikon me optimizëm në përpjekjet të cilat i bën Qeveria lidhur me problemin të cilin e ka Greqia me emrin e Maqedonisë, theksoi euroambasadori Samuel Zhbogar gjatë vizitës së SPB Shkup. "Atë që në përgjithësi e ndamë është optimizëm se punët po zhvillohen në drejtimin e duhur, se reformat që i presim në vend fillojnë të zbatohen dhe e inkurajojmë Qeverinë të vazhdojë në këtë rrugë. Në muajt e ardhshëm nga ana jonë do ta prezantojmë vizionin për rajonin në vitet dhe dekadat e ardhshme përmes dokumentit strategjik për Ballkanin Perëndimor që kryetari i KE-së Junker e paralajmëroi për në shkurt. Pres nga Qeveria dhe institucionet të tregojnë përkushtim dhe rezultate lidhur me reformat. Nëse këto vizione dhe aktivitetet përputhen shpresojmë se do të shohim rezultate të mira vitin e ardhshëm", tha Zhbogar. Lidhur me mundësinë që bashkësia ndërkombëtare të kryejë presion ndaj Greqisë të lejojë hyrjen e Maqedonisë në NATO nën referencën e përkohshme, ambasadori theksoi se gjithmonë është më mirë çështjet të zgjidhen përmes dialogut të kënaqësisë të të dyja palëve. "Nuk ka zgjidhje kur njëra palë është e kënaqur, ndërsa tjetra nuk është dhe të gjitha kompromiset janë të bazuara në atë se të dyja palët ta pranojnë zgjidhjen. Kjo është mënyra e vetme të vihet deri në zgjidhje afatgjatë. Shohim se kjo është qasja e Qeverisë, përmes takimeve të shpeshta mes ministrave të punëve të jashtme të cilat e përmirësojnë atmosferën dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe besojmë se kjo do të sjellë deri në rezultate të mira", tha euroambasadori Samuel Zhbogar.

Konsensus për reformat e BE-së dhe të NATO-s

Shkup, 17 nëntor - Zëvendëskryetari i Qeverisë përgjegjës për Çështjet Evropiane, Bujar Osmani, pati takim me presidentin e Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov. Në takim, zëvendëskryeministri informoi për vizitën në Bruksel, të realizuar së bashku me ministrin e Punëve të Jashtme,

Nikolla Dimitrov, ku u realizuan takime të rëndësishme me nënkryetaren e Komisionit Evropian dhe përfaqësuesen e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Frederika Moggerini, si dhe me Eurokomesarin për Zgjerim dhe fqinjësi të mirë, Johan Han. Osmani informoi për porosinë e ministrave të

punëve të jashtme të vendeve anëtare të Unionit, të cilët, në mëngjesin e punës në Bruksel "Miqte e Maqedonisë", të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Bullgarisë dhe Suedisë, shprehën gatishmëri për ta ndihmuar Republikën e Maqedonisë në aspiratat e saja evropiane dhe euroatlantike,

thuhet në kumtesë. Në vazhdim, Osmani informoi për paketën e reja reformuese të Qeverisë "Gjashtë dhe Nëntë", të cilat paraqesin rrrumbullaksim të Planit 3-6-9, implementimi i të cilit duhet të sigurojë hapësirë për progres në përafrimin kah Komisioni Evropian.

Shkup, 17 nëntor - Maqedonia është kryesisht shtet partiak dhe ajo praktikisht është rekoardere në Evropë në raport me anëtarësinë partiake, është konkluzion i studimit krahasues për mungesat zgjedhore në vend dhe përvojat në rajon, të përpunuar nga Qendra për monitorim civil. Slobodanka Jovanovska nga Qendra, duke i prezantuar rezultatet nga hulumtimi gjashtëmujor theksoi se në tre partitë kryesore në vend bëjnë pjesë 15,1 për qind e elek-

toratit, që siç theksoi është fenomen në Evropë. Sipas të dhënave të fundit, VMRO-DPMNE ka 170 mijë anëtarë, LSDM 70 mijë, ndërsa BDI rreth 35 mijë anëtarë. Ajo theksoi se partitë më të mëdha evropiane nuk kanë anëtarësi më të madhe se dy për qind të popullatës. Edhe partia ruse Rusia e

Bashkuar, e cila numëron rreth dy milionë anëtarë ka më pak se dy për qind të elektoratit. Në fokus të hulumtimit është edhe financimi i partive politike, vlera e donacioneve, sanksionet, kontrolli i grumbullimit të parave. "I kemi përcjellë kritikën e GREKO dhe ODIHR. Praktikisht tek ne ka rregullativë, por

nuk zbatohet dhe sipas shumë vlerësimeve limiti ngë është i lejuar i donacioneve në Maqedoni është i lartë në krahasim me standardin e popullatës", tha Jovanovska. Në Maqedoni limiti për donacion për person është 3.000 euro, ndërsa për kompani 30 mijë, që duke pasur parasysh rrogën mesatare

vlerësohet si i lartë. Qendra për monitorim civil jep edhe disa rekomandime për atë se si të përmirësohet financimi i partive politike, duke theksuar përvojat nga vendim që janë shembull i mirë. Janë analizuar edhe listat zgjedhore, respektivisht çfarë është ndryshimi mes numrit të votuesve dhe

popullatës. "Dhe këtu kemi fenomen. Kjo distancë në Maqedoni mes votuesve dhe anëtarëve është shumë e vogël diçka mbi dhjetë për qind, ndërsa në vendet e zhvilluara evropiane në Gjermani kjo hapësirë është 28.8 për qind, në Belgjikë 26, në Gjermani 24 për qind", theksoi ajo.

Studime i Qendrës për monitorim civil

Maqedonia, shtet partiak



Kronikë

17 vjeçari vjedh bastoren në Tetovë

Të enjten mbrëma rreth orës 21 një 17 vjeçar nga Tetova, ka kryer vjedhje në një Bastore Sportive në rrugën Strasho Pinxhur. 17 vjeçari, i njohur edhe më herët për vjedhje në disa bastore në Tetovë ka hyrë brenda, e ka shtyrë të punësuarën, ka hapur arkën dhe ka marrë 8750 denarë. Me paratë e marra ka dalë nga bastorja dhe me një person tjetër të panjohur, që e ka pritur jashtë, janë larguar nga vendi. Gjatë ditës së premte, 17 vjeçari do të ftohet në bisedë informative në Sektorin për Punë të Brendshme për të zbardhur vjedhjen e mbrëmshme.

Kafshohet nga qeni 11 vjeçari nga Sllatina

Një 11 vjeçar nga fshati Sllatinë, së bashku me babain e tij 41 vjeçar N.J, të enjten rreth orës 17 e 30 minuta, ka denoncuar se dy orë më parë djali i tij është sulmuar dhe kafshuar nga një qen në rrugën lokale në fshatin Tearcë. Sipas denoncimit, së bashku me tre shokët e tij, ka qenë duke lëvizur në fushën e sportit, kur nga një shtëpi ka dalë një qen dhe i ka shkaktuar lëndime në krahun e djathtë. 11 vjeçari është dërguar në Spital ku i është dhënë ndihmë mjekësore, kurse gjatë ditës pronari i qenit do të ftohet në bisedë informative.

13 aksidente për 24 orë

Një këmbësor është lënduar më rëndë në njërin nga gjithsej 13 aksidentet e regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në pesë aksidente më lehtë janë lënduar 10 persona, ndërsa në shtatë janë shkakuar dëme materiale. Nga MPB informojnë se gjatë ditës së djeshme policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar numër më të madh të kundërvajtjeve. Dymbëdhjetë shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se sa e lejuara dhe dy shoferë të cilët kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe. Shtatë persona janë shkyçur nga komunikacioni, katër shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin para se të përfitojnë të drejtën e drejtimit të automjetit dhe tre shoferë fillestarë. Janë sanksionuar edhe 25 këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugë jashtë kalimit për këmbësorë dhe 10 këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugë në dritë të kuqe të semaforit. Janë sanksionuar 64 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt.

Arrestohen dy shtetas të Shqipërisë

Të enjten mbrëma, rreth orës 20 e 30 minuta, në qendër të Tetovës, janë arrestuar dy shtetas të Shqipërisë, A.F 25 vjeçar nga Librazhdi dhe A.F 22 vjeçar nga Pogradeci. Sipas policisë, ata kanë qëndruar në Tetovë pa asnjë dokument dhe pa e paraqitur qëndrimin e tij. Pas arrestimit, që të dy shtetasit e Shqipërisë janë mbajtur në Policinë e Tetovës, kurse më pas janë dërguar në Njësinë për kriminalitet ndërkufitar, migracion, të huaj dhe riatdhesim, dhe janë depërtuar për në Shqipëri.

Arrestohet personi që kërkohet për kontrabandimin e 20 kg marihuanë

Është arrestuar edhe personi i dytë pas së cilit Prokuroria Publike e Shkupit në mars të këtij viti shtroi padi penale për rishitjen e marihuanës prej Kosovës në Maqedoni. SPB Shkup në mars të këtij viti shtroi padi penale në Prokurorinë e Shkupit kundër M.O.(39) dhe D.I. (65) për vepër të kryer penale "prodhim të paautorizuar dhe lëshimin në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotorpe dhe perkursorëve". Pas kallëzimit penal të parashtruar nga PPTH është dorëzuar edhe i denoncuar i dytë D.I., ndërsa i denoncuar i parë ka qenë i pakapshëm për organet e rendit, kumtoi MPB. Pas masave të ndërmarra me urdhërarrest qendror më 15 nëntor i denoncuar i parë M.O. është gjetur dhe i është dorëzuar Prokurorisë për procedurë të mëtejme. Veprën penale M.O. dhe D.I. e kanë kryer gjatë marsit të vitit 2017 për rishitje të mëtejme. Ata prej një personi nga Kosova e kanë furnizuar dhe e kanë organizuar transportin e drogës narkotike marihuanë në sasi prej rreth 20 kilogramë nga Kosova në Maqedoni. (U.H)

Udhëtimet me aeroplan në Maqedoni



Vizer transportuesi kryesor, Stambolli destinacioni kryesor

Qytetarët e Maqedonisë më së shumti preferojnë të udhëtojnë me kompanitë që ofrojnë çmime të lira që tregojnë pjesëmarrja me më shumë se 70 për qind e Viz Er, Pegasus dhe Germania Flug

Koha | Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 nëntor - Stambolli ka qenë destinacioni kryesor i udhëtarëve që kanë fluturuar nga aeroportet e Shkupit dhe Ohrit në nëntë muajt e parë të këtij viti. Gjithashtu, qytetarët e Maqedonisë më së shumti preferojnë të udhë-

EDHE TETORI ME FLUTURIME REKORD

Të dhënat tregojnë se vetëm në muajin tetor të këtij viti janë transportuar 184.393 udhëtarë që paraqet një rritje prej 21,4 për qind në raport me 151.877 udhëtarë të regjistruar në muajin tetor të vitit të kaluar. Nuk ka ndryshime edhe ndër destinacionet më të preferuara për udhëtim me avion, ku edhe më tej dominon Stambolli.

tojnë me kompanitë që ofrojnë çmime të lira që tregojnë pjesëmarrja me më shumë se 70 për qind e Viz Er, Pegasus dhe Germania Flug në totalin e të gjithë avio-kompanive që ofrojnë udhëtime në Maqedoni. Njëherazi kompania që ofron fluturime të lira në tërë Evropën, Viz Er, ka transportuar gati gjysmën e udhëtarëve në periudhën janar-shtator të vitit 2017.

Nga ana tjetër, me vendosjen e katër linjave nga

aeroporti i Shkupit dhe linjave sezonale nga Ohri në gjysmën e dytë të këtij viti, është rritur dukshëm numri i udhëtarëve. Sipas të dhënave zyrtare të kompanisë TAV, që menaxhon Aeroportet në Shkup "Aleksandri i Madh" dhe "Shën Apostulli dhe Pavli" në Ohër, afër 1.6 milionë udhëtarë kanë udhëtuar përmes aeroportëve të Maqedonisë, ose më saktësisht kanë udhëtuar 1.546.193 pasagjerë në nëntë muajt e parë të këtij

vit. Kjo paraqet një rritje prej 12 për qind në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nëse flasim për fluturimet e avionëve, nga të dyja aeroportet janë realizuar 13.752 fluturime që paraqet një rritje prej 6 për qind në nivel vjetor.

Ekspertët thonë se përkundër krizës ekonomike që ka kapluar të gjithë shtetet e rajonit, megjithatë të dhënat tregojnë se shumica e aeroportëve në Ballkan shënojnë rritje të

Gjykata Penale e Shkupit e pranon aktakuzën për "TNT"

Gruevski do të gjykohet edhe për "Kosmosin"

Përveç dy ish funksionarëve të lartë të shteti, njëherit edhe anëtar të Kryesisë së VMRO-DPMNE-së, për rastin "TNT" pritet të përgjigjen edhe ish kreu i Komunës së Gazi Babës, Toni Trajkovski dhe katër nëpunës të kësaj njësie

Koha | Omer XHAFFERI


Shkup, 17 nëntor - Këshilli Penal pranë Gjykatës Penale të Shkupit, të premten ka njoftuar se aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale Publike, për rastin "TNT", është vlerësuar pozitivisht dhe se e njëjta në periudhën e ardhshme pritet të nënshtrohet procesit gjyqësor. Listen e të akuzuarve kryesor në rastin "TNT", e kryesojnë ish kryeministri Nikolla Gruevski dhe ish ministri i Transportit dhe Çidhjeve, Mile Janakievski. Për rrënimin e jashtëligjshëm të objektit "Kosmos", pronë e



afaristit Fijat Canovski, në bazë të aktakuzës që e ka ngritur PSP-ja, akuzohen shtatë persona. Përveç dy ish funksionarëve të lartë të shteti, njëherit edhe anëtarë të Kryesisë së VMRO-DPMNE-së, për rastin "TNT" pritet të përgjigjen edhe ish kreu i Komunës së Gazi Babës, Toni Trajkovski dhe katër nëpunës të kësaj njësie të bashkëqeverisjes lokale.

Aktakuzës për rastin "TNT", paraprkisht i ka prirë një vendim i Gjykatës së Apelit në Shkup, e cila vendosi që dëshmitë dhe provat që burojnë nga bisedat e përgjimeve të jashtëligjshme, të njohura si "bomba", të mund të pranohen si dëshmi në procedurë gjyqësore. Ish kryeministri, Nikolla Gruevski, rendit si i akuzuari i parë, pasi që dyshohet se është

urdhëruesi kyç për rrënimin e objektit "Kosmos", qëllimi i të cilës ishte hakmarrja ndaj deputeti të atëhershëm Canovski, për largim nga koalicioni me VMRO-DPMNE-në. Përmblajtja e aktakuzës, e përpiluar dhe përgatitur nga PSP-ja, thekson se rasti "TNT", ka të bëjë për një "përplasje kriminale, ne rrelacion pushtet qendror-lokal, e cila ka funksio-



vazhdueshme të numrit të udhëtarëve si rrjedhojë e zgjerimit të destinacioneve të reja, hyrjes së më shumë avio-kompanive të reja dhe ofertave atraktive për fluturime. Vlerësohet se liberalizimi i vizave për shumicën e shteteve të rajonit, rritja e madhe e mërgimit nga vendet e Ballkanit në shtetet perëndimore, ardhja e kompanive që ofrojnë çmime prej 50 deri 100 euro për vajtje –ardhje, por edhe ardhja e madhe e turistëve të huaj, që përfshijnë vizitat e disa shteteve të rajonit ka rritur dukshëm në vitet e fundit numrin e udhëtarëve në të gjitha aeroportet në rajon.

“Në nëntë muajt e parë të këtij viti, destinacioni më frekuentues nga Aeroporti i Shkupit ka qenë Stambolli me 12.4 për qind, Cyrihu me 8.7 për qind, Vjena me 6.8 për qind, Bazeli me 5.1 për qind, Malme me 4.6 për qind dhe Londra me 3.9 për qind”, tregojnë statistikët e TAV për transportin e udhëtarëve në nëntë muajt e parë të vitit 2017.

Lidhur me pjesëmarrjen e avio-kompanive në transportin e udhëtarëve, Viz Er, ka transportuar më shumë se gjysmën e udhëtarëve, ose 57.5 për qind në totalin e udhëtimeve, pasojnë Turkish Airlines me 8,5 për qind, Austrian Airlines me 6,8 për qind, Germania Flug me 5,1 për qind dhe Pegasus Airlines me 4,5 për qind.

Vlen të theksohet se Aeroporti i Shkupit, sivjet si muaj më të frekuentuar nga udhëtarët e kishte gushtin. Në këtë muaj, aeroporti kryesor në Maqedoni, ka ofruar shërbimet e tij për 216.409 udhëtarë që paraqet një rritje prej 23,7 për qind në trafikun ajror dhe rritje prej 22.4 për qind në numrin e fluturimeve, duke arritur shifra rekordi të trafikut që është ndihmuar edhe nga ngjarja e madhe sportive, mbajtja e Super-kupës së UEFA -së ndërmjet Real Madridit dhe Manchester Junajtdit në arenën sportive “Filipi i Dytë”, që e vizituan tifozë të shumtë nga Spanja, Anglia si dhe nga shtetet e tjera. Dita e shtatë gushtit apo e hëna, ishte dita më frekuentuese në Aeroportin e Shkupit në nëntë muajt e parë të këtij viti, me ç’rast janë transportuar 8.283 udhëtarë me 98 fluturime. Sivjet janë vendosur edhe pesë linja të reja ajrore nga Shkupi. Në prill filloi të linja e re deri në Budapest, ndërsa gjatë muajit korrik u vendosën edhe linjat për në Romë, Maltë, Vaksjo dhe Doha. Në Aeroportin e Ohrit, si destinacion i ri u vendos aeroporti Katowice, me çka edhe u hap rruga për ardhjen më të madhe në Maqedoni edhe të turistëve polak.

nuar në mënyrë efikase për plotësimin e dëshirave të urdhëruesit, ndryshe ish kryeministri të Maqedonisë”.

Nga ana tjetër, vendimi i Gjykatës së Apelit që bombat për “TNT” të përdoren në proces gjyqësor, nënkupton se në seancat gjyqësore për këtë lëndë të PSP-së, pritet të lëshohen edhe 26 biseda nga përcjellja e komunikimeve të jashtëligjshme. Ndryshe, në njërin prej bisedave të publikuara nga LSDM-ja në shkurt të vitit 2015-të, ish kryeministri Gruevski, dëgjohej se si i propozon ish ministrit të Transportit dhe Lidhjeve, Janakievskit, ndryshimin e Planit detar urbanistik, me qëllim arritjen e synimit që lidhen me objektin tashmë të rrënuar “Kosmos”. Mes tjerash, në bisedat e publikuar për këtë rast, opinioni pati mundësi të dëgjojë se të akuzuarit kryesor koketojnë me këtë çështje dhe ndryshojnë mendimet, për që në fund të vendosin ndryshimin e Planit gjeneral urbanistik. Njëkohësisht, në njërin prej “bombave” të LSDM-së, i akuzuari Nikola Gruevski, dëgjohej se si sugjeron se në cilën ditë të bëhet rrënimi i objektit të kontestuar nga ana e tyre, gjegjësisht vendimi final mbetet që kjo ditë të jetë, menjëherë pas zgjedhjes së Qeverisë së re. Megjithatë, ai edhe kësaj radhe e ndryshon mendimi dhe urdhrin final për rrënimin e “Kosmosit” e jep që të bëhet në kohë të pushimeve veror, respektivisht me 1 gusht të viti 2011. Në këto biseda, krahas revanshizmit politik, shihet ndikimi i pushtetit ekzekutiv ndaj atij gjyqësor, me çka pasi ish ministrit Janakievski i parashtron dilemën se ekziston mundësi që gjykata ta ndalojë këtë procedurë, kryetari aktual i VMRO-DPMNE-së, dëgjohej duke i sugjeruar bashkë-partiakut të tij që të lajmërohet në “gjykatën më të lartë”.

Megjithëse shtohen fondet për projektet shqiptare

Teatrot shqiptare në gjysmë të rrugës

Dallimi është drastik, sidomos për Teatrin e Shkupit, për të cilin Ministria e Kulturës planifikon t’i akordojë 250 milionë denarë, ose 150 milionë më shumë sesa viti i kaluar. Që do të thotë se punimet për përfundimin e këtij projekti janë në gjysmë të rrugës, po të kihet parasysh kostoja e përgjithshme e deklaruar disa vjet më parë, rreth 500 milionë denarë. Nga Teatri bëjnë me dije se kjo shumë nuk lidhet me likuidimin e faturave të prapambetura, borxheve eventuale, apo punimeve ndërtimore, por me kompletimin e këtij projekti me pajisjet dhe orenditë

Koha **Evis HALILI**

Shkup, 17 nëntor - Financimi i punimeve për rikonstruktimin e Teatrit Shqiptar të Shkupit dhe për ndërtimin e Teatrit dhe Bibliotekës në Tetovë vazhdojnë të figurojnë si projekte që duhet të realizohen edhe në buxhetin e vitit të ardhshëm. Me të vetmin dallim se, për këto dy projekte, shumat që planifikohen të akordohen për vitin 2018 janë më të mëdha sesa ato të vitit të kaluar. Dallimi është drastik, sidomos për Teatrin e Shkupit, për të cilin Ministria e Kulturës planifikon t’i akordojë 250 milionë denarë, ose 150 milionë më shumë sesa viti i kaluar. Që do të thotë se punimet për përfundimin e këtij projekti janë në gjysmë të rrugës, po të kihet parasysh kostoja e përgjithshme e deklaruar disa vjet më parë, rreth 500 milionë denarë. Nga Teatri bëjnë me dije se kjo shumë nuk lidhet me likuidimin e faturave të prapambetura, borxheve eventuale, apo edhe punime ndërtimore, por me kompletimin e teatrit, arredimin me pajisje, orendi e të tjera. Pjesa më e madhe e kësaj shume do të përdoret për të blerë pajisjet, orenditë,



montimin e skenës, e të tjera. Por përfundimi i punimeve që zgjat prej gati katër vitesh (filloi në vitin 2014) do të varet edhe nga realizimi i mjeteve financiare. Shumat me të cilat Ministria e Kulturës ka mbështetur çdo vit këtë projekt kanë qenë thaujse të njëjta, çdo vit 80 milionë denarë, me përjashtim të vitit të kaluar, kur iu akorduan 100 milionë denarë. Pavarësisht buxhetit që i është ndarë këtij projek-

ti, ashtu si edhe atij për Teatrin në Tetovë, buxheti i akorduar është tërhequr sërish në muajin qershor. Nëse Ministria e Kulturës është arsyetuar me disakordanca mes buxhetit të planifikuar dhe punimeve të realizuara, teatrot janë justifikuar me pengesa teknike dhe komplikime të paplanifikuara. Qerthulli i justifikimeve ka vazhduar pa u mbajtur asnjë lloj përgjegjësie për afatet e

përfundimit të projekteve që janë shkëlur duke tejkaluar çdo tolerancë të arsyeshme kohore. Teatri dhe Biblioteka e Tetovës këtë vit do të marrë po ashtu 250 milionë denarë - shumë kjo që është 70 milionë denarë më e madhe se një vit më parë (180 milionë denarë vitin e kaluar). Të hollat do të përdoren për të vijuar me punimet përgjithërisht të ngritjen e godinës, ndërtimi i së cilës është në fazat fillestare. Nuk dihet nëse paratë e dedikuara do të shfrytëzohen deri në fund, ose në mesin e vitit të ardhshëm do të kthehen mbrapsht në arkën e shtetit. Sa i takon financimit të aktiviteteve në dy institucione të tjera që lidhen me kulturën dhe trashëgiminë shqiptare - nuk ka ndonjë ndryshim të madh në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Qendra Konservatore e Gostivarit do të ketë në dispozicion 3.900.000 denarë, ndërsa Muzeu i Alfabetit në Manastir 2.600.000 denarë. Buxheti për Muzeun është reduktuar, vitin e kaluar ishte gati tre milionë denarë. Por nëse për rikonstruktimin e këtij objekti Ministria e Kulturës nuk do të ndajë të holla, pas grantit të miratuar nga fondet IPA për këtë qëllim, në buxhet mesa duket nuk është bërë asnjë planifikim për shpenzimet shtesë, pagimin e qerasë për katin e parë, ose blerjen e tyre.



“Buxheti për Muzeun është reduktuar, vitin e kaluar ishte gati tre milionë denarë. Por nëse për rikonstruktimin e këtij objekti Ministria e Kulturës nuk do të ndajë të holla, pas grantit të miratuar nga fondet IPA për këtë qëllim, në buxhet mesa duket nuk është bërë asnjë planifikim për shpenzimet shtesë, pagimin e qerasë për katin e parë, ose blerjen e tyre

Hapa përpara që të bëhemi kampionë klimatik

Shkup, 17 nëntor - Zëvendësministri i Mjedisit të Jetesës dhe Planifikimit Hapësinor Jani Makraduli në sesionin plenar të pasdites të Konferencës së 23-të të Palëve të UNFCCC (COP 23), informoi për përparimin e Maqedonisë në drejtim të zbatimit të Marrëveshjes së Parisit për klimën. Makraduli, siç informojnë nga Kabineti i tij, ka thënë se Maqedonia para dhjetë viteve e ka ratifikuar Marrëveshjen e Parisit dhe se

me përkushtim bashkëngjitet në përpjekjet globale për ballafaqim me ndryshimet klimatike dhe për mundësimin të rritjes dhe zhvillimit të karbonit të ulët. “Jemi të angazhuar për #AksionKlimatik# Por, duhet të gjejmë mekanizëm për mbështetje financiare shtesë me qëllim që t’i zbatojmë aktivitetet të cilat janë planifikuar në dokumentet tona strategjike për ndryshimet klimatike. Si një vend i vogël i vendosur në

Ballkan, me të ardhura të mesme, nuk kemi qasje në më shumë burime. Kjo duhet të merret parasysh, veçanërisht nga Fondi i Gjellbër i Klimës”, tha Makraduli. Pa zbatim, theksoi Makraduli, ratifikimi do të mbetet vetëm votim i thjeshtë. Theksoi se kryeqyteti i Maqedonisë është njëri ndër qytetet më të ndotura dhe se ekziston lidhshmëri e fuqishme mes ndotjes së ajrit dhe ndryshimeve klimatike.





Problemi i lekturave shkollore është kthyer prej vitesh në një shqetësim të madh të mësimdhënësve, por jo edhe të institucioneve kompetente. Shkollat nuk kanë njohur furnizim të bibliotekave, të paktën gjatë 10 viteve të fundit, ndërsa lista me titujt e lekturave shkollore nuk është ndryshuar gati 30 vjet

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 17 nëntor - Mungesa e lekturave dhe librave artistik nëpër bibliotekat e shkollave është alarmante prej shumë vitesh, ndërsa mos ndryshimi i gjendjes, sipas mësimdhënësve të letërsisë, ndikon drejtpërdrejtë në demotivimin e nxënësve për letërsinë. "Prej vitesh është shuar pasioni i nxënësve për të lexuar libra që shkojnë përtej mësimave të detyrueshme të shkollës", thotë Rajmonda Asani, arsimtare në Shkollën Fillore "Panajot Ginovski" në Shkup.

Por, e keqja më e madhe është se nëpër biblioteka mungojnë edhe titujt e atyre lekturave të cilat duhet t'i punojmë me nxënësit, sipas plan programit mësimor me të cilin punojmë, sqaron më tej ajo. Për probleme të kësaj natyre, flasin edhe nëpër shkolla të tjera, kurse arsimtarët e gjuhës dhe letërsisë janë të detyruar shpesh herë të devijojnë prej programit mësimor, pasi në bibliotekën e shkollës nuk gjenden lekturat që ata duhet t'i pu-



nojnë me nxënësit. Kështu, në Shkollën Fillore "Hasan Prishtina", vetëm një e treta e nxënësve kishin lexuar lekturën pasi në bibliotekën e shkollës ishin vetëm tetë libra.

Arsimtarët e gjuhës janë të bindur se "nxënësit nuk lexojnë lekturat jo vetëm sepse nuk janë brenda shijeve të tyre artistike, por edhe sepse në shkollë nuk ka lektura".

Për këtë realitet dëshpërues tregon edhe arsimtarja Fitore Çirezi. Vitin që shkoi, ajo pohon se "vetëm tetë nxënës kishin lexuar lekturën e paraparë për kohën e pushimeve dimërore, mes dy gjysmë vjetorëve. Jo që kishte munguar interesimi i nxënësve, jo që neve arsimtarët nuk i angazhojmë nxënësit, por sepse kishin munguar lekturat në shkollë. Ky është

i gjithë problemi", thotë ajo, duke nënvizuar se mungesa e librave në bibliotekat e shkollave ka dëmtuar shumë rëndë pasionin për lexim, por edhe nivelin e njohurive të nxënësve nga letërsia.

"Që të lexojnë lekturën vetëm tetë nxënës në gjithë gjeneratën, pra në katër paralele, kjo është e frikshme për rolin që duhet të luajë shkolla në nxitjen e

shprehisë për leximin e veprave artistike tek nxënësit. Nëse jo shkolla kush tjetër duhet ta luajë këtë rol", shprehet Çirezi. Ajo, shpjegon se, sipas Programit mësimor që harton Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) çdo vit për shkollat fillore dhe të mesme, me nxënësit e kasave të gjashta arsimtarët e gjuhës duhet të zhvillojnë secilin muaj orë letrare, pra të bëjnë analizën e një lekture nga një autor i caktuar. Caktimi i lekturave që duhet të lexohen është gjithashtu problem në neve, pasi jo çdo herë lloji i letërsisë që caktohet me program është në harmoni me shijet dhe kërkesat e nxënësve. Arsimtarët, shpesh herë në përgjegjësinë e tyre profesionale marrin guximin të devijojnë programin dhe të kërkojnë nga nxënësit leximin autorëve dhe lekturave tjera. Mirëpo, edhe në këto raste është e pamundur që gjërat të ecin mbarë. Menjëherë del problemi i mungesës së librave. Edhe nëse gjenden lekturat "Zemër" nga Edmond De Amiçis, "Zogu

dhe kulla" nga Rrahman Dede apo "Sarajet e bardha" nga Vehbi Kika, numri i librave është tejet i limituar, me nga tetë, dymbëdhjetë apo e shumta njëzet libra për secilin libër. Një gjeneratë nxënësish, ka mesatarisht 120 nxënës. Në rastin konkret, në SHF "Hasan Prishtina", janë katër paralele të klasave të VI, që do të thotë se as të mbledhura bashkërisht librat e Amiçis, Dedes dhe Kikës përsëri nuk sigurojnë fond të mjaftueshëm librash për të gjithë nxënësit e klasave VI të asaj shkolle. Shpesh herë, shpëtimi kërkohet të gjendet te bibliotekat e qytetit. Por, edhe këtu gjendja nuk është më e mirë se sa në bibliotekat e shkollave. Problemi i lekturave shkollore është kthyer prej vitesh në një shqetësim të madh të mësimdhënësve, por jo edhe të institucioneve kompetente, Ministrisë dhe Byrosë. Shkollat nuk kanë njohur furnizim të bibliotekave të paktën gjatë 10 viteve të fundit, ndërsa lista me titujt e lekturave shkollore nuk është ndryshuar gati 30 vjet.

Mungojnë lekturat e shkollave

Bibliotekat e varfra shuajnë pasionin për letërsinë

Analfabetizmi, një dukuri shqetësuese

Brengos komuniteti rom

Sipas regjistrimit të fundit të popullatës të vitit 2002, 3.6 për qind e popullatës së Maqedonisë të moshës mbi 15 vjet janë analfabetë. Përqindje më të vogël të analfabetizmit sipas këtyre të dhënave, kanë pasur maqedonasit edhe atë 2.3%, ndërsa më të lartë romët, madje 20.6% prej tyre

Koha Aida XHONI

Shkup, 17 nëntor - Analfabetizmi ka kohë që është shndërruar si problem edhe në Maqedoni. Në shekullin 21, të flasësh për analfabetizëm, është vërtetë e çuditshme. Por, sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror për Statistikë të Republikës së Maqedonisë, që janë të vjetra që nga regjistrimi i vitit 2002, tek ne ka 1.693.044 qytetarë të shkolluar dhe 635.562 të pashkolluar (analfabetë).

Nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), na thanë se nuk posedojnë të dhëna për numrin e

KOMUNA	BANORË	TË SHKOLLUAR	NALFABETË
Haraçinë	11.597	8440	521
Bogovinë	28.997	23.049	990
Bërvenicë	15.855	12.791	504
Butel	36.154	30.672	686
Gazi Baba	72.617	61.156	1966
Gjorçe Petrov	41.634	36.308	594
Gostivar	81.042	66.235	2311
Dibër	19.542	15.736	450
Dollnen	13.568	10.480	815
Zhelinë	24.390	18.619	807
Zelenikovë	4077	3321	161
Kërçovë	67.053	54.103	2749
Kumanovë	10.5484	86.677	4177
Likovë	27.058	20.359	825
Saraj	35.408	27.394	1244
Strugë	63.376	51.299	1621
Studenica	17.246	12.711	938
Tearcë	22.454	18.343	952
Tetovë	86.850	69.922	3065
Çair	64.773	52.241	2386
Shuto Orizarë	22.017	15.890	1809
Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës			

personave që janë jashtë procesit arsimor, por se duhet të bazohemi në dhënat e fundit të ESHS-së. Zëdhënësi i MASH-it, Vladimir Dellov, në prononcim për Gazetën KOHA, thotë se MASH-i bën përpjekje të vazhdueshme, ndaj dhe ligjërisht arsimimi fillor dhe i

mesëm është obligativ për qytetarët e Maqedonisë. "Ju informojmë se në drejtim të ngritjes së arsimimit të popullatës, shkollimi fillor dhe i mesëm në Republikën e Maqedonisë, në pajtueshmëri me dispozitat pozitive ligjore, është i domosdoshëm. Në drejtim të përfshirjes së

ANALFABETIZMI NË RAJON DHE BOTË

NË KOSOVË, sipas regjistrimit të popullsisë (2011), janë evidentuar gjithësisë 55001 persona që nuk dinë shkrim-lexim e që përbënë 3.2% të numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe 3.9% të grupmoshave mbi 10 vjet.

NË SHQIPËRI: Analfabetizmi vazhdon të jetë një shqetësim për shoqërinë shqiptare. Sipas Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, shifrat e analfabetizmit lëvizin nga 2 për qind e popullsisë, deri në 10 për qind, sipas shifrave të pavarura.

NË BOTË: Sipas të dhënave të UNESCO, rreth 775 milionë persona të rritur në planet, nuk kanë as minimumin e nivelit të shkollimit, 1 në 5 persona të rritur janë analfabet, nga të cilët 2/3 janë femra. Rreth 75 milionë fëmijë nuk vijnë shkollimin, nuk ndjekin rregullisht shkollimin ose e kanë braktisur tërësisht atë.

përgjithshme, të gjitha janë falas (janë siguruar libra falas si dhe transport për nxënësit që jetojnë më larg se 2.5 kilometra nga shkolla ku ndjekin mësimin). Gjithsesi, ekzistojnë masa në pjesën e përkrahjes së personave të rritur, të cilët për shkak të ndryshme, në të kaluarën nuk e kanë ndjekur procesin arsimor, realizohen programe për arsim të rritur, të cilat në vazhdimësi i realizon Qendra për arsimin e të rriturve", tha Dellov. Nga Qendra për arsimin e të rriturve thonë se për momentin, mbi 3000 të rritur janë duke ndjekur arsimim të mesëm.

"Në periudhën prej vitit

2010 deri në vitin 2017, në arsimimin e mesëm janë përfshirë 1782 nxënës, kurse në mënyrë të suksesshme atë e kanë kryer 1435 individë. Në arsim të mesëm për të rritur janë përfshirë 347 nxënës. Në vitin 2017 kanë filluar arsimin e mesëm 1242 nxënës të rinj që do të thotë janë gjithsej 3042 nxënës", tha Lindita Qazimi, drejtore e Qendrës së Arsimit të të rriturve.

Të dhënat e kësaj qendre, gjithashtu konfirmojnë se prej numrit të përgjithshëm të papunëve në Maqedoni që është mbi 23%, për momentin në Maqedoni figurojnë 3719 persona pa punë që nuk

kanë asnjë ditë shkollim, ndërsa edhe 9394 persona të cilët e kanë lënë në gjysmë arsimin fillor. Sipas regjistrimit të fundit të popullatës të vitit 2002, 3.6 për qind e popullatës së Maqedonisë të moshës mbi 15 vjet janë analfabetë, përqindje më të vogël të analfabetizmit sipas këtyre të dhënave kanë pasur maqedonasit, edhe atë 2.3%, ndërsa më të lartë romët të cilët janë deklaruar analfabet madje 20.6% prej tyre.

Sa u përket komunave me shumicë shqiptare, gjendja qëndron si në vijim (bazuar në regjistrimin e vitit 2002, të dhëna nga Enti Shtetëror i Statistikës së Maqedonisë.)



Fillon iniciativa qytetare "Stop për përmbauesit"

Kush po e rrit borxhin e qytetarëve!

Konfederata e organizatave qytetare në Maqedoni dhe Shoqata "No Pasaran" e "Zëri i Tekstilit" fillojnë me fushatën e mbledhjes së nënshkrimeve të qytetarëve kundër veprimeve të përmbauesve ndaj qytetarëve, të cilët gjatë kohës me dhunë po paguajnë borxhet e mbetura ndaj kreditorëve, por assesit t'i paguajnë këto borxhet



Koha Zejnulla VESEL

Shkup, 17 nëntor - Nga sot (e shtunë), me iniciativë të Konfederatës së organizatave qytetare në Maqedoni dhe Shoqatën "No Pasaran" e "Zëri i tekstilit", fillojnë me fushatën e mbledhjes së nënshkrimeve të qytetarëve kundër veprimeve të përmbauesve ndaj qytetarëve, të cilët gjatë kohës me dhunë po paguajnë borxhet e mbetura ndaj kreditorëve, por assesit t'i paguajnë këto borxhet. Konfederata e organizatave qytetare kërkon që përmbauesit të punojnë në gjyq dhe urgjentisht institucionet përkatëse të propozojnë ndryshimin e Ligjit për përmbaimit dhe të "ngrijnë" të gjitha urdhëresat aktive që janë lëndë përmbaimit ndaj personave fizik. Mënyra se si kanë funksionuar deri më sot përmbauesit, sipas organizatave qytetare, nuk është në pajtim me Ligjin për përmbaimit, prandaj është më se nevojshme një revizion i punës së deritanishme të të gjithë përmbauesve si dhe të gjitha proceseve gjyqësore gjatë zbatimit të procedurave përmbauese. "Mbi 200.000 qytetarë janë pengë i vendimeve të përmbauesve dhe një pjesë e këtyre qytetarëve ende i kanë të bllokuara llogaritë bankare me urdhër të përmbauesve. Një numër i konsiderueshëm i këtyre qytetarëve, nuk kanë asfale të hyrash në llogaritë bankare. Kemi raste të shumta ku përmbauesit kanë bllokuar edhe qytetarë, të cilët si të hyra të vetme kanë ndihmat sociale apo

pranojnë kompensime nga Agjencia për punësim dhe vlerësojnë se ky veprim është kundër ligjor. Ligji për përmbaimit është shumë i qartë, përmbauesi ka të drejtë t'i merr borxhliut vetëm një të tretën e të hyrave në llogarinë bankare, ndërsa përmbauesit ju kanë marrë rrogën e plotë, pensionin apo ndihmën sociale tre, katër apo pesë muaj radhazi. Me këtë qytetarët jo vetëm që nuk kanë para për të paguar borxhin, por kanë pasur dhe vështirësi të mëdha sa i përket sigurimit të gjërave ushqimore brenda një muaji", thotë Ana Gligorova nga iniciativa qytetare për mbledhjen e nënshkrimeve "Stop për përmbauesit". Sipas Gligorovës, përmes iniciativës për grumbullimin e nënshkrimeve të qytetarëve, kërkohet të dihet saktë sa është vlera reale e borxhit prej 2000 denarëve, i cili sipas përmbauesve rritet dhe bëhet borxhi jo i realtë në vlerë prej 20.000 denarë.

"Këto 18.000 denarë të llogaritura si borxh shtesë nga përmbauesit shkojnë në "erë", gjegjësisht me këtë jo vetëm që qytetari ka paguar borxhin bazë, por qytetarët e Maqedonisë nuk kanë më asnjë borxh. Prandaj, zgjidhja më e mirë do të ishte që përmbauesit të kthehen atje ku dhe ishin para vitit 2006, si nëpunës shtetërorë në gjykatë. Kërkojmë që deputetët të jenë anën e qytetarëve. Ata janë bërë deputetë me votat e qytetarëve dhe e kanë për obligim t'i mbrojnë qytetarët që t'i shpëtojnë nga ky problem serioz që kanë", tha Ana Gligorova, nga iniciativa qytetare "Stop për përmbauesit".

Kryetari i Konfederatës

së organizatave sindikale në Maqedoni, Marjan Petreski, thotë se të shtunën (sot) para "Porta Maqedonia" në Shkup, nga ora 12 do të fillojmë me grumbullimin e nënshkrimeve dhe nënshkrimet do të grumbullohen edhe në qytete tjera të Maqedonisë. "Shpresojmë se Qeveria e re do të mbajë premtimet e saja të dhëna para se të vjen në pushtet, se këto padrejtësi që u bëhen qytetarëve nga ana e përmbauesve dhe noterëve, do të përmirësohen", tha Petreski. Nga Oda e Përmbauesve të Maqedonisë thonë se sa i përket kërkesës për uljen e tarifës së përmbauesve nga ana e organizatave qytetare, përmbauesit në Maqedoni kanë tarifa më të ulëta nga vendet e rajonit. "Tarifa e përmbaimit është e krijuar në bazë të numrit të përmbauesve dhe të punësuarve në të gjitha zyrat e përmbauesve. Taksa administrative më e ulët e një përmbauesi është 4.5 euro, ndërsa më e larta është 150 euro.

Në anën tjetër, taksa më e ulët e një avokati është 1300 denarë, ndërsa më e larta është 48.000 denarë. Pra, nuk janë taksat e përmbauesve që e rrisin vlerën e borxhit bazë, por janë taksat e avokatëve dhe notareve që janë për disa herë më të larta se taksat administrative të përmbauesve", thotë Zoran Dimov, kryetar i Odës së Përmbauesve të Maqedonisë.

Ndërkaq, sa i përket kërkesës që përmbauesit të kthehen në gjyq, kryetari Dimov thotë se derisa përmbauesit punonin në kuadër të gjykatave, përmbaimit ishte vetëm 2 për qind. "Pas shumë reforma të pasuk-

sesshme në fushën e përmbaimit, në vitin 2005 u miratua Ligji i ri për përmbaimit, i cili gjatë këtyre 9 viteve tregoi rezultate të mira në fushën e përmbaimit dhe përmbaimit i lëndëve është rritur për 48 për qind nga 2 për qind sa ishte në vitin 2005. Gjithashtu, qytetarët duhet të dinë se në tarifën e përmbauesve nuk janë të llogaritura vetëm harxhimet që i bën një përmbaues, por këtu përfshihen edhe harxhimet e avokatit të angazhuar nga ana e kreditorit, të cilat për një seancë gjyqësore kanë koston deri më 16.000 denarë si dhe shpenzimet e noterit. Pra, nuk janë harxhimet e përmbauesve që e rrisin vlerën e borxhit bazë, por janë harxhimet e avokatëve dhe noterëve që e çojnë borxhin bazë të rritet për 10 herë," thotë Dimov.

Njëherit kryetari i Odës së Përmbauesve, Dimov, informon që në të ardhmen të mos ketë keqpërdorime nga ana e përmbauesve, sa i përket bllokimit të llogarive bankare të personave fizik dhe t'ju merret e gjitha rroga në vend se një të treta, siç parasheh ligji, kemi kërkuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të përgatis regjistër me numrin e saktë të personave fizik që janë bartës të ndihmave sociale. "Me përpilimin e këtij regjistri, do të dihet saktë se sa është numri i qytetarëve që janë pranues të ndihmave sociale dhe para se një përmbaues të merr veprim për bllokim të llogarisë bankare, do të duhet të bëjë kontroll nëse personi fizik është bartës i ndihmës sociale dhe nëse ky person është rast social, asnjë përmbaues nuk do të ketë të drejtë t'i bllokojë llogarinë bankare deri në momentin kur ky person do të ndryshojë statusin e bartësit të ndihmës sociale. Në anën tjetër, nëse një person si të hyra në llogarinë bankare ka vetëm pagën mujore, me Ligjin e ri për përmbaimit, ata janë të mbrojtur dhe përmbauesi do të mund të tërheq vetëm një të tretën e rrogës e jo të gjithë rrogën siç ka ndodhur deri më sot", thotë Zoran Dimov, kryetar i Odës së Përmbauesve të Maqedonisë.

Kronikë

Rrihet një nxënës në stacionin e autobusit tek Banka Popullore

Një nxënës 16-vjeçar është rrahur në stacionin e autobusit në afërsi të Bankës Popullore të RM-së. Siç është theksuar në buletin e policisë, babai i nxënësit dje në orën 15:30 në polici ka denoncuar se rreth orës 13:00, djali i tij 16-vjeçar nga fshati Pobožhje i Shkupit, nxënës në shkollën e mesme, derisa ka qenë duke pritur në stacionin e autobusit në afërsi të Bankës Popullore të RM-së, së bashku me shokët e tij, është sulmuar fizikisht nga disa persona të moshës prej 16-17 vjeçare. Nga sulmi minoreni ka marrë lëndime të dukshme, ndërsa është ankuar edhe në dhimbje në kokë. Ndërmerren masa për gjetjen e personave.

Sulmohet një mjek dhe infermiere në Poliklinikën e Çairit

Një mjek dhe një infermiere të punësuar në poliklinikën Çair janë sulmuar fizikisht nga një shkupjan i cili e ka sjellë mbesën me ngërçe në stomak. Incidenti ka ndodhur tw enjten rreth orës 12:40 kur E.S. së bashku me vëllain e saj e ka dërguar mbesën në poliklinikë. Deri në prishje të rendit dhe qetësisë publike ka ardhur pasi nga ana e një mjeku të Repartit të fëmijëve u është thënë se me automjet të ndihmës së shpejtë fëmija duhet të dërgohet në Klinikën e fëmijëve. Është kërkuar telefon nga Ndhma urgjente mjekësore, por të njëjtit nuk janë paraqitur menjëherë në telefon, me ç'rast nga ana e mjekut të Repartit të fëmijëve personat janë udhëzuar që të paraqiten personalisht në pikën e Ndhmës urgjente mjekësore në kuadër të poliklinikës. Në atë moment, E.S. ka filluar të bërtasë dhe të godasë derën me ç'rast i është kërcënuar infermieres N.E. Pastaj ka dalë mjeku A.N. i cili është shtyrë, zvarritur dhe ka marrë kërcënime për jetë nga ana e E.S. në qoftë se diçka i ndodh fëmijës. Nga familjarë të fëmijës, E.S. është larguar, ndërsa mjeku me personelin mjekësor e kanë transportuar fëmijën. Pas pastrimit të plotë dhe dokumentimit të ngjarjes kundër të denoncuarit do të pasojë kallëzim adekuat.

F.S. është vrasësi i Martin Janushevit

Kemi dëshmi të pakontestueshme se personi F.S. është autor i vrasjes së Martin Janushev, informoi ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski gjatë vizitës së SPB Shkup. "Është dorëzuar kallëzim penal, ndërsa hyjnë në fuqi edhe masat e tjera të cilat duhet të ndërmerren siç është fletarrestimi ndërkombëtar etj. për ta siguruar personin dhe për zbardhjen e plotë të rastit", tha Spasovski. Ai shtoi se ka indikacione për vendin ku ndodhet autori dhe për momentin MPB është orientuar drejt zbulimit të tij. Ish-futbollisti Martin Janushev u vra më 3 nëntor të këtij viti me disa plumba para hyrjes së ndërtesës së tij në rrugën "Vlladimir Komarov" në lagjen Aerodrom të Shkupit. Një pjesë e mediave ndërkohë publikuan se pas vrasjes së Janushev qëndron 23-vjeçari Filip Sekulovski, i cili ka vuajtur dënimin gjashtëvjeçar me burg për tregti dhe posedim të drogës. Sekulovski, fundjavën kur u krye vrasja ka qenë i liruar për fundjavë të lirë, por nuk është kthyer në burg. Drejtoria për sanksione atëherë konfirmoi se Sekulovski nuk është kthyer nga fundjava e lirë dhe prandaj është shpallur fletarrestim për të. (O.XH)

Nga e diela ftohje e kohës me dëborë nëpër male

Shkup, 17 nëntor - Nga e diela pritet ftohje me reshje shiu nëpër vendet më të ulëta dhe dëborë nëpër male dhe vendet më të larta mbi 800 metra. DPHM njoftoi se nën ndikim të masës më të ftohtë dhe relativisht të lagësht nga e diela do të mbizotërojë mot me vranësira, ndërsa nga fundi i ditës do të ketë reshje të shiut në pjesët

perëndimore dhe veriore të cilët nëpër male dhe në vendet më të larta do të kalojnë në dëborë. Do të fryjë erë mesatare veriore. Reshjet do të vazhdojnë edhe të hënën paradite dhe do të shkaktojnë rënie të konsiderueshme të temperaturave, e cila të hënën do të jetë në interval nga 4 deri në 9 gradë Celsius.

Reshjet të mirëseardhura për bujqësinë

Shkup, 17 nëntor - Temperatura dhe reshjet të cilat e kapluan Maqedoninë janë të mira për bujqësinë, veçanërisht për mbjelljet të cilat janë në faza të ulëta të zhvillimit më së shumti për shkak të lagështisë së ulët në periudhën e deritanishme, vlerësojnë agrometeorologët. Sipas tyre, stabilizimi i motit javën e ardhshme me temperatura të mëngjesit dhe ditore rreth 10 gradë Celsius, do të mundësojnë zhvillim normal të kulturave. "Reshjet gjatë fundjavës presim t'i plotësojnë rezervat e lagështisë edhe në

shtresat më të thella që është garanci për periudhën e ardhshme", thonë nga DPHM. Vlerësim i Drejtorisë është se reshjet e fundit të shiut me sasi mbi 150 litra në një metër kator të shënuara në Gjevgjeli dhe Demir Kapi, në mënyrë të plotë e ndryshuan fotografinë për bujqësinë në Maqedoni. Në vendet e tjera, edhe pse me sasi të ndryshme, prej 25 deri në 60 litra për njësi të sipërfaqes, reshjet do të kontribuojnë që farat të fillojnë me mbirjen ose të zhvillohen normal kulturat të cilat tashmë kanë mbirë.



Projekti i UNICEF-it merr mbështetje të gjerë

Fëmijëve pa prindër në familje dhe jo në institucione

Qeveria u angazhua deri në vitin 2020 t'i jepet fund kujdesit të fëmijëve deri në moshën tre vjeçare në institucione të mëdha të kujdesit, gjegjësisht ajo të zëvendësohet me kujdes në familje kujdestare dhe të afërmit, gjegjësisht forma të më të afërme deri te familja biologjike

Koha Aida XHONI

Shkup, 17 nëntor - Fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror deri në moshën trevjeçare të strehuar në institucionet e mëdha për përkujdesje kanë më pak gjasa të zhvillohen në mënyrë normale edhe fizikisht edhe psikikisht. Prandaj nuk ka vendim që mund një qeveri ta sjellë që mund të bëjë ndryshim më të madh në jetën e një individi, nga vendimi për atë çka do të ndodhë me këta fëmijë, porositi përfaqësuesi i UNICEF-it, Benjamin Perks në takimin e së premtes të punës të grupit interpartiak parlamentar në temë "Familje për çdo fëmijë". Sipas tij, familja për çdo fëmijë është burim parimor i mësimi para moshës tre vjeçare kur, siç tha, formohen pjesë e madhe e kapaciteteve kognitive, emocionale dhe sociale. Në të njëjtën kohë, shtoi ai, familja për fëmijën është burim i sigurisë, dashurisë, identitetit dhe përkatësisë. Të gjithë këtë, sipas tij, nuk e marrin fëmijët e strehuar në institucionet e



mëdha. Atje ata janë nën stres të madh emocional toksik që e konteston zhvillimin e tyre normal. Si dalje nga kjo situatë, sipas tij, janë bashkëpunimi me sistemin shëndetësor dhe shërbimet sociale që të pengohet ose të paktën të zvogëlohet heqja dorë e prindërve nga fëmijët e tyre, të zhvillohen forma të tjera alternative të kujdesit siç janë familjet kujdestare ose të afërmit, por edhe të intensivkohet mënyra e përvetësimit. Në Maqedoni, tha, ka 72 fëmijë të cilët presin të përvetësohen, ndërsa 200 prindër të interesuar për të marrë fëmijë. Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, theksoi se në botë në përgjithësi kanë ndryshuar shumë punë në lidhje me këtë kategori të fëmijëve, janë sjell shumë doku-

mente ndërkombëtare për mbrojtje, janë përmirësuar zgjidhjet ligjore të cilat kanë të bëjnë me to, por megjithatë, siç tha, ajo që iu mungon fëmijëve në institucione të tilla dhe të ngjashme është ngrohtësia dhe dashuria e familjes. Ajo që në Maqedoni ka rreth 250 fëmijë të strehuar në institucione, sipas Xhaferit, flet se diku ende ka ngecje në procesin e deinstitutionalizimit dhe se duhet shumë punë dhe angazhim i të gjithë aktorëve duke filluar nga Qeveria, ministritë, Kuvendi, sektori joqeveritar dhe tërë bashkësia. "Projekti 'Familje për çdo fëmijë' është projekt i Qeverisë së RM-së. Kuvendi mund të bëjë mjaftueshëm në drejtim të këtij procesi për të marrë edhe në dinamikë edhe në cilësi. Këtu para së gjitha-

sh mendoj në procesin ligdhënës, por po aq i rëndësishëm është roli mbikëqyrës. Besoj se edhe si shtet edhe si shoqëri dhe para së gjithash si individë të gjithë jemi të vetëdijshëm se bëhet fjalë për më të dashurit tanë, më të rinjtë dhe më të pafuqishmit", tha Xhaferi. Në temë "Familje për çdo fëmijë" ditë më parë në Shkup u mbajt edhe konferencë e organizuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe UNICEF-it. Qeveria u angazhua deri në vitin 2020 t'i jepet fund kujdesit të fëmijëve deri në moshën tre vjeçare në institucione të mëdha të kujdesit, gjegjësisht ajo të zëvendësohet me kujdes në familje kujdestare dhe të afërmit, gjegjësisht forma të më të afërme deri te familja biologjike.



Qytetarët të kuptojnë sa është me rëndësi të paguhen tatimet

Shkup, 17 nëntor - Qasje më serioze të kontrolleve inspektuese, vendosje e tërësishme të paraqitjes së plotësuar tatimore nga ana e DAP-it deri në janar të vitit 2019 dhe sistem më i mirë informativ për pagesë më efikase të tatimeve, paralajmëroi ministri i Financave, Dragan Tevdovski. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve lidhur me rekomandimet e djeshme të Bankës Botërore, Tevdovski përmendi se qytetarët duhet të kuptojnë sa është e rëndësishme të paguhen tatimet. "Qytetarët duhet të kuptojnë sa është me rëndësi të paguhen tatimet. Pa këtë nuk mund t'i zhvillojmë shtyllat e shoqërisë, arsimi, shëndetësisë", tha Tevdovski pas ngjarjes së përfunduar për harmonizimin e legjislaturës së Maqedonisë me atë evropiane për sigurimin. Sipas tij, fakt është se Maqedonia viteve të kaluara ka pasur një nga pagesat më të dobëta të tatimeve në krahasim me vendet e tjera në rajon. "Bëjmë çmos që këtë ta ndryshojmë. DAP realizon projekt të madh me Holandën për sendërtimin e softuerit, por kjo është praktikisht edhe vullnet politik që të bëjmë presion dhe tatimet të grumbullohen siç duhet", deklaroi ministri, duke shtuar se pagesa e tatimeve në tetor ka qenë në nivel shumë më të kënaqshëm në krahasim me periudhën e kaluar. Reformat e parashikuara dhe ndryshimet e zgjidhjeve aktuale ligjore, shtoi ministri, do të mundësojnë shërbime më të mira për qytetarët, por edhe ngritjen e vetëdijes për grumbullimin e tatimeve. I pyetur për pensionet, Tevdovski informoi se me buxhetin për vitin 2018 janë paraparë 2,1 miliardë denarë më shumë për pagesën e tyre me kohë. "Në buxhetin mundësojmë edhe rritjen e pensioneve në pajtim me ligjin, respektivisht harmonizimin me rritjen e çmimeve për jetë", tha ministri i Financave, Dragan Tevdovski.

Maliqi zëvendëskryetar i Qytetit të Shkupit

Shkup, 17 nëntor - Enver Maliqi është zëvendëskryetari i ri i Qytetit të Shkupit. Siç informojnë autoritetet e qytetit, kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov pas-

dite e emëroi Enver Maliqin për zëvendës të tij. Maliqi është këshilltar i Qytetit të Shkupit nga radhët e BDI-së dhe menaxher i kompanisë "Gemak Trade".



SHGM takoi sekretarin e përgjithshëm të OSBE-së

Siguri më të madhe, e jo dënime për gazetarët

Shkup, 17 nëntor - Në Maqedoni ekziston tendencë e qartë për mosdënim të dhunës mbi gazetarët sepse asnjë dhunues nuk është nxjerrë para drejtësisë. Nevojitet të ndërtohet mekanizëm institucional për parandalimin dhe dënimin e dhunës mbi gazetarët, për të cilin SGHM është e gatshme të bashkëpunojë me institucionet. "Këtë e ka theksuar kryetari i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë Naser Selmani në takimin me sekretarin e përgjithshëm të OSBE-së, Tomas Greminger, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të pesë organizave të tjera civile. Siç kumtoi SHGM, ambasadori Greminger, i cili po qëndron për vizitë dyditore në Maqedoni i ka njoftuar përfaqësuesit e organizatave civile me qëllimet e vizitës në Maqedoni, të shohë si vendi e ka tejkaluar krizën politike dhe të një-

het me agjendën për reformën e Qeverisë, për çfarë, ka thënë, OSBE është e interesuar t'i mbështesë ato përpjekje. Lidhur me ndryshimet e



ligjeve për media, Selmani ka thënë se debati në vend që ta përmirësojë tekstin e ligjit, ai e përkeqëson. Për SHGM-në, ka thënë, është absolutisht e papranuar ideja e Qeverisë që ta rregullojë përmbytjen mediatiqe. "Kjo është në kundërshtim me praktikën më të mira në demokracitë evropiane", tha Selmani. Ai ka theksuar se imponimi i dënimeve në para për mënyrën e njoftimit të gazetarëve tregon

se Qeveria dëshiron ta luajë rolin e kryeredaktorit dhe atij përgjegjës të mediae. Sipas tij, Qeveria deri më tani nuk ka treguar dëshirë për debat të vërtetë me argumente rreth modelit për financimin e Radiotelevizionit të Maqedonisë. "Nëse Qeveria më përpara e di se për RTVM-në duhet të ndahen vetëm 0,7 për qind nga buxheti i shtetit, atëherë për çfarë shërben debati për ligjin" ka pyetur Selmani.



UEJL shënon 16 vjetorin e themelimit

Në qendër të strategjisë, avancimi i mësimdhënies

Rektori Zamir Dika tha se bashkëmoshatarin ynë është procesi i Bolonjës - reforma më sublimë e arsimit të lartë në Evropë; jemi tre vjet më të vjetër se Facebook-u; shtatë vjet më të vjetër se Iphone-i i parë



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 17 nëntor - Në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë është mbajtur ceremonia e 16-të vjetorit të themelimit të këtij universiteti. Me këtë rast, para të pranishmëve rektori Zamir Dika foli për rrugëtimin e këtij universiteti nga fillimi e deri në ditët e sotme. "Më vjen mirë që Bordi i Universitetit, duke iu falënderuar, në veçanti përfaqësuesve ndërkombëtarë, ka vënë në qendër të strategjisë aspiratën për avancim të mësimdhënies, duke integruar mbështetjen e teknologjive të informacionit. Përvoja jonë nga ky bashkëpunim i mrekullueshëm me bashkësinë ndërkombëtare dhe komunitetin lokal, mjedisi i hapur shumë-kulturor dhe shumë-gjuhësor që po kultivojmë, si dhe hapja ndaj të gjithë pjesëmarrësve në inovacion dhe dije,

na kanë shndërruar të gjithë ne - stafin akademik e administrativ të UEJL-së dhe studentët tanë në një komunitet intelektual vibrant të vlerave dhe standardeve të hapësirës së përbashkët evropiane të arsimit të lartë, me garanci se edhe në këto troje është e mundur të projektohet e ardhmja...", tha ndërmyjet rektori Dika. Sipas rektorit Dika, gjashtëmbëdhjetë vjet është një hark i shkurtër kohor për të prodhuar ngjarje të mëdha historike, por sipas tij, "në dimensionin ballkanik, suksesi i UEJL-së lidhet me parametra jo vetëm arsimor, por edhe social-politik e kulturologjik. Megjithatë,

bashkëmoshatarin ynë është procesi i Bolonjës - reforma më sublimë e arsimit të lartë në Evropë; jemi tre vjet më të vjetër se Facebook-u; shtatë vjet më të vjetër se Iphone-i i parë; u rritëm në kohën e revolucionit teknologjik, i cili mundësoi që globalizimi të arrijë në nivele të paimagjinueshme - ku komunikimi, lëvizja, por edhe tregu i lirë i tejkaluan kufijtë dhe kanë hapur një dimension të ri të fushëveprimit për universitetet", tha rektori Dika, i cili falënderoi faktorin ndërkombëtar, SHBA, BE dhe OSBE për kontributin e madh në ngritjen e këtij universiteti model në Maqedoni dhe rajon. Zëvendëskryeministri,

Hazbi Lika, në fjalën e tij para të pranishmëve, theksoi se është nderi i veçantë të drejtohet në solemnitetin që shënon 16-vjetorin e themelimit të Universitetit të Evropës Juglindore, i cili, sipas tij, së bashku me Universitetin Shtetëror të Tetovës, të themeluar disa vite më parë dhe pas shumë vitesh me përpjekje dhe luftë të pareshtur të shumtë veprimtarëve të arsimit për arsimin sipëror në gjuhën shqipe në Maqedoni, shënoi ngritjen e vazhdueshme të arsimit sipëror në gjuhën shqipe. "Pas hezitimit shumëvjeçar, pas ngulfates së arsimit të lartë në gjuhën shqipe në vitet e fundit të sistemit të kalu-

ar dhe pas shumë peripecive që na ndoqën gjatë ngritjes së këtyre tempujve, sidomos gjatë hapjes së Universitetit të Tetovës, themelimi i këtij Universiteti shënoi një kapitull të ri, kapitull ky që çoi drejt institucionalizimit, kapitull që çoi drejt vlerave të reja, kapitull që çoi në krijimin e horizonteve të reja, të cilat na afrojnë dhe na bashkojnë me vlerat moderne evropiane dhe civilizuese", tha Lika. Për ngritjen e arsimit këtu në Tetovë, sipas Likës, sigurisht se respektin më të madh e meritojnë punonjësit e arsimit, të cilët sakrifikuuan shumë dhe iu rrekën një pune të mundimshme, e në disa vite edhe shumë të rrezikshme. "Por, medoemos këtu më duhet t'i kushtoj respekt të veçantë dhe të theksoj rolin e rëndësishëm si dhe kontributin e komunitetit ndërkombëtar në përgjithësi, e në të veçanti të OSBE-së dhe të komisarit të atëhershëm, të ndjerit Maks Van Der Shtul, i cili punoi me përkushtim për të hapur derën e arsimit sipëror në Maqedoni". Pres që të gjithë ne të vazhdojmë të kontribuojmë me përkushtim, për këtë Universitet, si dhe për arsimin në gjuhën shqipe në

përgjithësi. Ua kemi borxh gjeneratave që shkuan dhe u flijuan, por edhe atyre që vijnë. E kemi për detyrë që rinisë tonë t'ia krijojmë ato kushte, të cilat nuk i kemi pasur ne vetë. Të ndërtojmë një perspektivë dhe një të ardhme më të sigurt, duke shpresuar se gjeneratat e ardhshme të mos sfidohen nga probleme të njëjta si; jemi përballë ne, por të ngrënë sa me lart trofetë që ua dorëzojmë ne dhe t'i përcjellin brez pas brezi, duke synuar që të jemi pjesë e botës së civilizuar ku do të mund të japim të veçantë tonë dhe të marrim pjesë në procese universale", deklaroi Hazbi Lika, zëvendëskryeministri.

Të pranishëm në këtë solemnitet ishin përfaqësues të korit diplomatik, rektorë universitetesh nga Maqedonia, profesorë dhe studentë të UEJL-së, me ç'rast u ndanë edhe disa mirënjohje në shenjë respekti për kontributin e dhënë në avancimin e vlerave arsimore në UEJL. Kështu, u veçuan për merita në fushën e tyre të punës, Heather Henshou, Norbert Marks dhe Abdullah Islamogllu. I gjithë aktiviteti u përcoll edhe me një performancë të shkëlqyer muzikor.

USAID ndanë tetë grante për rininë

Tetovë, 17 nëntor - Në Hapësirat e Qendrës për bashkëpunim ballkanik "Loja" në Tetovë, përfaqësues të USAID-it, kanë prezantuar sesionin informativ rreth granteve për mbështetje rinore. USAID kryesisht do të mbështesë grante që kanë të bëjnë me rininë dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në vendimmarrje. Me këtë rast USAID do të ndajë tetë grante, ndërsa vlera është 15 mijë dollar për një grant. Aplikimi ka filluar me tre nëntor dhe do të zgjasë deri më 24 nëntor. Eduard Gonzalez, drejtor i Zyrës për Zhvillim në USAID, thotë se qëllimi është përmes këtyre granteve rinia të jetë më aktive në vendimmarr-



rje. "Qëllimi i projektit është që të ndihmojmë përfshirjen e organizatave rinore në jetën politike të Maqedonisë, në proceset politike, në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme dhe qëllimi kryesor është që rinia të jetë pjesëmarrëse në të gjitha vendimmarrjet politike. Ne po bëjmë promovimin e pro-

jekteve që e ndihmojnë përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile dhe posaçërisht organizatave rinore. Ne do të ndajmë tetë projekte dhe secili grant kap vlerën prej 15 mijë dollarë. Do të ndihmojmë organizatat që do të ndihmojnë rininë të përfshihen në jetën politike të vendit. Ne e dimë

se Tetova është një qytet me plot rini dhe shumë organizata të mrekullueshme dhe shpresojmë se edhe këtu do të ndajmë grante për këta organizata", tha ai. Në këtë sesion informativ të granteve për mbështetje rinore, kanë marrë pjesë përfaqësues të shumë organizatave rinore nga Tetova dhe rrethina të cilët janë njohur me kushtet e dhe kriteret për aplikim të organizatave. Projekti i USAID-it për pjesëmarrje qytetare është projekt pesëvjeçar që kap shumën prej 9.4 milionë dollarë, i cili synon të përforcojë kapacitetin e organizatave qytetare (OQ) dhe grupeve rinore për avancimin e politikave

publike, përmirësimin e shërbimeve publike, promovimin e qeverisjes së mirë dhe të kontribuohet për përmirësimin e standardit jetësor të njerëzve në Maqedoni. Ky projekt implementohet nga Ist Uest Menaxhment Institut (East West Management Institute-EWMI), në partneritet me katër OQ lokale: Fondacioni për internet dhe shoqëri "Metamorfozis", Asociacioni për iniciativë demokratike (AID), Fondacioni shoqëri e hapur në Maqedoni dhe Këshilli rinor nacional i Maqedonisë. Prej fillimit e deri tani Projekti i USAID-it për pjesëmarrje qytetare ka ndarë 31 grante që kapin shumën mbi 1 milion dollarë. (u.h.)



Shuhet Hanife Sejfullah Reçani

Shkup, 17 nëntor - Pas një sëmundje të rëndë të shtunën ka ndërruar jetë njëra ndër këngëtarët më të njohura të muzikës folklorike dhe popullore në rajonin e Pollogut, Hanife Sejfullah - Reçani.

Shumë kush, veçanërisht breznitë e viteve 60-të dhe 70-të kanë dëgjuar për këngëtarën e madhe të këngës popullore shqiptare të atyre viteve, Hanife Sejfulla Reçani.

Hanifja, talentin dhe zërin e saj prej këngëtareje do ta zbulon pa i mbushur aqoma 12 vjeç, ku mësuesit e saj do ta përkrahnin atë për tu bërë një këngëtare e vërtetë. Disa nga këngët e saj të njohura ishin: "Bien tri dairet", "Prej Tetove në Gostivar", "Moj fusha e Korabit", "I hipa vaporit", "Kënga e çobanit", "Kënga e bilbilit" etj.



• Agim Nuhiu: Tani mbetet detyrë e shtetit të bëjë një shkëputje nga krimi dhe korrupsioni që kaploi sistemin, të shuaj irredentizmin e thelluar me Greqinë dhe të synojë zgjidhjen e emrit

Tetovë, 17 nëntor - Vendi duhet të largohet nga ndikimi rus dhe të orientohet në drejtim të integritetit drejt Bashkimit Evropian dhe NATO. Ndërsa, kontesti me emrin duhet të zgjidhet që vendi të mos ketë probleme që kanë të bëjnë

Vendi të largohet nga ndikimi rus

me sigurinë. Kështu u theksua gjatë një debati në Universitetin e Tetovës, me temë "Sfidat e sigurisë dhe standardet universale, në procesin e integruar euroatlantik. Për zëvendësministrin e Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Agim Nuhiu, shteti përveç reforma në shërbimin sekret dhe jurisprudencë duhet të bëjë edhe reforma në aspektin politik, në drejtim të orientimit për përmirësim dhe largimin e ndikimit rus në vend. "Tani mbetet detyrë e shtetit të bëjë një shkëputje nga krimi dhe korrupsioni që kaploi sistemin, të shuaj irredentizmin

e thelluar me Greqinë dhe të synojë zgjidhjen e emrit, të forcojë marrëdhëniet me Bullgarinë, Shqipërinë e Kosovën, të vendos një orientim të ri drejt NATO-s dhe BE-së dhe një distancim të ndikimit rus", tha Agim Nuhiu. Zgjidhja e kontestit të emrit me Greqinë dhe reformat e mirëfillta brenda shtetit, me theks të veçantë, sjellja e ligjit për funksionim si duhet të shërbimit sekret të shtetit, këto sipas ekspertëve, janë sfidat kryesore të shtetit tonë në rrugën drejtë euro-integrimeve, temë kjo mbi të cilën është debatuar sot në Universitetin e Tetovës.

"Sa i përket sfidave të sigurisë në aspektin Integruar, unë mendoj se Maqedonia është kthyer shumë hapa pas, dhe ka shumë punë, sfida dhe reforma politike për të bërë në aspektin e sigurisë dhe reforma ekonomike që duhet plotësuar. Maqedonia Fillimisht do duhet të bëjë një reformë thelbësore të sistemit të sigurisë së brendshme apo sigurimit shtetëror sepse pamë se gjatë dhjetë viteve të shkuara pamë se ky sistem ka dështuar tërësisht dhe është vënë në shërbim të partisë e jo të shtetit" tha Ermira Memeti, juriste. (u.h.)



Alex S. JONES

Imagjinoni një sferë prej hekuri, gri dhe të papërsosur, si një gjyle e madhe. Mendojeni këtë gjyle të rëndë, të përbërë nga masa totale e lajmeve serioze të raportuara përditë, bërthama e hekurt e informacionit, që është në qendër të një demokracie funksionale. Kjo bërthamë hekuri është e madhe dhe e ngathët, ajo përmban tërësinë e të gjithë produktit të gazetarisë profesionale, të krijuar nga organizatat e lajmeve – gazeta, radio dhe televizione lajmsh, shërbime të lajmeve të tilla si Associated Press dhe Reuters, dhe disa revista-ve. Një pjesë e përmbajtjes krijohet tashmë nga mediat e reja, jofitimprurëset, dhe madje, herë pas here, nga tabloidët e supermarketeve, por shumica dërrmuese, ende vjen nga mediat tradicionale të lajmeve.

Kjo bërthamë hekuri nuk përfshin bëmat më të fundit të Paris Hiltonit, apo një rrëfim të ndeshjes së fundit të Yankees, apo US Open. Nuk ka karikatura apo fjalëkryqe. Nuk ka reklama. Nuk ka artikuj rreth këlyshëve shtëpiakë apo arrative të fundjavave, apo receta të gatimit me shumë piper. As nuk përfshin këshilla për blerjen e

Të humbasësh lajmin

pasurive të paluajtshe, investime, kritika filmash, apo këshilla dietash. Nuk ka asgjë të keqe me asnjë nga këto gjëra. Në të vërtetë, artikujt e këndshëm dhe argëtues janë shumë më tërheqës për shumicën e njerëzve, sesa përmbajtja e bërthamës, që disa e gjejnë të zymtë, të mërzi- shme, ose të mbushur me anshmëri. Ajo nuk ka editoriale dhe nuk përfshin mendimet e kolumnistëve, apo blogger-ave. Këto gjëra rrjedhin nga bërthama. Ato janë të mundura, sepse ekziston një bërthamë. Pikënisja e tyre është pothuajse gjithmonë informacioni i mbledhur nga raportimi, që i jep bërthamës peshën e saj, dhe shërbejnë për të përhapur vetëdijesimin mbi informacionin që ndodhet në bërthamë, për të analizuar dhe interpretuar atë, dhe për ta sfiduar atë. Opinionistët zgjedhin midis asaj që ofron bërthama, për të gjetur fakte që do të shprijn më tek një argument, ose do të avancojnë një agjendë të politikave. Por ato janë jashtë bërthamës, sepse ato ofrojnë gjithmonë komente dhe vëzhgime personale, jo raportim origjinal.

Brenda bërthamës është lajmi i jashtëm, që nga mbulimi i luftës në Irak, deri tek artikujt që përshkruajnë përpjekjet për të shpëtuar parqet kombëtare në Mozambik.

Ka lajme për politikën, nga Shtëpia e Bardhë, deri tek zyra e kryetarit të bashkisë. Ka një artikull për një dëgjuesë publike mbi një propozim, për të ndërtuar fusha të reja sportive, dhe një shpjegim për një koncept të zonimit rajonal, i cili mund të ketë ndikim mbi vlerat e pronave. Ka lajme rreth reformës së Medicare dhe lajme shkencore rreth ngrohjes globale. Ka artikuj për biznesin, si për risitë edhe për skandalet, madje ka edhe lajme sportive, për gjëra të tilla si shpërdorimi i steroideve. Aty gjen edhe një artikull rreth debatit brenda bordit të shkollës lokale, mbi kodet e veshjes, së bashku me debatin në legjislaturën e shtetit, lidhur me temën e “intelligent design” dhe a duhet të jepet mësim si shkencë. Sferës së hekurt i jepet peshë shtesë, nga artikujt investigues, duke filluar nga zbulimi se të burgosurit janë duke u përdorur për të lyer shtëpinë e drejtorit të burgut, deri tek zbulimi se qeveria po përgjion telefonat, pa urdhër gjyqate, si pjesë e luftës kundër terrorit.

Ajo që futet në këtë “gjyle”, është agregati i përditshëm i atyre që ndonjëherë quen “lajmet e llogaridhënies”, sepse është forma e lajmeve, qëllimi i të cilave është që të mbajnë përgjegjës qeverinë

dhe ata që janë në pushtet. Ky është lajmi i bazuar në faktet, ndonjëherë i quajtur “lajmi i verifikimit”, që ndryshon nga “lajmi i pohimit”, i cili shfaqet më së shumti këto kohë në televizionet me lajme 24-orëshe dhe në blogje.

Gazetarët tradicionalë kanë besuar për një kohë të gjatë, se kjo formë lajmesh bazuar në faktet është furnizuesi ushqimor thelbësor i demokracisë, dhe se, pa një ushqim të tillë të shëndetshëm, demokracia do të dobësohet, do të sëmuret, do të “vdesë” ndoshta.

Për më shumë se një shekull, kjo bërthamë e lajmit të raportuar ka qenë pikënisja e një bashkëbisedimi kombëtar, për atë se, kush jemi ne si popull dhe si vend. Ashtu sikurse Toka është e rrethuar nga një mbështjellë e atmosferës, po kështu edhe kjo bërthamë është e rrethuar nga një shtresë e trashë, bisedash dhe opinionesh. Bashkëbisedimi – që ngjan më shumë me një grindje familjare që s’ka fund – ndodh në faqet e editorialeve dhe letrat drejtuar botuesve, në opinionet dhe në debatet e të dielës në mëngjes, tek “O’Reilly Factor” dhe tek programet radiofonike të Rush Limbaugh dhe Don Imus, në blogjet në internet dhe në deklaratat e shtypit, në tryezat e ngrënies

mbrëmjeve, në bare, në karikatura politike...

Dhe në barcaleta. Në dhjetë vitet e para si prezantues i “The Tonight Show”, Jay Leno tregoi më shumë se 4000 barcaleta për Bill Clintonin. Por, për secilën prej barcaletave të Jay Lenos, pikënisja ishte nga bërthama e hekurt. Bërthama ushqen edhe industrinë e argëtimit, e cila ka zërin e vet të fuqishëm në bashkëbisedimin kombëtar. Programet pothuaj-lajme në televizion, si “Today” dhe “20/20” shohin tek bërthama, për ide dhe frymëzim. Disa programe që i dedikohen vetëm argëtimit, si “The West Wing” (serial), vijnë direkt nga bërthama, dhe në të njëjtën kohë, edhe sitcom-et më idiote, apo fjalët më të pista në këngët e hip hop-it, janë shpesh të lidhura me bërthamën e hekurt, në një farë mënyre. Pavarësisht se ku ndodh bashkëbisedimi në lidhje me çështjet publike, është pothuaj gjithmonë një rrjedhojë e asaj “gjyleje” të hekurt.

Shqetësimi më i madh për ata që merren me lajmet, është se kjo bërthamë është në rrezik, kryesisht për shkak të telasheve që i kanë pllakosur biznesit të gazetave. Janë gazetaret kombëtarë që ofrojnë shumicën dërrmuese të lajmeve të bërthamës. 85% e lajmeve profesionale vijnë nga

gazetat, por kam dëgjuar hamendësime nga burime të besueshme, që kjo shifër shkon deri në 95 %. Ndërkohë që njerëzit mund të mendojnë se lajmet i marrin nga televizioni apo interneti kur vjen fjala tek këto lloje lajmsh, janë pothuaj gjithmonë gazetaret që kanë bërë raportimin e vërtetë. Çdo gjë tjetër është zakonisht thjesht një sistem shpërndarjeje, dhe ndërkohë që burimet për lajmet televizive kanë rënë dhe lajmet në radiot komerciale pothuaj janë zhdukur, impakti i vërtetë mbi lajmet e bërthamës së hekurt, ka ardhur prej telasheve ekonomike të gazetave.

Deri tani, bërthama e hekurt e lajmeve është mbrojtur disi nga një model ekonomik, që ka qenë në gjendje të sigurojë burime ekstra përtej asaj që lexuesit – dhe reklamuesit – do të ofronin financiarisht. Këto lloj lajmsh janë të vështirë të prodhohen, sidomos rpaortimet investiguese. Dhe ka tregues që shumë njerëz nuk janë të interesuar. Në ekonominë mediatike të të ardhmes, matësit e ftohtë do të përçaktojnë atë që duhet shpenzuar për lajmet. Përmasa dhe cilësia e bërthamës së hekurt do të jetë një pasqyrim i drejtpërdrejtë i asaj që audienca e saj do të mbështesë financiarisht. Do të sundojë kërkesa, dhe kjo ndoshta do të thotë se si vend, do të humbasim shumë lajme. Do të flitet shumë, por lajmet serioze, të raportuar nga gazetarë profesionistë, “po ia mbathin” të frikësuar.



Delvina KËRLUKU

Para ca muajsh bëra një shkrim, ku vura në spikamë neglizhencën apo veprimin e qëllimshëm të ambasadorit të BE-së në Shkup, z. Zhbogar, i cili në ceremoninë e dorëzimit të çmimit “Zhan Mone”, foli në gjuhën serbe, duke mohuar gjuhën maqedonase dhe atë shqipe. Mesazhet e kësaj sjelljeje secili i mori në mënyrën e vet. Shkrimi im, përveç se në gazetën e përditshme KOHA të Shkupit, u botua edhe në disa mjete të tjera shqiptare, si në Tiranë, poashtu edhe në Prishtinë e gjetiu. Ne, disa kolegë gazetarë shqiptarë, e komentuam midis vete këtë gjest aspak diplomatik të diplomatit evropian, por jehona ishte e paktë, sidomos nuk pati asnjë reagim nga partitë politike shqiptare, edhe pse mohohet gjuha e tyre për të cilën rrahin aq shumë krahorët partiakë. Të pak-

Ç’është ky diskriminim që përsëritet e përsëritet!

Dhe kështu do të jetë, derisa partitë shqiptare të kthjellohen dhe barazinë e gjuhës së tyre, ta marrin pak me seriozitet

tën të kishte përhëndetur në gjuhën angleze, e cila tanimë ka marrë letërnjoftimin e gjuhës së diplomacisë, por të cilën edhe e njohin shumica e gazetarëve. Më në fund përkthyesit atë punë kanë, e të cilët nuk mungojnë në evente të tilla. Dhe, nuk duhet të mungojnë. Në atë mbrëmje nuk mungoi audienca e gjerë, por as mediat e shumta të vendit dhe të huajat. Aty ishin edhe mediat në gjuhën shqipe. Dhe fjala e diplomatit evropian (me përkatësi etnike slovene), befaso! me dushin e ftohtë. Siç thashë, të nesërmen nuk pati reagime qenësore, sikur të mos kishte ndodhur ndonjë gjë e madhe. Mos ishte kjo gjest manifestim i një servilizmi të tepruar, apo ndonjë urdhër-rekomandim nga

lart, mbetet të hetohet e të shihet. Skandale me mosrespektimin e gjuhëve në kryeqendër tonë, kanë ngjarë edhe më parë. Ndodhi edhe disa muaj më herët me gazetaren nga Shqipëria Sonila Meço, kur iu drejtua auditorit në gjuhën angleze, e jo në shqipen e saj. Unë shkrova edhe për këtë rast. Shkrimi pati jehonë, por jo edhe ndonjë efekt konkret.

Më ka rastisur që shpesh të raportoj aktivitetet në selinë e Bashkimit Evropian, për gazetën ku punoj. Shumë herë ka qëllyar të luaj rolin edhe të përkthyesit në gjuhën shqipe, pasi organizatori nuk e ka parë të arsyeshme të respektoj ligje e konventa për barazinë e gjuhëve. Gjithmonë është kënaqur me përdorimin e dy gjuhëve: anglisht e maqedonisht. Po shqipja që flitet, të paktën, nga një e treta e popullatës, ku na mbeti. Mediat në gjuhën shqipe përse anashkalo- hen? Evropa na lodhi me sloganët e barazisë, por ja që një qëndrim tjetër (mos themi diskriminues) ndaj

shqipes dhe shqiptarëve. Gjuha shqipe mbeti çështje e hapur, e cila nuk po mbyllet me dekada. Në çdo fushatë zgjedhore partitë atunë kryesore e kanë rregullimin me ligj të përdorimit (zyrtar) të gjuhës shqipe. Mirëpo, sa kalojnë zgjedhjet dhe verifikohen mandatet, premtimet e zotimet i merr era, dhe deputetët vazhdojnë të bëjnë veshin shurdh, dhe ia krisin gjumit letargjik (hipokrit). Çështja e përdorimit të saj, po përlitet kaq shumë edhe ditëve të sotme në Parlamentin e Maqedonisë. Na ka zënë veshi të dëgjojmë se ligji që po trajtohet përmban flamarin (rekomandimin) e BE-së. Sa mirë! Por përse ajo vetë nuk e përfill këtë rekomandim, kur në aktivitetet që organizon zyra e saj në Shkup, shqipja e ka vendin prapa derës? Se të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni duhet të shënojnë progres shumë më të dukshëm e të prekshëm, përmes një zbatimi sa më real e më konkret edhe të vetë marrëveshjes së Ohrit. Përfaqësuesit e BE-së kanë


deklaruar se Maqedonia konsistohet si shtet sovran dhe i pavarur dhe si shtet qytetar dhe demokratik. Na kanë thënë se angazhohen për të siguruar sundimi i së drejtës si sistemi themelor i pushtetit; të garantohen të drejtat e njeriut, liritë qytetare dhe barazia nacionale; të sigurohet paqa dhe bashkëjetesa e popullit maqedonas, me kombësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë; të sigurohet drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës personale dhe të përbashkët, etj., etj. Por, këtu ndodh ndryshe. Kur ligjin e shkulin vetë ligjvënësit?! Rezultoni të jetë shndërruar në shembullin se si rregullorja dhe ligjet, shkelen në mënyrë flagrante, para mediave, në tempullin ligjvënës – Kuvendin e Maqedonisë. Kjo shihet edhe në konferencën “Ditë e medias, BE – Ballkani Perëndimor”, e zhvilluar nga Komisioni Evropian, disa ditë më parë në Tiranë. Si shumë herë më parë barazia kombëtare dhe gjuhësore: në këtë ak-

tivitete kaq të rëndësishëm organizatori është “ku- jdesur” që të mos ketë të pranishëm asnjë përfaqësues të mediave shqiptare në Maqedoni, por vetëm të maqedonasve (bashkë me zëdhënësin e Qeverisë, Mile Boshnjakovski). Aty është folur për lirinë e mediave, por nënëkuptohet që me këtë nënkuptohen mediat në gjuhën maqedonase. Ato shqiptare, si ta kenë punën! Kush pyet për to?! Përveç se diskriminim klasik, nuk gjen emër tjetër për këtë veprim. Dhe kështu do të jetë, derisa partitë shqiptare të kthjellohen dhe barazinë e gjuhës së tyre, ta marrin pak me seriozitet. Këtë qëndrim diferencues kjo Zyrë e ka edhe për çmimet që ndanë për gazetarët. Brenda tre vjetësh, aq sa unë jam në dijuni, pasi e ndjek këtë veprimtari si gazetar, nuk është ndarë asnjë çmim për asnjë disiplinë gazetare. Porosia del e qartë: Evropës (kësaj Zyre) i intereson vetëm një popull dhe vetëm një gjuhë. Ose: shqiptarët s’kanë gazetari për të qenë!

FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

- 3. Spërkat me ujë
- 5. Pjesë e tenisit
- 7. Enë e madhe
- 9. Autori nga Përmeti, Bardhyl
- 10. Thesar
- 12. Modelja Kraford
- 13. Inicialet e Tuistit
- 14. E rrezikshme (aktivitet, ndërmarrje)
- 18. Shansonieri frëng, Montan
- 20. I veshur bukur
- 21. Erstedi
- 22. Lidhëz e gj. latine (dhe)
- 24. Olympique Lyonnais
- 25. Që përbëhet prej nervash
- 27. Eseisti britanik, Eliot
- 28. Akademiku Ali
- 29. E 1000-ta pjesë e gramit
- 32. Qytet në Kaliforni
- 33. Këngëtar i Gëzimit
- 35. Qytet në Spanjë
- 37. Këngë solemne
- 39. Vegël frymore prej druri
- 40. Liga profesionale e basketbollit
- 41. Vietnam i vjetër
- 42. Në sasi të vogël
- 45. Por, porse, veçse
- 46. Regjisori Kryeziu
- 49. Humbje në fuqi, rraskapitje
- 50. Këngëtar anglez. Kris.




VERTIKALISHT


- 1. Mjet informimi me zë
- 2. Gjëra
- 3. Aktorja Ulman
- 4. Drekë në raste gëzimi
- 5. Këtë natë
- 6. Turbo Direct Injection
- 8. Natriumi
- 9. Material elastik për dysheme
- 11. Inicialet e aktorit Redford
- 12. Ndajfolje sasive
- 15. I dikurshëm
- 16. Këngëtarja në foto
- 17. Klubi i karatesë
- 19. Pjesët e aparatit për ventilim
- 23. Dorëzim, ndore (ndajf.bised.)
- 24. Gazetarja italiane, Falaçi
- 26. Office of Labor Relations
- 29. Malësor
- 30. International Bank Account Number
- 31. Fotografia kishtare
- 32. Gomar
- 34. Këngëtar Brajan
- 35. Tra mbajtës i tavanit
- 36. Posedon
- 38. Këngëtarja Qazimi
- 43. Kënde
- 44. Aktori ynë Dritëro
- 47. Grup i organizuar këngëtarësh
- 48. Nisu kënde.

Kakuro


e lehtë



mesatare




e vështirë



KOHA e lirë
për më të rinjtë


FIGURAT E FSHEHURA

Katër figurat e dhëna fshehen diku brenda figurës së dhënë. Gjejini ato!




ZBULONI FIGURËN

Ngjyrosni fushat që përmbajnë pika që të zbuloni figurën e fshehur!




DALLIMET

Gjejini 5 dallimet në fotografitë e mëposhtme!




LABIRINTI

Ndihmoni skitarit që të zgjedhë rrugën e vërtetë deri te caku!



BASHKONI PIKAT

Bashkoni pika që të zbuloni figurën e fshehur!



DOMINOJA

Bashkoni numrat nga dy, ashtu që të fitohen figurat e lojës së dominos.

3	3	4	2	4	2	3	3
0	1	0	2	3	4	1	3
6	6	2	1	1	2	2	0
4	4	5	4	6	2	4	0
3	6	6	5	0	2	1	0
4	5	5	0	6	1	0	5
6	5	6	1	5	3	5	1

DREJTKËNDËSHIT

Numrat e dhëna tregojnë hapësirën e drejtkëndëshit. P.sh, Numri 2 tregon se duhet të bëni drejtkëndësh prej dy kutive.

		2	6				
			3				2
				2			
12							
	6						8
		2	4				
	2		4				4
3	4			5	7		
		2					3


MOSBARAZIMI

Plotësoni tabelën duke u bazuar në operacionin e mosbarazimit. Përdoren numrat prej 1 deri 4.

<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	<	<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	3	>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

MARGARITARI

Lidhni pikat ashtu që të mos mbetet asnjë fushë e pakaluar. Pikat e zeza paraqesin skajet (kthesat) e vijës.



TRANSFORMIMI

Transformoni fjalën BIXHOZ në KARTA duke zëvendësuar nga një shkronjë.

1	B	I	XH	O	Z
2					
3					
4					
5					
6	K	A	R	T	A

Sudoku

i lehtë

1			4		6			
	4			8		1		
	9	7	1			4		2
			9					
		8	5					
7			2					6
4		8	3			1		
	2			1	9	4		
	5		7					8

mesatar

		9		8				
2			3					5
	6		5	9				
1	6				4			
	8		6	7		9		
		2				8		6
			1	5		3		
7			4					1
		2		5				

i vështirë

7	8			1	5	9		
1	5							
		9		7				
			9	4		1		
6				2				
							8	4
	3	6			2			
	6	4						9
8			5					

MENSUR MAMUTI	POEZI E S.G.J.	LUMË NË GJERMANI	KTHESA RRUGE, LAKU	QË MUND TË ECË NGA NJË VEND NË NJË TJETËR (f.)	FUTBOLLISTI IRLANDEZ, ROJ	SHIH FOTON	ITRIUM	PJESË APO SKENË E FILMIT OKSIGJEN	I	SHTET NË AZI	SULFUR	VES, VETI E MIRË LENTË	V
Mbledhësi, koleksionari													
BAGREM (sh.) ANEMBANË								KALLAJ AKTORI AMERIKAN, ELIOT (Semjuel)			ROBERT REDFORD REZE		
A								AMBCIIE, ZELL (sh.) QENI I HOLIVUDIT, RIN					
SHKOQ					MITRA, UTERUSI GAZ PËR NDRIÇIM						PËREMËR DËFTOR RUMANI		
AMPER		FILOZOFËT MBRETI I KUNGFU-së, BRUS											
KËNGËTARJA, FARA				EMPLOYER ID NUMBERS AKTORJA AM. TARNER									
NUMRI I LUDOLFIT			NJE TITULL ARISTOKRATESH Q.N.										
URAN		SHOERRA E DELES KËNGËTARJA SHAHINI											
QYTET NË FRANCE				UNIVERSITETI I TETOVËS GRUAJA E HUAN PERONIT									
Ë. NJ.			GJENDJA E LIRË E MOTORIT FIZIKANTI EVANXHELISTA							POLITIKANI SHQIPTAR, BAMIR			
PJESË E THEMRES (sh.)													
GAZ PA NGJYRË (shq.)								ZERO MAKINË PËR PËRPUNIM ME ANË TË SHTYPJES					
SOFTUER PËR KOMPRIIM TË DHËNAVE				TRANS PACIFIC PARTNERSHIP BANORE E PEJES									
IMPULS		KAMPIONI, ME I MIRI ALEKS FERGUSON						FIGURË NGA BIBLA (është dënuar me vdekje)	MALET E ULËTA KRYEJ	K	KOSH I MADH PËR MATJEN E DRITHIT (shq.)	AKTORJA ANGLEZE, LUPINO	L
LLOJ BIME MJEKESORE				ELEKTRON SHKRIMTARI BULLGAR, PELIN			INSTRUMENT MUZIKOR MJET NJEHSIMI ME GOGLA					URUGUAJ SHKALLA E ULËT E NOTËS 'E', E-MINOR	
KOHA E LIRË	VEPËR E S.G.J. VËREN, SHIKON												
SHUMËS		DRAMË E S.G.J. NOTË MUZIKORE											
FUTBOLLISTI I SHKENDIJËS, IZAIR						ANKONA SHKRONJA E PARË				REGJISORI SPELLING SUPERMEN			
PLUHURI QË MBETET PAS FLAKËS				FIGURË NGA BIBLA, BABAI I ENAKITËVE					STILOGRAF				



SUDOKU "killeri" | SUDOKU ">" | KENKEN | ARUKONE | NONOGRAM | TRANSFORMIMI | SUDOKU | SUDOKU "killeri"

SKANDI | KRIPTOGRAMI | DOMINOJA | DREJT. | MOZAIKU | GOLFI ENIGMATIK | MOSBARAZ. | PIKAT | LABIRINTI | MARGARIT. | PËR MË TË RINJTË | KAKURO | FJALËKRYQI KLASIK

16/11/2017



Landi CAKA

Kush ishin Templarët?

Themeluar në vitin 1118 nga aristokrati Hygo di Payns, në respekt të kërkesës së San Bernardo di Chiaravalle në përfundim të kryqëzatës së parë. Urdhri i Templarëve ishte i përbërë në fillim nga 11 murgj francezë të armatosur me shpata, të cilët kishin për detyrë të mbrojnë nga të pafetë pelegrinët që udhëtonin përgjatë rrugës së shenjtë nga Jaffa në Jeruzalem. Arabët i quanin Templarët, "djajtë e bardhë". Lindja e këtij urdhri duhet lidhur në sensin territorial dhe historik me Tokën e Shenjtë e cila ishte në qendër të luftërave ndërmjet forcave kristiane dhe atyre islamike pas kryqëzatës së parë, kur rrugët për në Tokën e Shenjtë ne vendin në të cilin besohej se kishte lindur në antikitet tempulli i Salomonit (nga i cili ka marrë emrin), u njoh nga Kisha në vitin 1129 dhe ne vazhdim iu njohën privilegje të mëdha.

MJEKËR DHE MUSTAQE

Kalorësit e parë ishin laike, por duke qenë të dëlirë, të bindur dhe të varfër, kjo i lejoi Urdhrit që të grumbullojë pasuri të pafundme, edhe si pasojë e transferimit të vlerave monetare nga dhe për në Tokën e Shenjtë. Një pjesë e mirë e këtyre pasurive u përdorën për ndërtimin e 9 mije kishave, pallateve dhe vendeve të fortifikuara.

Jetonin në bazë të rregullave të shumë të rrepta: ishin të detyruar të mbikëqyrnin festat e shpeshta fetare, të agjëronin sipas ritit kristian, të bënin bamirësi, të konsumonin ushqimin në qetësi duke dëgjuar një lexim biblik, të mbanin flokët e shkurtër, mjekër dhe mustaqe. Vishnin mantel të bardhë me një kryq të kuq në shpatullën e majtë dhe autoriteti i tyre madhor ishte Mjeshtri i Madh.

Influenca e Templarëve (në vitin 1147 numri i tyre ishte rreth 300, por shumë shpejt u bënë me mijëra) u përhap me shpejtësi në të gjithë Europën, dhe pasuria e tyre u rrit me ritme marra mendëse (ishin shumë pranë trashëgimisë së mbretërisë së Arragonës në Spanjë.) Perëndimi i



HISTORIA E MURGJVE TË FAMSHËM LUFTËTARË TË MESJETËS

këtij urdhëri filloi në vitin 1307: të akuzuar për sodomi, tradhti, lakmi dhe idhujtari, me qindra templarë u arrestuan, torturuan dhe dënuan në turrën e druve nga mbreti i Francës, Filipi i IV, mbasi i frikësuar nga pushteti i tyre, dhe në vitin 1312 Urdhëri u mbyll nga Këshilli i Vjenës.

LEGJENDAT RRETH TEMPLARËVE

Karakter i fortësisht mistik në Urdhër të Templarëve ishte vendndodhja e tij në Jeruzalem në malin Moriah, pikërisht në vendin ku kishte lindur tempulli i Salomonit. Pikërisht ky fakt, ka sjelle lulëzimin e shumë legjendave rreth Templarëve që edhe në ditët e sotme kanë shumë mbështetës të palëkundur. Një ndër legjendat është dhe marrja në posedim e Gralit të Shenjtë, si dhe të Arkës së Lidhjes, dhe kjo i ka dhënë atyre pushtetin e një qeverie okulte, mbi të gjitha qeveritë e tjera.

Legjenda, por me një bazë të mundshme vërtetësie: bazuar në shumicën e historianëve, pasuria e tyre i bëri te



plotfuqishëm dhe i nxori jashtë çdo kontrolli. Në një shekull, në vitet 1300, në kohën që shteti kërkonte të emancipohet nga Kisha, Templarët ishin një pengesë e rrezikshme për t'u kaluar.

KU KA PËRFUNDUAR THESARI I TEMPLARËVE?

Sipas disa të dhënave, Templarët vazhduan të prosperojnë në fshehtësi për vite me radhë si rojtari të pasurive të pafundme. Efektivisht, me anë të aktit Ad Providam të 2

majit 1312, që u pasua nga Këshilli i Vjenës, urdhëruan që pasuritë e Templarëve t'i kalonin Urdhrit Ospitalieri.

Në qoftë se në Francë mbreti i shkathët Filipi IV, pretendoi nga Kavalierët e Maltës, "si trashëgimtare" të Templarëve një dëmshpërblim ekonomik me të madh se ajo që kishin konfiskuar, edhe në vende të tjera të Europës shumë të fronëzuar reklamuan pjesën që i takonte nga pasuria e templarëve në domenet përkatëse.

Në Portugali, për

shembull, pasuritë e Templarëve përfunduan në Urdhër të Krishtit, e krijuar për luftuar Morët dhe me pasuritë e tyre financuan Flotën Detare e cila dy shekuj me pas do të garantonte mbretërisë luzitane një rol të dorës së parë në epokën e zbulimeve gjeografike.

E njëjta gjë ndodhi edhe në Spanjë, ku një strukturë ushtarake e krijuar për të përballuar rrezikun saracen, Urdhri Ushtarak i Nostra Signora di Montesa konfiskoi të mirat materiale dhe pro-

Kalorësit e parë ishin laike, por duke qenë të dëlirë, të bindur dhe të varfër, kjo i lejoi Urdhrit që të grumbullojë pasuri të pafundme, edhe si pasojë e transferimit të vlerave monetare nga dhe për në Tokën e Shenjtë. Një pjesë e mirë e këtyre pasurive u përdorën për ndërtimin e 9 mije kishave, pallateve dhe vendeve të fortifikuara

nat e Templarëve dhe një pjesë të kalorësve të tij. Në Gjermani pronat e Templarëve u ndanë ndërmjet Kalorësve Teutonike, ndërkohë që pronat e Urdhrit të Maltës, ish Templarë, u rrëmbyen në vitin 1500 nga Enriku VIII pas ndarjes me Romën. Një fat të njëjtit patën me Revolucionin pronat e mbetura në Francë.

THESARI I VËRTETË I TEMPLARËVE

Murgjit e famshëm, luftëtarët e Mesjetës karakterizoheshin nga një jetëgjatësi e veçantë, duke jetuar dy herë më shumë se pritsshmëritë e moshës në atë periudhë. Sekretet qëndronte tek mënyra e të ushqyerit, e cila bazohej në një dietë të ngjashme me dietën mesdhetare. Këtë version e mbështet Francesco Franceschi, drejtor i Repartit të Mjekësisë së Urgjencës në Policlinico Gemelli Romë.

Nga dokumentat e analizuara të studiuesve vjen informacioni se në jetën e përditshme Templarët ndiqnin rregulla të hekurta (dhe kjo dihej), duke filluar nga detyrimi për të larë duart para se të uleshin për të ngrënë deri tek një program i detajuar diete që parashikonte mish vetëm dy herë në javë. Në tavolinat e tyre me bollëk gjendeshin peshku, fruta e freskët dhe vaji i ullirit, frutat e detit me përmbajtjen e tyre Omega-3. Gjithashtu programoheshin tre pjata me bishtajore. Uji gjithmonë shtohej me lëng portokalli. Vera lejohej por e racionuar, e cila shoqërohej me tulin e aloe vera e cila është antispetike dhe fungicide. (atsh)



“Urdhri i Templarëve ishte i përbërë në fillim nga 11 murgj francezë të armatosur me shpata, të cilët kishin për detyrë të mbrojnë nga të pafetë pelegrinët që udhëtonin përgjatë rrugës së shenjtë nga Jaffa në Jeruzalem. Arabët i quanin Templarët, "djajtë e bardhë". Lindja e këtij urdhri duhet lidhur në sensin territorial dhe historik me Tokën e Shenjtë e cila ishte në qendër të luftërave ndërmjet forcave kristiane dhe atyre islamike pas kryqëzatës së parë, kur rrugët për në Tokën e Shenjtë ishin të rrezikuara nga grabitës dhe fanatikë islamike të cilët sulmonin dhe grabisnin pelegrinët.



Përgjatë vitit të kaluar, Malcolm Simmons, ka qenë objekt i disa hetimeve të pavarura në lidhje me disa pretendime të rënda kundër tij. Këto hetime janë duke u bërë nga një ekip, i cili është krijuar dhe që ndodhet në Bruksel

EULEX, misioni i korruptuar evropian

Misioni i EULEX-it në Kosovë merr sërish një goditje. Dorëhiqet kryetari i gjyqtarëve të misionit, duke hedhur akuza se "EULEX-i është një mision politik dhe jo mision që promovon shtetin ligjor"

Kryetari i gjyqtarëve të misionit EULEX, Malcolm Simmons, ka dhënë dorëheqjen nga pozita e tij, duke e akuzuar në të njëjtën kohë këtë mision për përfshirje në korupsion. Gjykatësi britanik Malcolm Simmons, në një intervistë për gazetën franceze "Le Monde", ka folur për keqfunksionim të madh në misionin e EULEX-it, i cili gjykon rastet më të rënda të korupsionit dhe disa raste për krime lufte në Kosovë. Gjykatësi Simmons, thotë se ai ka denoncuar shumë raste të korupsionit brenda misionit më të shtrenjtë të Bashkimit Evropian. "EULEX-i nuk është një mision që synon promovimin e shtetit ligjor. Është një mision politik. Kushdo që e mendon të kundërtën është ose naiv ose i marrë", citon Le Monde, gjykatësin Simmons, i cili thotë se "EULEX-i dëshiron ta rrezonte një pjesë të klasës politike kosovare". I menjëhershëm ka qenë reagimi i zyrës së shëfës së diplomacisë evropiane dhe i misionit EULEX në Kosovë. Zyrtarë të këtij misioni në një deklaratë për medie, thanë se ata janë duke hetuar pretendimet e gjykatësit britanik Simmons, i cili sipas tyre, është po ashtu nën hetime, për të njëjtat pre-



tendime të ngritura kundër tij. "Përgjatë vitit të kaluar, Malcolm Simmons, ka qenë objekt i disa hetimeve të pavarura në lidhje me disa pretendime të rënda kundër tij. Këto hetime janë duke u bërë nga një ekip, i cili është krijuar dhe që ndodhet në Bruksel, i kryesuar nga një ish-gjyqtar i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Këto pretendime janë në faza të ndryshme të hetimeve, kurse disa prej tyre janë dërguar në një Bord Disiplinor dhe tani janë në pritje të vendimit të këtij Bordi. Të tjerat janë në vijim e sipër", thuhet në deklaratën e misionit EULEX për hetimet kundër tashmë ish-gjyqtarit Simmons. "BE-ja dhe EULEX-i zbatojnë politikë të zero-tolerancës për sjellje të papërshtatshme dhe keq-qbërje, ndërsa të gjithë pjesëtarët e misionit janë përgjegjës për veprimet e tyre. Prandaj, të gjitha pretendimet e paraqitura së fundmi nga z. Simmons janë trajtuar me seriozitetin e njëjtë dhe po ashtu kanë rezultuar me hetime që janë në proces

dhe duke u zhvilluar në të njëjtën mënyrë sikur edhe ato kundër tij, do të thotë në përputhje me kornizën e aplikueshme, Kodin e Sjelljes dhe Disiplinës për Misionet civile të PPSM të miratuara nga Këshilli në qershor 2016. Nga z. Simmons është kërkuar që t'i paraqesë të gjitha provat që i posedon në mbështetje të pretendimeve të tij, por për fat të keq ai këtë nuk e ka bërë ende", thuhet më tej në reagimin e misionit EULEX. Ky mision thotë se nuk e paragjykon epilogun e hetimeve të tanishme dhe i mirëpret përfundimet e tyre, të cilat përshtatshëmrisht do të bëhen publike. Edhe në vitin 2015 një prokurorë e këtij misioni, Maria Bamieh, ngriti akuza për korupsion brenda misionit EULEX. Edhe për këtë rast një ekip i pavarur i hetuesve të BE-së zhvilloi hetime, por ato rezultuan pa ndonjë rezultat konkret. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të ligjit, EULEX, u vendos në Kosovë në vitin 2008 menjëherë pas shpalljes së pavarësisë. Baza

ligjore për funksionimin e këtij misioni është përcaktuar nga Këshilli i Ministrave të BE-së, me anë të veprimit të përbashkët të Bashkimit Evropian. Në bazë të kësaj, EULEX-i funksionon në kuadër të kornizës së përgjithshme të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. EULEX-Kosova është krijuar me synimin e përgjithshëm që t'i ndihmojë institucionet, organe gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit të Kosovës në zhvillimin e drejtësisë efektive të bazuar në sundimin e ligjit dhe të lirë nga ndikimet politike. Ky mision është misioni më i madh civil i themeluar në kuadër të Politikave të Përbashkëta për Siguri dhe Mbrojtje (CSDP) të Bashkimit Evropian. Ne qershor të vitit të ardhshëm misionit EULEX i skadon mandati, mirëpo qysh tash kanë nisur debatet dhe analizat brenda mekanizmave evropian dhe institucioneve të Kosovës, nëse duhet vazhduar mandati i këtij misioni edhe për dy vjet apo jo.

Kryetari i Parlamentit bullgar dha dorëheqje

Kryetari i Parlamentit të Bullgarisë, Dimitar Gllavçev dje dha dorëheqje. Me këtë hap Gllavçev dëshiron që të japë shembull për kthimin e parlamentarizmit. Partia Socialiste e Bullgarisë dhe Lëvizja për të Drejta dhe Liri dje kërkoi nga Gllavçev që ta braktisë funksionin, duke parashtruar 88 nënshkrime për shkarkimin e tij. Gjatë parashtrimit të kërkesës për dorëheqje, ata paralajmëruan se nuk do të marrin pjesë në punën e Parlamentit



derisa Gllavçev të mos largohet nga funksioni. Dorëheqja u kërkua pasi ai të mërkurën e nxori nga seanca kryetaren e PSB-së, Kornelia Ninova. Pritet që deputetët në Parlamentin e Bullgarisë sot të zgjedhin kryetar të ri.

Pakënaqësi me kriteret e BE-së

Pakënaqësitë në rritje të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës me qasjen e Bashkimit Evropian, nuk nënkuptojnë largimin nga përcaktimi për integrimin e Kosovës në BE, thonë deputetë dhe njohës të integritimeve. Vënia e ratiifikimit të Marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi si kusht të pazëvendësueshëm për heqjen e vizave, në Prishtinë vazhdon të shihet si një padrejtësi që i është bërë Prishtinës nga ana e Brukselit. Të premtën, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj pritet që të diskutojë me zyrtarët e lartë të BE-së, në Bruksel perspektivën evropiane të Kosovës, zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe çështjen e kushtëzimit të Demarkacionit dhe liberalizimit të vizave. Kryetarja e Komisionit parlamentar për Integritet Evropian, Blerita Deliu-Kodra, deputete e Partisë Demokratike të Kosovës, tha për Radion Evropa e Lirë se Kosova ka perspektivë evropiane dhe se procesi i integritimit në



Bashkimit Evropian, është një prej synimeve të institucioneve të vendit. "Mendoj që Kosova po kalon nëpër një proces dhe po ecë nëpër rrugë në të cilat shumë shtete kanë kaluar", tha Deliu-Kodra. Sipas saj, Bashkimi Evropian nuk do të lejojë që të ketë përsëritje të gabimeve që kanë ndodhur me shtetet e tjera. "Prandaj nuk e them që janë raporte të këqija me BE-në. Ne kemi takime të vazhdueshme, kemi konsultime të vazhdueshme nga të gjithë akterët politikë, por që fokusi duhet të jetë tek kryerja e obligimeve", tha Deliu-Kodra. Ajo tha po ashtu se Kosova e ka një agjendë të përcaktuar nga BE-ja dhe obligime duhet të përmbushen.

Holandë, mijëra shqiptarë të përfshirë në botën e krimit

Përafërsisht janë rreth 20 mijë shqiptarë që qëndrojnë për një periudhë relativisht të shkurtër në Holandë dhe vetëm 800 janë të regjistruar ligjërisht. Policia dhe drejtësia holandeze dyshojnë se shumë prej tyre kanë aktivite kriminale

Një numër i madh i shqiptarëve të paregjistruar në Holandë ka alarmuar autoritetet vendase për veprimtarinë e tyre të dyshimtë. Përafërsisht janë rreth 20 mijë shqiptarë që qëndrojnë për një periudhë relativisht të

shkurtër në Holandë dhe vetëm 800 janë të regjistruar ligjërisht. Policia dhe drejtësia holandeze dyshojnë se shumë prej tyre kanë aktivite kriminale. "Ekziston dyshimi se ata shumë shpejt po ngjiten në majat më të larta të krimit. Duket se shqiptarët janë më shumë se mesatarja e krimit aktiv në Amsterdam kohët e fundit, kështu që ne do të donim të dinim se sa janë këtu", ka thënë prokurori i Amsterdamit Maaïke van Kampen. Për të vërtetuar numrin e shqiptarëve që qëndrojnë në Holandë, gjatë verës një agjenci e specializuar monitoroi faqet shqiptare në inter-



net që klikohen nga territori i Holandës përmes smartphoneve dhe tabletëve. Rezultoi se me smartphone ekzistonin 35.953 vizitorë unikë dhe 4475 vizitorë nga tabletët. Këto shifra të larta janë ndoshta për shkak se një

shqiptar mund të ketë në përdorim më shumë se një smartphone. Kjo është arsyeja pse autoritetet holandeze kanë marrë për bazë shifrën 20 mijë shqiptarë dhe jo më shumë se 35 mijë. Edhe ministrja holandeze e

Drejtësisë, Justine Asbroek thotë se është shumë e dyshimtë veprimtaria e shqiptarëve në Holandë. "Nëse i krahasojmë këto shifra me 800 shqiptarë të regjistruar, ky është një numër shumë i madh. Shqiptarët që arrestohen këtu, pothuajse gjithmonë kanë një histori të paqartë rreth aktivitetit të tyre në Holandë. Dyshimi është se një pjesë e konsiderueshme është e përfshirë në botën e krimit", u shpreh ministrja Asbroek. "Rritja e shqiptarëve është shqetësuese. Në Mbretërinë e Bashkuar ata kontrollojnë 60% të tregut të kokainës dhe janë shumë të dhunshëm. Me anë të bashkëpunimit

intensiv midis policisë, gjyqësorit, autoriteteve tatimore dhe komunës së Amsterdamit, ne duam t'i parandalojmë ata që të ndërthuren me botën e krimit", shtoi prokurori van Kampen. Sipas autoriteteve holandeze, ka një bashkëpunim të ngushtë me homologët italianë për të identifikuar shqiptarët e përfshirë në aktivite kriminale në të dy shtetet. Theksojmë se sot u finalizua një operacion i përbashkët mes Italisë dhe Holandës, që çoi në arrestimin e 14 personave (6 prej tyre shqiptarë të cilët trafikonin drogë nga Holanda drejt Italisë, ndërsa qendër ishte Shqipëria.



A i nevojitet ndokujt një punëtor fushe? Po pres oferta, - thërret një tregtar. S'kalon shumë dhe një nigerian i dorëzohet një pronari të ri, i cili është i interesuar në blerjen e një njeriu të fortë për punë në fusha. Kjo skenë përsëritet përditë në Libi, pak kilometra nga deti Mesdhe, ku mijëra njerëz vdesin të mbytur gjatë përpjekjeve për të gjetur një jetë më të mirë në Evropë



Libi, aty ku emigrantët shiten sikurse delet

Në një kamp emigrantësh në Libi ku zhvillohet një anka ndi mirëfilltë për blerjen e emigrantëve, sikur në kohërat e tregtisë së skllervëve. Blerësit kërkojnë kryesisht djem të rinj, të fortë e të aftë për të punuar tokën. Dy të rinj shiten për 400 dollarë secili. Ishte rrjeti televiziv CNN që denoncoi shitjen e emigrantëve, të cilët janë në kërkim të një jete më të mirë në Evropë, larg masakrave dhe luftimeve në vendet e tyre, por që përfundojnë si objekt i skllavo-provarëve të rinj të shekullit të 21-të.

"A i nevojitet ndokujt një punëtor fushe? Po pres oferta, - thërret një tregtar. S'kalon shumë dhe një nigerian i dorëzohet një pronari të ri, i cili është i interesuar në blerjen e një njeriu të fortë për punë në fusha. Kjo skenë përsëritet përditë në Libi, pak kilometra nga deti Mesdhe, ku mijëra njerëz vdesin të mbytur gjatë përpjekjeve për të gjetur një jetë më të mirë në Evropë. Subjektet e shitura nuk flasin, janë të traumatizuar", thonë reporterët e CNN-it. Kontrollat në portet libiane vështirësojnë rrugën e emigrantëve, nga ana tjetër trafikantët kanë gjetur këtë zgjidhje për përfituar nga persona që kanë

udhëtuuar nga vende të tjera dhe nuk kanë mundur të nisen siç u ishte premtuar. Skllavërit kryejnë punë agrare të përditshme dhe shpërblimi i mbetet në dorë tregtarit, i cili kërkon edhe pagën e shpërgimit për prishje pakti. Shitjet shkojnë rreth 1200 dinarë libianë ose rreth 800 dollarë. Victory, një nigerian 21 vjeç, ka harxhuar të gjitha kursimet për t'u larguar dhe mbërritur në Evropë.

"Nëse i shihni njerëzit do të vini re shenjat, janë goditur, gjymtuar", thotë 21-vjeçari. Kushtet janë të këqija dhe mungon ushqimi dhe ka abuzime fizike. Ai na rrëfen se trafikantët u premtojnë të ndajnë fitimet bashkë, ata duhet të paguajnë borxhin, pavarësisht se nuk i çuan në Evropë, megjithatë paratë duket se nuk janë kurrë të mjaftueshme.

Ata shiten ditë pas dite. Kur arratisen ose çlirohen nga autoritetet - kthehen në pikën zero. Deportohen në vendin e origjinës, kanë humbur të gjitha kursimet dhe kanë jetuar një ferr. Kthehen në pikën nga ku u nisën për të ikur, me çantat bosh dhe nganjëherë me familje që ka kërkuar hua për të paguar lirimin

e tyre. "U ktheva në fillim. Është shumë e dhimbshme, shumë e dhimbshme! Unë nuk mbërrita në Evropë. Falënderoj Zotin për ata që ia dolën!", psherëtin Victory.

Përmes një investigimi, CNN zbuloi një rrjet të vërtetë të trafikut të qenieve njerëzore, madje edhe një prej personave që shite emigrantët. Në video duket trafikanti i njerëzve që shet një djalë që konsiderohet i fuqishëm, në gjendje për të gërmuar. Disa prej emigrantëve e pranojnë hapur përpara kamerave që janë shitur për një grusht parash tek persona që as nuk i njohin.

Ata rrëfejnë gjithashtu se janë dhunuar fizikisht. Situata e rëndë e emigrantëve në kampet libiane ka ngjallur reagimin e OKB-së, që kritikon ashpër BE për menaxhimin e fluksit dhe paktin me qeverinë libiane.

Trajtimi i emigrantëve në kampet e emigrantëve është çnjerëzor, vlerësoi OKB. Nuk vonoi reagimi i Brukselit që u shpreh se qëllimi kryesor i misionit në Libi është shpëtimi i jetëve, por duke nënvizuar se ekzistenca e kampeve që i përngajnë burgjeve është e paprueshme.



Edhe Bush plak kishte ngacmuar seksualisht një 16-vjeçare


Një grua ka akuzuar ish-presidentin amerikan George H.W. Bush se e kishte ngacmuar seksualisht kur ajo ishte vetëm 16-vjeçare. Roslyn Corrigan është gruaja e gjashtë që e akuzon Bushin për prekje ngacmuese. Ajo ka thënë për "Time Magazine" se ishte takuar me Bushin në një organizim të CIA-s në Teksas në vitin 2003, aty ku punonte edhe babai i saj.

"Reagimi im i parë ishte i tmerrshëm. Isha shumë, shumë e hutuar. Isha fëmijë", ka thënë ajo. Jim McGrath, përfaqësues i Bushit, ka thënë për BBC-në se presidenti i 41-

të amerikan, që dikur drejtonte edhe CIA-n, "kërkon fajle nëse ka ofenduar dikë ndonjëherë". Corrigan ka deklaruar se incidenti kishte ndodhur kur Bush po bënte fotografi me të dhe me mamanë e saj në zyrrat e CIA-s në Teksas, në nëntor të 2003-s. "Sapo ishim bërë gati për fotografimin e ai uli duart në prapnicën time dhe i shtypi ato, që vërehet edhe nga fytyra ime në këtë fotografi. "Reagimi im i parë ishte i tmerrshëm. Isha shumë, shumë e hutuar. Isha fëmijë", ka thënë ajo. "Nuk i thash asgjë. Çfarë do t'i thoshte një adoleshente një ish-presidenti". Bush në atë kohë ishte 79-vjeçar.

YouTube fshin 50 mijë video të Anwar al-Awlakit

Uebfaqja më e madhe në botë për video, YouTube, ka fshirë rreth 50 mijë video në të cilat paraqitej predikuesi radikal islamik amerikano-jemenas, Anwar al-Awlaki, që ishte vrarë në një sulm me dron më 2011. Awlaki ishte i njohur se përdorte dhunë kinse si detyrim religjioz, edhe pse pas vdekjes së tij, familja e tij kishte mohuar se ishte terrorist. Videot që kanë mbetur në YouTube janë dokumentare dhe raportime të tjera të mediave, raporton "New York Times". BBC ka mësuar se kjo fshirje është si rezultat i reagimit të



shoqërisë. Awlaki kishte postuar shumë lloje të videove në YouTube. Në disa prej tyre ai thërriste haptas për dhunë, por në të tjerat ai fliste për islam dhe historinë e tij.

Venezuela drejt fundit, inflacion pa tavan i bolivariit!

Sipas faqes "Dollar Today" që llogarit vlerën e dollarit me atë të bolivariit jashtë kursit të Bankës Qendrore të Venezuelës, një dollar blihet në tregun jozyrtar me 52.128 bolivare

Monedha bolivari e Venezuelës vazhdon rënien e saj të përshpejtuar përballë dollarit amerikan. Venezuelanëve i nevojiten 50.000 njësi të monedhës së tyre për të patur një dollar amerikan

në tregun e zi që rregullon aktivitetet tregtare të vendit. Sipas faqes "Dollar Today" që llogarit vlerën e dollarit me atë të bolivariit jashtë kursit të Bankës Qendrore të Venezuelës, një dollar blihet në tregun jozyrtar me 52.128 bolivare. Portali i konsideruar nga regjimi i Nikolas Maduro si një instrument lufte ekonomike kundër tij është i ndaluar në Venezuelë dhe i nxjerr të dhënat e llogaritjeve operacionale që kryhen në qytetin kolumbian të Kukutës, ku mijëra venezuelanë blejnë dhe kryejnë transaksione. Ky lloj tregu shërben si refer-



encë për miliona blerje dhe konsumatorë në mes të një inflacioni që e kalon shifrën 800% në vitin 2017. Kursi i tregut të zi e tejkalon 5000 herë vlerën

e kursit zyrtar të këmbimit dhe 15 herë vlerën referenciale të sistemit të ankandeve që autoritetet implementuan këtë vit, por që nuk punon ka disa

javë. Me këtë kuotizim rroga minimale prej 177.507 bolivare është më pas se 4 dollarë, ndërkohë që të ardhurat bazë (rrogë + bonus ushqimi shkon në 456.507 bolivare) janë më pak se 10 dollarë. Regjimi çavist ka monopolin e shitjeve të valutës së jashtme që nga 2003 dhe muajt e fundit ka shkurtuar hedhjen e monedhave të huaja për shkak të thellimit të krizës ekonomike dhe rënies së çmimit të naftës, burimi kryesor i financave. Kompanitë private dhe ndërmarrjet venezuelane ankojnë se nuk kanë marrë nga shteti mjaftueshëm

dollarë që u shërben atyre për importet, e blejnë në tregun e zi dhe rregullojnë çmimet sipas kursit të "Dollar Today." Kjo rrethanë ka shkaktuar një mungesë të ushqimeve dhe të produkteve bazë, të cilat kur gjenden shiten me çmime të ndaluara për pjesën më të madhe të venezuelanëve. Këtë të enjte Maduro njoftoi një plan për një veprim të menjëhershëm që do të konsistojë në inspektimin e më shumë se 11.000 dyqaneve për të luftuar kundër spekulimit dhe grumbullimit dhe për të kontrolluar çmimet e vendosura nga qeveria.



Francezët të çmendur pas Aliu të Tepelenës

Nga Napoleoni tek Hygoja...

Xherardo NIKJARI

1. Gjatë kohës kur Franca po fillonte të shfaqte ambicie ekspansioniste në brigjet e Adriatikut dhe Jonit, në letrat e ndryshme të Napoleonit me generalët francezë, ai shpreh opinionin se nuk mund të gjente njeri më të përshtatshëm për t'i besuar këto territore sesa Ali Pashës. Në 1806 Napoleoni kishte marrë një dhuratë nga Ali Pasha, një shpatë të cilën e kishte pranuar me kënaqësi.

Ja çfarë thotë në një letër Napoleoni për Ali Pashën:

“Nëse Korfuzi bie në duart e mia, nuk mund t'ia besoj tjetër njeriu më të mirë se Ali Pashës. Duhet që letra dhe instruksionet e mia të bëhen të tilla që të mos kuptohen qartë nëse bien në duart e agentëve.

Besoj se Ali Pasha shumë gjëra i bisedon dhe me Portën e Lartë... E mora letrën që më kishte nisur sekretari juaj dhe përmbytjen e kuptova.

U binda për miqësinë e tij; ju kam dhënë prova të veçanta të dashurisë sime, prandaj dua që ju të ndieni efektin. Do të urdhëroj gjeneralët e mi që të bien dakord me ju. Paqja është vendosur mes meje dhe perandorit të Rusisë, duke përfshirë këtu edhe Portën e Lartë. Do të pranoja gjithnjë me kënaqësi gjithçka që do të vinte nga ana juaj.”

Një vlerësim tjetër për Ali Pashën na vjen nga një francez, i magjepsur nga personaliteti i tij jo i zakonit.

2. Honore de Balzac (1799-1850), babai i realizmit i letërsisë europiane, do



të shkruante plot adhurim për këtë figurë të Orientit i cili ishte i vetmi që po ngrinte krye ndaj Portës së Lartë.

Honore de Balzac ishte një shkrimtar francez dhe autor i mbi 30 novelave dhe i 5 pjesëve teatrale, me kryeveprën “Komedia njerëzore”, ku janë përfshirë rreth 95 romane.

...Aliu deshte, që thoni ju, të më vinte në krye kudo, të më bënte bile edhe trashëgimtarin e vet. Po mua më kish ardhur në majë të hundës me atë jetë; sepse, në fund të fundit, Aliu i Tepelenës është në konflikt me Portën.

Prandaj edhe unë, e

Ali Pasha është një nga figurat më kontradiktore të shek. XIX. Ai u vlerësua nga Hygoi, Dumas etj. U quajt kolos, u quajt Napoleon i dytë, por në të njëjtën ishte një burrë i pamëshirshëm, një gjakatar në orientin që ishte në dekadencë

shihja me vend të merrja drejtimin për nga porta e të dilja jashtë. Për, hakun, ama, s'duhet t'ia hazotërisë së Tepelenës.

Se, në fakt, më dëndi me dhurata: diamante, sa të duash, 10.000 galera, 1.000 verdhushka, një greke të bukur për shërbëtore, një arnaut të vogël për shoqëri, dhe një kalë arab.

Eh, Ali Pasha i Janinës është njeri që hajt ta marrësh vesh! Duhet historian që të flasë për të. Vetëm në Orient, ka shpirta të tillë gur e shkruar gurit, që njëzet vjet të tëra bëjnë gjithçka për të vënë në vend një fyerje që u është bërë një ditë të bukur. Pale që

kishte mjekrën më të bukur borë të bardhë që s'është parë ndonjëherë, në atë fytyrë të ashpër dhe të sertë...”

3. Aleksandër Dumas (1802-1870) ishte romancier francez që admironte natyrën shqiptare dhe kulturën e saj. Ishte mjeshtër i përshkrimit të ngjarjeve historike që i vishte me ngjyra letrare. Shkroi veprën madhore “Krime të fshehta” në 3 vëllime, ku trajtohet me hollësi veprimtaria e Ali Pashë Tepelenës dhe natyra shqiptare.

Për Ali Pashë shkruan: Në kulmin e marrëdhënies së tij kishte qejf ta thoshte hapur se ishte pikërisht ajo e ëma, që e kishte qejf ta thoshte hapur se ishte pikërisht ajo e ëma që e kishte bërë të mbërrinte aty ku ndodhej.

“Gjithçka ia detyroj nënës sime, i thoshte ai një ditë konsullit të

Francës, sepse im atë, kur vdiq, nuk më la veçse një konak e disa ara. Mendja ime e ndezur nga këshillat e saj që më dha dy herë në jetë, sepse më bëri edhe njeri, edhe vezir, më zbuloi fshehtësinë e fatit që më priste.

Që atëherë Tepelena për mua nuk qe veçse trualli i lindjes, nga i cili duhej të lëmohesha për të rënë mbi prenë që e përpuñojë në kokë. Ëndërroja veç për fuqi, thesare, pallate, për gjithçka që koha ka krijuar e më premtonte sepse caku ku kam arritur nuk është fundi i shpresave të mia.”

4. Viktor Hygo (1802-1885) ishte shkrimtar francez, që renditet ndër më të mëdhenjtë në Francë, por edhe në mbarë botën. Shquhet, veçanërisht për kon-

tributin e rëndësishëm politik në krah të luftëtarëve francezë kundër Perandorisë së Dytë si mbrojtës i regjimit republikan.

Më 1829, boton vëllimin poetik “Orientalët” nga e cila po japim disa pjesë nga parathënia:

“Gjithë kontinenti po anon nga Orienti. Do të shohim gjëra të mëdha. Barbaria e vjetër aziatike ndoshta nuk është aq e zhevshur nga njerëz të mëdhenj sa ç'pandeh qytetërimi ynë.

Duhet rikujtuar se ajo prodhoi të vetmin kolos që ky shekull mundi të vërë ballë përballë Bonapartit, mjaft që edhe Bonaparti të kish parë silah; atë njeri gjeni, turk e tartar në të vërtetë, atë Ali Pashë që është për Napoleonin çka është tigri për luanin, skifteri për shqiponjën...”

5. Fransua Pukëvil (1770-1838) ishte mjek, diplomat, arkeolog e historian francez, ai botoi ditarin me titull: “Udhëtime në Epir, Kostandinopojë, Shqipëri dhe vise të tjera”.

Vepra e tij ka rëndësi për historinë e Shqipërisë, pasi atje ka mjaft përshkrime të jetuara për masakrat e Homovës, Shën Vasilit hde Kardhiqit.

I frymëzuar nga vepra e Pukëvilit, Aleksandër Dumas shkroi romanin “Konti i Montekristos” (vajza e supozua e Ali Pashës, Hajdeja, martohet me kontin).

Për Ali Pashën, Pukëvili shkruan: “Zhbirues i kujdesshëm, pyetjet i kishte gjithmonë tinëzare, kurse përgjigjet gjithë gjallëri dhe kurdoherë false, sado që në dukje të çiltra. Pretekstet i gatuate fët e fët, shkaku e vërtetë e vinte në lëvizje dhe e mbante të fshehur”.

Dhjetë librat që ndikuan në rrjedhën e historisë

Martin Puchner, autor i librit “Fjala e shkruar: Si i dha letërsia formën historisë së botës”, përzgjedh 10 librat, që ai beson se kanë pasur një ndikim të fortë në kursin e historisë botërore



EPI I GILGAMESHIT: Është teksti i parë i rëndësishëm në letërsinë botërore, dhe një shembull i përsosur i fuqisë së tregimeve të shkruara, për të formësuar historinë. Duke forcuar kohezionin kulturor në të gjithë rajonin, Epi ndihmoi në ruajtjen e perandorisë më të hershme territoriale.

BIBLA E EZRËS: Tekstet e shkruara u bënë gjithnjë e më të rëndësishme për jetën e hebren-

jve, gjatë mërgimit në Babiloni, vendi më i shkolluar mbi tokë në atë kohë. Kur shkruesi i quajtur Ezra i udhëhoqi pasuesit e tij përsëri në Jeruzalem, ai i mbante lart fletushkat e Torahut dhe u kërkonte mërgimtarëve të kthyer që të përkuleshin para tyre,

ashtu siç do të bënin para një perëndie. Ishte fillimi i shkrimit të shenjtë, që i dha jetë Judaizmit, Krishtëritit dhe Islamit. Që nga ajo kohë, ne kemi jetuar në një botë të formësuar prej teksteve të shenjta.

DIAMOND SUTRA: Di-

amond Sutra përkujton jetën e Budës duke portretizuar ndërveprimet e tij me nxënësit dhe zakonet e tij të përditshme, me hollësi të pazakonta. **PËRRALLA E GENJIT:** Kjo përrallë shumëbreznore, e shkruar nga një vajzë që pritej të bëhej

grua, në oborrin e Japonisë, është romani i parë i madh në letërsinë botërore, dhe ai zgjeroi tej mase aftësinë e letërsisë për të kapur emocione komplekse dhe ndërveprime delikate.

NJË MIJË E NJË NET: Koleksione tregimesh dhe përrallash ka patur nëpër botë që nga India në Greqi, por asnjë koleksion nuk u bë kaq popullor sa Një mijë e një netët, me Sheherezaden e famshme, motrën e saj dhe mbretin vrasës.

POPOL VUH: Është kulmi i letërsisë Maya, tradita e vetme letrare që u zhvillua pa kontakt me kontinentin e Euroazisë.

DEKLARATA E PAVARËSISË: Shkruar nga Thomas Jefferson dhe përmirësuar nga komiteti, Deklarata e Pavarësisë kombinon idetë e Iluminizmit me një histori ankesash dhe dobësis.

MANIFESTI KOMUNIST: Kur Marks dhe Engelsi shkruajtën “Manifestin Komunist” me porosi të një grupi të vogël revolucionarësh mërgimtarë me banim në Londër, ata e dinin se donin të ndryshonin botën. Ata thjesht nuk dinin nëse do të kishin sukses.

EPI I SUNJATËS: Legjendari Sunjata themeloi Perandorinë Mali gjatë Mesjetës së vonë, por epika që përkujtonte veprat e tij u transmetua gojarisht për qindra vjet, përpara se të shkruhej në shekullin e njëzetë.

REKUIEMI: Akhmatov e dinte që nuk do të lejohej të shkruante për jetën nën Stalinin, dhe se do të arrestehej, nëse një tekst i tillë do të gjendej në apartamentin e saj. Por këto rrethana nuk e penguan që të shkruante Rekuemin, poemën e gjatë për gulagët. (ata)



“Babai im (Legjenda e futbollit shqiptar Foto Strakosha) ishte heroi im, por idhulli im ishte gjithmonë Buffon, dhe jam dëshpëruar kur e kam parë atë në atë situatë, dhe mbi të gjitha Italia e ka merituar të shkojë tutje

Liga e parë, java e 16-të

Shkupi dhe Renova në “luftë” për pikë

Liga e parë futbollistike e Maqedonisë nuk ndalet, vetëm dy ditë pushim për t'u rikthyer sërish në fushë me kalendarin e javës së 16-të që afron ende pa u shuar jehona e takimeve në mesjavë. Do të luhen të dielën pesë përballje interesante, mes tyre spikat përballja mes dy ekipeve shqiptare FC Shkupi dhe Renova si dhe derbi i madh mes Vardarit dhe Pelisterit



Shkup, 17 nëntor – Gjithçka fillon me përballjen mes dy skuadrave shqiptare FC Shkupi dhe Renova. Skuadra tetovare në Çair vjen për tu rehabilituar nga disfata e thellë nga Vardari në mesjavë me 5-2, derisa bardhekalterit nuk e zhvilluan ndeshjen me “Skopjen” e cila u anulua pasi fusha ishte e mbuluar me ujë dhe nuk i plotësonte kushtet për lojë. Dhe kjo ndoshta do të jetë një përparësi për djemtë e trajnerit Ardian Nuhiu, të cilët janë më të pushuar për dallim prej futbollistëve të Renovës, të cilët luajtën ndeshjen me kampionin dhe lodhja mund të paraqet problem, duke marrë parasysh se ata nuk kanë pasur kohë për pushim. Ndryshe, tre pikët për të dyja skuadrat

janë më se të nevojshme, andaj dashamirët e futbollit pritet të shohin një ndeshje të mirë. “Synojmë tre pikët për tu ngjitur më lartë në tabelë. Jemi të përgatitur maksimalisht për këtë përballje dhe secili që do të luajë duhet të jep maksimumin për të realizuar cakun e dëshiruar. Ndeshja e anuluar me ‘Skopjen’ bëri që të jemi më të pushuar për dallim prej futbollistëve të Renovës, të cilët luajtën ndeshjen me Vardarin të enjten. Por, kjo nuk duhet të na mashtron ne, përkundrazi duhet të jemi të kujdesshëm. Apeloj deri të publiku sidomos tek ‘Shvercerat’ që të vijnë në numër sa më të madh dhe të në përkrahin në këtë sfidë mjaftë të rëndësishme për ne”, deklaroi për KOHA, mbrojtësi Se-

RENOVA AKUZUAR GJYQARËT PAS SFIDËS ME VARDARIN

“Skuadra e Renovës të enjten humbi me rezultat 2-5 nga Vardari, por sipas drejtuesve të kësaj skuadre, ndarja e drejtësisë nuk ka qenë njëlojë për të dyja skuadrat. “Rezultati mund t’ju mashtrroj, mirëpo jo edhe video-materialet. Vardari iu dha një penalti e pagënë në pjesën e parë, ndërsa Renovës nuk iu akorduan dy penalti në pjesën e dytë. Kjo e bëri dallimin në këtë ndeshje. Urime Vardarit për fitoren, por dyshojmë se rivali do të fitonte ashtu lehtë, nëse referët do të drejtonin takimin pa tendencë dhe të mos favorizonin dikë, në dëm të tjetrit. Mirëpo, kjo është drejtësia në futbollin e Maqedonisë”, thonë nga Renova.

dat Berisha. Në anën tjetër, kapiteni i KF Renova, Fisnik Nuhiu për gazetën KOHA thotë se në Shkup do të vijnë për të mos humbur ndeshjen, derisa pikët nga kjo përballje u nevojiten shumë. “Kemi nevojë shumë për pikë. Nuk jemi në situatë të mirë dhe nga kjo përballje siç thash duhet të marrim pikë në tre ndeshjet e fundit. E para është me Shkupin, ndeshje shumë e vështirë dhe në

një teren të vështirë. Shkupi ka ekip të mirë dhe gjithmonë është vështirë të merren pikë në Çair. Mirëpo, ne do të japim maksimumin që mos të pësojmë disfatë”, u shpreh Nuhiu. Ndryshe, skuadra tjetër tetovare Shkëndija, e cila është lider i pakontestueshëm në 15 xhirot e deritanishme, në Tetovë do të pret skuadrën e “Skopjes”, një autsajder total ku pikët nuk duhet të vi-

hen në diskutim për kuqezinjët. Nga radhët e kuqezinjve thonë se kjo ndeshje është më e rëndësishmja, pasi duan që të qëndrojnë besnik në përcaktimin e tyre, për të marrë takimet një nga një. “Ndeshja me ‘Skopjen’ për ne është më e rëndësishmja në këtë moment, pasi duam të qëndrojmë besnik në përcaktimin tonë për të marrë takimet një nga një. Prandaj gjithë vëmendja jonë tani është

Dyshet:	A.Pandev – Rabotnički
Pobeda – Sileksi	
Shkëndija – Skopje	
Shkupi – Renova	
Vardari – Pelisteri	

kah sfida me ‘Skopjen’, rival që ne do ta trajtojmë si gjithë tjerët në kampionat, pa marrë parasysh pozitën e tyre në renditje. Neve nuk na lejohen gabime nëse duam të arrijmë objektivat dhe për këtë arsye nuk guxojmë të nënçmojmë askënd, apo të hymë në ndonjë ndeshje më të relaksuar me pretendimin se do të jetë e lehtë dhe pikët do të vijnë vetë. Përkundrazi, takimi me ‘Skopjen’ për ne është derbi, do të hyjmë me përqendrim maksimal dhe me dëshirë për të bërë punën tonë në mënyrën më të mirë të mundshme. Besoj të jemi në nivel dhe të dalim me tre pikë nga ky duel për të vazhduar ecurinë pozitive në kampionat”, deklaroi për KOHA, mbrojtësi Mevlan Murati.

Dhe në fund, takimi që zgjon interesim të madh për dashamirët e futbollit është edhe përballja mes rivalëve të mëdhenj, Vardari dhe Pelisteri. Kjo ndeshje do të luhet në ora 18 e jo në ora 13, siç janë paraparë të zhvillohen përballjet tjera.



KB Shkupi kërkon fitoren e parë

Shkup, 17 nëntor – Skuadra e basketbollit Shkupi të shtunën me fillim prej orës 18:00 në sallën e sporteve “Shaban Tërstena” do të përballlet me “Karposh Sokoli”, ku do të jetë në kërkim të fitores së parë në Superligë, pasi deri më tani ata kanë pësuar gjashtë humbje nga po aq ndeshje të zhvilluara. Në postimin në rrjetin social “Facebook”, KB Shkupi fton dashamirët e basketbollit sidomos grupin e tifozëve “Shvercerat Shkup” që të vijnë dhe ti përkrahin ata në tentimin për të arritur fitoren e parë këtë sezon. “Takimin e radhës do ta luajmë kundër ‘KK Karposh Sokoli’ të shtunën në ora 18.00 në palestrën ‘Shaban Tërstena’ në Çair. Kjo është ndeshja jonë e dytë para tifozëve tanë, shpresojmë me përkrahjen tuaj, ‘Shvercerat Shkup’, do t’ia dalim ta shënojmë fitore”, kanë shkruar në faqen e tyre zyrtare në “Facebook” nga KB Shkupi.

Shkëndija nuk merr pjesë në “Kupën e Pavarësisë”

Shkup, 17 nëntor – Edhe pse u paralajmërua pjesëmarrja e KF Shkëndijës në kuadër të turneut “Pavarësia” i cili organizohet tradicionalisht nga Federata Shqiptare e Futbollit, në kuadër të festave të nëntorit, klubi kuqezi nuk do të marr pjesë. Një gjë të tillë e konfirmuan edhe nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun. “KF Shkëndija sërish ka qenë e nderuar për të qenë pjesë e ‘Kupës Pavarësia’ ku ne me kënaqësinë më të madhe kemi marrë pjesë vite me radhë. Mirëpo, kësaj radhe me keqardhje kemi njoftuar FSHF-në se këtë vit nuk do të mund të jemi pjesë e kësaj feste shkak i angazhimeve që kemi në kampionatin ven-



dor”, thonë nga klubi tetovar. “Përveç ekipit të parë, Shkëndija është lidere dhe garon për titull edhe në kategoritë e juniorëve dhe kadetëve dhe në kushte të tilla ku-

fizohemi të dërgojmë në Shqipëri qoftë edhe formacion të kombinuar apo ekipin e të rinjve. Derisa, para vetes kemi ndeshje të rëndësishme kampionale në të gjitha kate-

goritë dhe duke respektuar peshën e këtij turneu festiv që përket me pavarësinë e shtetit shqiptar jemi të detyruar kësaj radhe të anulojmë pjesëmarrjen. Urojmë turneu të shkojë si gjithmonë në mënyrën më të mirë, ndërsa në të ardhmen Shkëndija sërish të kthehet të luajë në këtë festë kombëtare”, thonë nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun të KF Shkëndija. Ndërkohë, pjesëmarrjen e deritanishme në këtë turne tradicionale e kanë konfirmuar KF Tirana, Besa e Pejës, Otranti nga Ulqini i Malit të Zi, ndërsa vendin e Shkëndijës me shumë gjasa do ta zë Liria e Prizrenit nga Superliga e Kosovës.

Shqipëria i jep pasaportën Donjetës



Donjeta Sadiku nuk do të ketë mundësinë që të paraqitet në Kampionatin Botëror që mbahet në Indi, pasi Qeveria e këtij vendi nuk e njeh pasaportën e Kosovës. Por, ajo në të ardhmen nuk do përballlet me probleme të tilla, pasi do pajiset me pasaportë shqiptare. Donjeta Sadiku dhe trajneri i saj Besim Brahimi, të shoqëruar nga drejtuesit e federatës kosovare të boksit të enjten kanë qëndruar në Tiranë, ku e

kanë kërkuar nënshkrimin e shqiptare, me vendim të Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Krejt kjo për shkak që sportistja e suksesshme kosovare të mos humbë gara tjera të rëndësishme që i ka para vetës, siç e humbi Botërorin, shëri i problemeve të udhëtimit, shkruan “Zëri.info”. Me pasaportë shqiptare ajo mund të udhëtojë pa probleme në shtete të ndryshme për ta përfaqësuar Kosovën në gara të mëdha ndërkombëtare.



Havier Hernandez i shpreh besnikërinë e tij ekipit të West Hemit. 29-vjeçari ka refuzuar ofertën e Çivas -Guadalajara. "Chicharito" deklaroi se nuk ka aspak ndërmend të largohet nga Premier Liga

Gabimin më të madh të karrierës e kam bërë tek Juventus

Karlo Ançeloti, trajneri i Italisë. Kjo është komunikata zyrtare që presin të gjithë italianët në orët ose ditët në vazhdim. Ventura është shkarkuar, Karlo Tavecchio nuk heq dorë nga presidenca e federatës dhe Karlo Ançeloti është kontaktuar për të kuptuar nëse do të ishte në dispozicion. Tani mungon vetëm zyrtarizimi për teknikun e ri, që duhet t'i hapë rrugë revolucionit që pritet të ndodhë me kombëtaren "axurre". Ndoshta është akoma pak për t'u konsideruar një revolucion i vërtetë, duke parë se, përveç Venturas, të gjithë të tjerët do të qëndrojnë aty ku ishin. Por, gjithsesi, kalimi i Ançelotit në drejtim të Italisë do të ishte një lëvizje e rëndësishme. Ai ka fituar kudo që ka shkuar dhe ka ditur të krijojë marrëdhënie të forta me të gjithë yjet që ka drejtuar. Më poshtë janë renditur 10 gjëra që duhet të dini për trajnerin italian:

Një fitues i lindur

Nëse si lojtar ka treguar cilësi dhe karakter në fushë, duke udhëhequr klubet ku ka luajtur dhe kombëtaren drejt fitoreve të shumta, cilësitë më të mira Ançeloti i ka treguar në rrugëtimin e tij si trajner. Është mes atyre që

kanë fituar më shumë, i vlerësuar në Itali dhe jashtë saj. Si trajner, ai ka fituar gjithçka: në Itali, Francë, Angli, Spanjë dhe Gjermani, duke siguruar 3 Çampions Liga me dy skuadra të ndryshme, Milan (2) dhe Real Madrid.

"X-factor"

Ançeloti është një trajner i shkëlqyer, por një këngëtar shumë i keq. Pavarësisht nga kjo, ai ka një pasion të madh për gjithçka që ka lidhje me muzikën. Këtë e tregojnë faktet, sepse në çdo moment të rëndësishëm të karrierës së tij, i ka shoqëruar triumfet me kolona zanore të kënduara me sa frymë kishte, pavarësisht stonimit: "I migliori anni della nostra vita" e Renato Zeros ka bërë menjëherë xhiron e internetit, ashtu si "Nel blu dipinto di blu", e kënduar një ditë pasi Çells kishte fituar Premier Ligë. Tani mund të ketë



ardhur momenti për të kënduar 'Azzurro'?

30 vite më pas

Ançeloti mund të kthehet te kombëtarja italiane 30 vite pas grumbullimit të tij të parë në një Botëror, pikërisht për t'i kthyer "axurrët" në Kupën e Botës. Ka qenë 1986-a dhe mesfushori Karlo Ançeloti (e ka mbyllur karrierën me Italinë me 26 ndeshje dhe 1 gol) është thirrur për Botërorin e Meksikës, por më pas ka qëndruar gjithmonë në tri-

bunë. Një aventurë aspak pozitive, si ajo e Itali '90. Botërori i luajtur në shtëpi është mbyllur në mënyrë zhgënjyese, me një vend të tretë.

Kthimi te të kaltrit

Kush mendon se kjo do të ishte aventura e parë e Karletto- në drejtim të Italisë, gabohet. Ai është ulur në atë stol dhe ka mbuluar rolin e ndihmëstrajnerit të Arrigo Sakit, trajneri që udhëhoqi Italinë deri në finalen e mallkuar të USA '94.

Ana e errët e stolit

Ançeloti konsiderohet me të drejtë një nga trajnerët më të mirë në botë. Por edhe ai ka një anë të errët, mbi të cilën duhet të punojë shumë. Është fitues, por për një kohë të shkurtër, me përjashtim të Milanit. Ka ndodhur tek Juventus, ku ka shkuar afër Çampions Ligë; e ka bërë edhe me Çellsin, për vetëm dy sezone; e njëjta gjë ka ndodhur edhe te PSZH, Real Madrid dhe Bajern Muni. Disa vite dhe më pas vjen shkarkimi ose prishja e dyanshme e kontratës. Gjithmonë pasi ka fituar, por pa vënë kurrë rrënjë.

Miku Stefano

Nuk janë të shumtë ata që e dinë për miqësinë e tij me Stefano Borgonovo (i ndarë nga jeta në 2013-ën për shkak të një sëmundje të pushueshme). Kanë qenë shumë të lidhur, Stefano dhe Karlo, që në sezonin 1989-90 kanë luajtur

bashkë me fanellën e Milanit. Edhe kur rrugët e tyre profesionale janë ndarë, dhe kur Borgonovo u sëmur, Ançeloti i ka qëndruar gjithmonë afër mikut dhe familjes.

Si Cristiano Ronaldo

Qarkullon edhe një anekdotë për periudhën kur ishte te Real Madrid. Jo vetëm këngë të stonuarra (si himni i klubit i kënduar me zë të lartë në "Bernabeu" për të festuar "Decima"-n, por edhe imitimi. Imitimi për festimin e Cristiano Ronaldo, gjatë ndeshjes Real Madrid-Eibar, më 22 nëntor të 2014-ës, ka qenë padyshim një nga momentet më argëtuese të aventurës spanjolle të Karlo Ançeloti.

Mësimet më të mira vijnë nga gabimet

Askush nuk është perfekt dhe as Karlo Ançeloti. Ka qenë vetë ai që e ka pranuar, duke ripërshkuar karrierën e tij si trajner, veçanërisht në fillim, me disa gabime të tepërta nga të cilat ka mësuar shumë: "Përmend dy gabime mbi të gjithë: të parin e kam bërë kur drejtoja Parman, ku refuzova Roberto Bagion. Ndërsa, tek Juventus nuk kam arritur të kuptoj se Anri nuk ishte një sulmues krahu".

Publicitet

PROAQUA
NPN PROAQUA

Në bazë të nenit 22 dhe 23 Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014), Rregullorja për organizim të punës dhe sistematizimit në vendet e punës dhe Pëlqimi i kryetarëve të komunave të Ohrit dhe Strugës, UD Drejtori i NPN Proaqua Strugë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për pranimin e punëtorëve në kohë të pacaktuar pune

NPN "Proaqua" - Strugë ka nevojë për :
1. Këshilltar për ekologji në NPN Proaqua Nj. P Kolektor

Dokumentacioni i nevojshëm:
- Lutje,
- Diplomë për shkollimin e kryer,
- Dokument identifikimi

Të dorëzohet në drejtori – Arkiv pranë NPN Proaqua Strugë, rr Kej 8 Nëntori p.n në afat prej 5 ditësh që nga shpallja në shtypin ditor.

NPN "Proaqua" – Strugë
17.11.2017

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E ZHELINËS

Në bazë të nenit 35 dhe 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e RM-së " nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15 31/16, 163/16) neni 50 pika 4 nga Ligji për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e RM-së " nr. 5/02) , neni 49 të Statutit të komunës së Zhelinës, Kryetari i komunës së Zhelinës sjell:

N J O F T I M

Për organizim të prezantimit Publik dhe anketës publike të „ Projektit arkitektonik-urbanistik për ndryshim dhe plotësim të planit urbanistik për fshatin Zhelinë për NP 23.3. me destinim B2-Njësi të mëdha tregtare do të kryhet me nxjerrjen në tabelën e shpalljeve të komunës së Zhelinës. Anketa publike do të zgjat 5 (pesë) ditë pune edhe atë prej 24. 11. 2017 deri 30. 11. 2017 v, ndërsa Prezantimi publik me prezantim profesional të planit do të mbahet në ditën 30. 11. 2017 vit (e Enjte) në ora 12.00 në hapësirat e komunës së Zhelinës (salla e madhe në katin e dytë)

Qytetarët e interesuar dhe personat juridik në afatin e paraparë, në fletat anketuese të përgatitura nga komuna e Zhelinës, do të mund t'i japin vërejtjet e tyre dhe në kohë t'i dorëzojnë në komunë.

Komuna e Zhelinës
Kryetar,
Sejdi Blerim

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Shpall

Kërkesë për dhënie të Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit nr. 2 në lokalitetin "Baza Ribnički Çeshmi Shtip" për nevojat e instalacionit për separim të rërës në Shtip, PK 11114, Komuna e Shtipit

Në pajtim me nenin 30 paragrafin 1 të Ligjit të Ujërave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar Kërkesë për dhënie të Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit, komuna e Shtipit për Beton Shtip, Vanço Përke nr. 119 me numër të arkivit nr. 11/5-763/2017.

Parashtruesi i kërkesës:
Beton Shtip
Vanço Përke nr. 119
2000 Shtip
Republika e Maqedonisë

Koordinatat e pusit sipas sistemit shtetëror koordinativ janë:
Pusi – 2 X=4 620 344 Y=7 597 047

Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail L.Dashi@moepp.gov.mk. Publiku i tanguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së kërkesës, ka të drejtë që të dorëzojë mendime dhe komente në formë të shkruar në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bul. "Goce Dellçev" nr. 18 ndërtesa e RTM (kati i 10), 1000 Shkup.

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 i Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore nr. 07-9992/2 të datës 05.06.2014, të sjellë nga MASH, SHF "Panajot Ginovski" publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për grumbullimin e ofertave

SHF "Panajot Ginovski" Butel, Shkup, rr. Ferid Bajram nr. 30, tel. 2621-416, organizon ekskursione dhe aktivitetet tjera të lira për nxënësit për vitin shkollor 2017/18 në pajtim me Programin për aktivitetet e theksuara edhe atë:

- piknik njëditor vjeshtor dhe pranveror për nxënësit prej klasës së I deri në të IX;
- ekskursion njëditor për nxënësit e klasës së III;
- mësim në natyrë për nxënësit e klasës së V;
- ekskursion shkencor dyditor për nxënësit e klasës së VI;
- ekskursion shkencor treditor për nxënësit e klasës së IX;
- transport për aktivitetet tjera të lira të nxënësve.

Kushtet minimale të cilat duhet t'i plotësojë ofertuesi janë:
-të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike.
- të ketë të realizuar në mënyrë të suksesshme së paku 3 ekskursione për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira në 3 vitet e fundit.
-të përmbushë kushtet për udhëtim të grupeve të nxënësve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilët udhëtojnë grupet e fëmijëve.

Kriteri për ndarje të marrëveshjes për realizim të ekskursioneve dhe aktivitetet tjera të lira është çmimi më i lirë. Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes, ofertuesi i zgjedhur parashtron garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursioneve dhe aktivitetet tjera të lira në shumë prej 5% e vlerës së marrëveshjes.

Ftohen ofertuesit e interesuar të parashtrorjnjë oferta sipas dokumentacionit i cili mund të merret në lokalet e shkollës çdo ditë pune prej ora 9,00 deri në ora 15.00.

Të gjithë ofertuesit e interesuar të parashtrorjnjë ofertë në origjinal, të nënshkruar dhe të vulosur nga ana e personit përgjegjës të ofertuesit me dokumentacion të bashkëngjitur të nënshkruar dhe të vërtetuar nga ana e organit kontraktues, në zarf të mbyllur me shenjë **MOS HAP** në këndin e epërm të djathtë, deri te komisioni për organizim të ekskursioneve për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira në adresën SHF "Panajot Ginovski" - Butel, Shkup, rr. "Ferid Bajram nr. 30 ose në arkivin e shkollës. Oferta e ofertuesit që nuk përmbushë kushtet minimale do të refuzohet nga ana e komisionit.

Shpallja zgjatet 5 (pesë) ditë pune. Ofertat të cilat do të arrijnë më vonë se termi i theksuar nuk do të merren parasysh.

SHF "Panajot Ginovski"
Komisioni për ekskursione për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira të nxënësve



Eliminimi më shkaktoi trishtim të madh. Unë kam lindur pas vitit 1958, hera e fundit që skuadra jonë kombëtare nuk arriti të kualifikohej për Kupën e Botës, kështu që nuk e dija se çfarë do të thoshte të mos isha atje. Tani mund të pranoj se ndihem surreal dhe shumë i trishtuar

Roberto Mançini nuk mendon për drejtimin e Italisë

Jam i lumtur te Zeniti

Unë nuk jam i befusuar që emri im është përmendur në listë, duke parë se ata diskutuan gjithashtu me kolegët me përvojë, që kanë fituar në vende të ndryshme. Por, unë jam i lumtur te Zeniti dhe në Shën Petersburg, kështu që nuk jam duke menduar për Kombëtaren

A mundet që Roberto Mançini të zëvendësojë Gian Piero Venturan, si trajner i Italisë? “Bosi” i Zenit këmbëngul se ai është i lumtur në Rusi. Ventura, 69-vjeç, u shkarkua nga Federata Italiane e Futbollit (FIGC), pasi Italia nuk u kualifikua dot për në fazën finale të Kupës së Botës për herë të parë që nga viti 1958. Ish-trajneri i Mançester Sitit dhe i Interit, Mançini, i cili bëri të vetin titullin në Seria A, duke fituar 36 ndeshje ndërkombëtare me Italinë, është shfaqur si një nga kandidatët për të mbushur boshllëkun, bashkë me ba-

shkatdhetarët Karlo Ançeloti, Fabio Kapello dhe Fabio Kanavaro. Megjithatë, 52-vjeçari nuk ka plane për ta lënë Zenit, ku ai mori përgjegjësinë si trajner në qershor. “Unë nuk jam i befusuar që emri im është përmendur në listë, duke parë se ata diskutuan gjithashtu me kolegët me përvojë, që kanë fituar në vende të ndryshme”, – tha Mançini për “Match TV”. – Por, unë jam i lumtur te Zeniti dhe në Shën Petersburg, kështu që nuk jam duke menduar për Kombëtaren. Objektivi im është të fitoj titullin e ligës ruse. Ashtu si shumë nga bashkatdhetarët e mi, unë ëndërrova ta shihja Italinë në Kupën e Botës, në Rusi. Eliminimi më shkaktoi trishtim të madh. Unë kam lindur pas vitit 1958, hera e fundit që skuadra jonë kombëtare nuk arriti të kualifikohej për Kupën e Botës, kështu që nuk e dija se çfarë do të thoshte të mos isha atje. Tani mund të pranoj se ndihem surreal dhe shumë i trishtuar”, tha Mançini. Për humbjen totale 1-0 të “play-off”-it kundër Suedisë, e cila fitoi ndeshjen e

parë dhe ruajti avantazhin minimal në Milano, Mançini tha: “Mendova se Kombëtarja ishte shumë e pafat, sidomos në ndeshjen e dytë, kur humbën shumë shanse, por futbollit është një sport shumë i çuditshëm. Ka ditë kur gjithçka shkon kundër jush dhe nuk mund të bëni asgjë për këtë. Prandaj, nuk do ta shohim Italinë në Rusi gjatë verës së ardhshme. Në të gjitha ekipet kombëtare duhet të ketë një zhvendosje të gjeneratave, Italia është padyshim në një moment të tillë, por mendoj se së shpejti do të kthehet të jetë lider në botën e futbollit, sepse vijnë shumë të rinj të talentuar”, përfundoi Mançini.



Akuzon ish-trajnerin dhe shokët e ekipit!

Sulmuesi brazilian Robinjo ka deklaruar se ai nuk donte të largohet nga Mançester Siti, duke fajësuar trajnerin Roberto Mançini për transferimin e tij në vitin 2010. Mark Hjus e mori Robinjon në vitin 2008 dhe ai pati një fillim të shkëlqyer në “Ettihad Stadium”, duke shënuar 12 gola në e muajt e parë. Gjithsesi, paraqitjet e tij njohën rënie, sepse gjërat nuk shkuan sipas planeve, kur Roberto Mançini mori drejtimin e ekipit. “Mançini nuk mori më të mirën nga unë”, – tha Robinjo. – Më duhet të shkoja në kombëtare dhe për këtë vendosa të rikthehem në Brazil. Mançini më caktoi disa detyra në fazën mbrojtëse, që më penalizuan në fushë. Ai më detyroi të largohesha, sepse unë dua të luaj i lirë”, u shpreh Robinjo. 33-vjeçari, i cili aktualisht luan për Atletiko Mineiro në Brazil, ka disa kujtime nga koha kur ishte në Mançester dhe i është përgjigjur zërave që e shohin si “djali i festave”. Ai tha: “Më pëlqente shumë Mançesteri, klubi i Sitit, restorante dhe pa harruar klubet e natës. Për mua u krijua imazhi i dikujt që i kishte qejf festat dhe faktikisht ato është. Por faktikisht them se te skuadra jonë kishte futbollistë anglezë që festonin më shumë se brazilianët. Xho Hart ishte gjithë kohës në festa, e njëjta gjë për Mikah Riçards. Edhe Shon Urajt-Filips dilte çdo natë. Por në momentin që dilnim në brazilianët, thuhej se kanë lindur për të festuar”, përfundoi Robinjo.

Murinjo pas David Luiz

Në dhomat e zhveshjes së Çellsit nuk ka atmosferë të mirë. Antonio Konte ka tashmë probleme në marrëdhënien me David Luiz. Diego Kosta dhe Matijç nuk u larguan nga klubi në mënyrën më të mirë, verën e këtij viti, ndaj duket se tani mund të jetë radha e brazilianit, siç është raportuar nga “Daily Star”. Dhe gazeta angleze bën me dije se së shpejti mund të materializohet një takim mes lojtarit dhe Hose Murinjo, trajnerit të Mançester Junajted.



Në këtë mënyrë, David Luiz do të kthehet nën urdhrat e portugezit, i cili ishte pikërisht trajneri në kulmin e dëshpërimit, kur lojtari u shit te

PSZH-ja. Mediat britanike paralajmërojnë, nga ana tjetër se Çellsit nuk do të pranonte kurrësi më pak para sesa ka paguar për ta marrë atë, pra 35 milionë euro. Takimi i ardhshëm i Çellsit është larg nga shtëpia, kundër Uest Bromviç Albion, në të cilin do të shihet nëse ka thirrje për David Luiz para një sfide të tillë të rëndësishme, apo jo. Kundër Mançester Junajtedit ishte një rast, ose një këputje mes lojtarit dhe trajnerit Konte.

Dele Alli në bisedime me menaxherin Mendes

Mesfushori i Totenhemit, Dele Alli, ka nisur bisedimet me supermenaxherin Jorge Mendes, i cili me shumë gjasa do të marrë përsipër përfaqësimin e lojtarit. Mendes konsiderohet si menaxheri më i fuqishëm i botës së futbollit dhe nën kujdesin e tij janë emra të tillë si Kristiano Ronaldo dhe Hoze Murinjo. 21-vjeçari Dele Alli duket se do të bëhet një nga futbollistët më të mirë të planetit dhe Mendes ka nisur të punojë për transferimin



e tij në elitën e futbollit evropian. Mësohet se familja e Dele Alli ka pasur një takim formal me

menaxherin Mendes, teksa ky i fundit mendon se lojtari i Totenhem do të vlejë më shumë se 100 milionë euro, në momentin që do të vendosë të largohet nga “White Hart Lane”. 51-vjeçari e ka kuptuar se në verën e ardhshme do të intensifikohet sulmet e ekipeve të mëdha për lojtarin. Totenhem do të preferonte më shumë transferimin në Spanjë dhe Mendes duket njeriu i duhur, prej kontakteve që ka me Realin dhe Barcelonën.

I hapur për të rinovuar me Sitin

Pep Guardiola, është i hapur për të rinovuar kontratën e tij me Mançester Sitin. Kjo është deklaruar nga anglezja “Daily Mail”, e cila informon se trajneri katalanas mund të shpenzojnë më shumë kohë në stolin e “qytetarëve” se në Muni apo edhe në Barcelonë. Guardiola aktualisht ka një kontratë me Mançester Sitin deri më 2019, ndërsa rinovimi do të kryhet për të paktën një vit më shumë. Një nga çelësat e negociatave



për kontratën e re do të jetë raporti i shkëlqyeshëm që ka

tekniku me drejtuesit e klubit, çka do t'i lehtësonte bisedimet pa u ngutur gjatë gjithë sezonit aktual. Rezultatet e mira dhe performanca e ekipit këtë sezon, si dhe reagimi pozitiv karshi metodave të Pep, e kanë inkurajuar atë të qëndrojë më shumë në Angli. Mançesteri tani është lider i Premier Ligës, me tetë pikë diferencë mbi vendin e dytë dhe e ka siguruar biletën për në fazat me eliminim direkt të Ligës së Kampionëve.

Presidenti i Monakos harron Mbappen

Fiton 450 milionë euro nga shitja e radhës

Dimitri Rybolovlev, presidenti i Monakos, ka një nuhatje të jashtëzakonshme për biznes. Pasi ka zbarkuar te Monako në 2013-ën, miliarderi rus ka shpenzuar 155 milionë euro për të marrë në ekip futbollistë, si Falkao, Hames dhe Mutinjo, por në vitet e fundit muzika ka ndryshuar, me klubin francez që ka vendosur të investojë te të rinjtë. Në fakt, kanë qenë të shumta

operacionet që kanë dërguar një mal me para në arkat e Monako, por ai i fundit nuk ka lidhje me klubin e Principatës. Sipërmarrësi rus ka nxjerrë në shitje “Svator Mundi” të Leonardo da Vinçit, pikturë që e ka blerë në 2013-ën për 127,5 milionë dollarë. Vepra e artit është

shitur në Nju Jork për shifrën rekord 450,3 milionë dollarë. Një goditje e madhe e realizuar nga Rybolovlev, i cili i ka dhënë vazhdimësi operacioneve të mira të mbyllura këtë verë, siç ka qenë edhe transferimi i Kylian Mbappe, i transferuar te Paris Sen-Zhermen me

formulën e huazimit, por me detyrimin për t'u blerë për 180 milionë euro në fund të sezonit. Nuk duhen harruar as operacionet Mendy, i blerë për 13 milionë euro, dhe Bernarndo Silva, i paguar rreth 16, të cilët kanë përfunduar te Mançester Siti i Guardiola-s për 107,5

milione euro në total. Bakajoko, i marrë nga Rennes për 8 milionë euro, i transferuar te Çellsit për 44,5. Më pas, shitjet e Germain dhe Allan Saint-Maksim te Marsej dhe Nica, kanë dërguar në arkat e klubit 18 milionë euro të tjerë.





Dua 7 fëmijë dhe po aq “Topa të Artë”

“Unë dua shtatë fëmijë dhe të njëjtin numër “Topash të Artë”. Kjo do të thotë se nuk kam ndërmend të ndalem këtu. Sa kohë që luaj, do t’i fitoj të gjitha, që mund të fitoj. Ëndrra ime është “Topi i Artë” i pestë, ndërsa vitin e ardhshëm do të ketë edhe një tjetër”, thotë Ronaldo



Kristiano Ronaldo thotë se dëshiron të ketë shtatë fëmijë dhe të fitojë të njëjtin numër “Topash të Artë”. Por, 32-vjeçari ende mbetet në fokusin e kritikave të fundit, pasi shënimi i një goli në shtatë ndeshje të La Liga-s për këtë sezon është shumë më poshtë rezultatit të tij të zakonshëm. Në një intervistë me “L’Equipe”, Ronaldo tha se po qëndron i qetë pas fillimit të ngadaltë të sezonit në kampionatin spanjoll, duke këmbëngulur se ai mund të kontribuojë më shumë për ekipin e tij sesa vetëm me golat. “Unë jam i lumtur dhe ndihem mirë. Duhet të qëndroj i qetë dhe të vazhdoj të punoj, sepse mund të bëj më mirë, – tha Ronaldo. – Ju shikoni tek mua një makinë golash, një djalë, i cili ka

“**Ëndrra ime është “Topi i Artë” i pestë, ndërsa vitin e ardhshëm do të ketë edhe një tjetër**”

për të shënuar gjatë gjithë kohës. Nëse ky nuk është rasti, të gjithë nuk kanë interes të dinë nëse kam luajtur mirë apo jo. Unë jam gjykuar vetëm për të shënuar, gjë që ndonjëherë nuk është gjithmonë më e rëndësishmja. Unë e pranoj kritikën, por nuk pajtohem. Prandaj, nuk i lexoj apo dëgjoj ato që thuhet për mua. Por, nuk kam zgjidhje tjetër, përveçse ta pranoj. Nuk mund ta kontrolloj botën”, shtoi më tej portugezi. Ronaldo është në një situatë shumë më të mirë në Ligën e Kampionëve, ku ka shënuar gjashtë herë në katër ndeshje në grupe. Megjithatë, Real Madridi momentalisht është i dyti në Grupin H, pas humbjes 3-1 ndaj Totenhemit, në ndeshjen e tyre të fundit, më 1 nëntor.

Përfundimi si i dytë në grupin e tij do të thoshte një ndeshje kundër një fituesi të grupeve të tjera në raundin e 1/16, që do të mund të nënkuptonte një balafaqim me PSG-në, ndoshta. Por, Ronaldo këmbëngul se si dy herë radhazi kampionët e Evropës, nuk kanë frikë nga asnjë kundërshtar i mundshëm: “Unë nuk kam frikë nga PSZH-ja, jemi dy herë radhazi kampionët e Evropës. Duhet ta respektojmë këtë. Ne do të preferonim ta përfundonim të parët në grup, por gjëja më e rëndësishme është para së gjithash kualifikimi”, shtoi më tej ai. Duke parë më përpara, ylli i Portugalisë tha se ende ka shumë më tepër, çka ai do të donte të arrinte, si në fushë, ashtu edhe jashtë saj: “Unë dua shtatë fëmijë dhe të njëjtin numër “Topash të Artë”. Kjo do të thotë se nuk kam ndërmend të ndalem këtu. Sa kohë që luaj, do t’i fitoj të gjitha, që mund të fitoj. Ëndrra ime është “Topi i Artë” i pestë, ndërsa vitin e ardhshëm do të ketë edhe një tjetër”, përfundoi Ronaldo.



Nejmar ndryshon shtëpi në Paris

Nejmar është dashur të shkojë në një shtëpi tjetër. Ai jetoi në Bougival, një qytet i qetë, me më pak se 9000 banorë, ku hyrje-daljet e e tij të shpeshta nuk i shqetësonin fqinjët. Në këtë rast, ka qenë e kundërta. Fqinjët e shqetësonin atë. Shtëpia luksoze ka 1000 metra katrorë sipërfaqe, plus bodrum, pishinë dhe një kopsht prej 5000 metrash katrorë, si dhe një mur rrethues 170 centimetra të lartë, nga i cili njerëzit nuk hezitonin të hidheshin për t’iu afruar lojtarit brazilian. “Le Parisien” publikon se arsyeja që lojtari i PSZH-së ka vendosur të ndryshojë shtëpinë e tij është pikërisht kjo. Ai nuk e ka gëzuar jetën private, pasi njerëzit do ta mësynin në shtëpinë e tij për të marrë fotografi, ose për të kërkuar autografe. Prej tani futbollisti do të jetojë në një zonë shumë më të sigurt të Parisit.



DASHI (20/III-20/IV)



Puna: Po tregoheni shumë i ngadaltë në punë. Kështu mund të humbisni shumë gjëra. **Shëndeti:** Në fund të javës mund të keni probleme të mëdha me shëndet andaj kujdes. **Dashuria:** Partneri/ja po pret hapat që ju do të merrni. Kështu veproni!

DEMI (21/IV-20/V)



Puna: Pavarësisht shëndetit, duhet që të veproni me përkushtim me punë. **Shëndeti:** Yjet ju sugjerojnë që të keni kujdes të shtuar nga gripi. **Dashuria:** Problemet financiare do mund t'ia kushtëzojnë një lidhje të re.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Puna: Fuqia e juaj për të vazhduar përpara nuk do ju përshtatet gjatë kësaj jave. **Shëndeti:** Konsumoni sa më shumë produkte natyrore. Largohuni nga mishrat! **Dashuria:** Do të gjendeni në një pozitë konfuze para partnerit/ës gjatë vikendit.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Puna: Jeni në dilemë! Të rri apo të largoheni nga puna. Në fund vendosni vet. **Shëndeti:** Po ndjeni një lodhje. Yjet ju sugjerojnë pushim. **Dashuria:** Gjatë vikendit do të kuptoni rëndësinë e partnerit/ës tuaj.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Puna: Frytet e punës tuaj nuk do t'i shihni në fundjavë. Ato do i shihni në fund të javës. **Shëndeti:** Në mes të javës mund të hasni në disa vështirësi me lukthin. **Dashuria:** Duhet të jeni më i dëgjueshëm, sidomos në aspektin sentimental.

VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Puna: Keni një mendje analitike, kështu që do të arrini suksese të mëdha në punë. **Shëndeti:** Këshillohuni me mjekun për çdo ndryshim në shëndetin tuaj. **Dashuria:** Yjet ju sugjerojnë që të merrni masa të shtuara për sferën tuaj sentimentale.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Puna: Fillimin e javës përkushtojani punës, pasi që kështu mund të pushoni më shumë. **Shëndeti:** Nuk po ushqeheni si duhet. Kjo mund të shkaktojë probleme për shëndetin tuaj. **Dashuria:** Kujdes me partnerin/ën, pasi që mund të hasni në disa keqkuptime që nuk keni hasur më parë.

AKREPI (22/X-21/XII)



Puna: Nuk mund të ndihmoni shumë të tjerët. Sidomos njerëzit të cilët nuk ju kanë ndihmuar. **Shëndeti:** Keni energji dhe imunitet të mjaftueshëm në këtë javë. Andaj mos u shqetësoni. **Dashuria:** Do të keni momente të mospajtimit me partnerin/ën. Për beqarët do këtë risi.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Puna: Ëndrrat e juaja më në fund mund të bëhen realitet. Por, duhet të punoni më shumë. **Shëndeti:** Mos u frikësoni pa nevojë edhe nëse keni ndonjë problem me shëndetin. **Dashuria:** Kalojeni një vikend duke shpenzuar para. Por, vetëm nëse këtë e bëni për dashurinë.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Puna: Fillimin e javës kushtojani shokëve tuaj. Kështu do ju mundësohet një punë e re. **Shëndeti:** Nëse nuk keni kujdes në mesjavë do mund të keni probleme me ftohjen. **Dashuria:** Duhet të bëni ndryshime, normalisht pozitive, në mënyrë tuaj të sjelljes me partnerin/ën.

UJORI (20/I-19/II)



Puna: Të gjithë po flasin për "bum"-in në karrierën tuaj. Vazhdoni me të njëjtin ritëm! **Shëndeti:** Këshillohuni me mjekun për çdo ndryshim në organizmin tuaj. **Dashuria:** Për beqarët do të jetë një javë përplot argëtim. Aventurat nuk do të ndalen.

PESHQIT (20/II-19/III)




Puna: Ka ardhur koha që të ndihmoni sa më shumë njerëzit që ju rrethojnë. **Shëndeti:** Po tregoheni shumë i ndjeshëm ndaj disa problemeve që ju rrethojnë. **Dashuria:** Dikush që ju adhuron do të fillojë të hyjë ngadalë në jetën tuaj...



Koha Koha	PARAJSA TOKËSORE (fig.) (spanj.)	MASAKËR E ORGANIZUAR	I. GJ.	SHOSHIT, SHOSH	FUTBOLLISTI TURK, BURUK	KËMBË TRIRROKË- SHE (let.) (Shq.)
PJESË E NJË FILMI SERIK						
SHKENCA QË STUDIOJ LIGJET E MENDIMIT						
DENI GLOVER			SHKOPI I BILARDOS ARI			
KOMPOZITORI GJERMAN, KARL				SIMBOLI I NITON-it USHQIMI KRYESOR I KINEZËVE		
ROLETË					ITALIA HERO LEGJENDAR I ATHINASVE TË VJETËR	
I PAMORAL- SHËM						
Koha Koha	KËNGËTARI YNË NGA FOTO	ISH BOKSIERI AMERIKAN, NORTON	VEESHJE E SIPËRME SI PELERINË MBET, NGEC	GJERMANIA SEKT I VEÇANTË FETAR I MUSLIMANËVE	KËNGËTARI, MARTIN BIMË E EGËR BARISHTORE	
ATROFI DHE SHKOLLITJE E SHITRESES GJEMBORE TË LEKURËS (mjek.)						MONOPOLI- ZIMI
ISH PORTIERI ITALIAN, VALTER				PJESË E SYRIT TRAJTIM I TEMAVE EROTIKE		
LEVERDIA					ENTONI KUIN ENË QË NXË NJË OKË	
ZET		JO E ROBERUAR KAPOTË ESKIMEZE			LIMAN NË JAPONI EMËR MASHKULLI	
PYLL			BUJTINË (vjet.) TRUP GJEOMETRIK (shq.)			POND KUBET NË LOJRAT E BIXHOZIT
SEND I VETËM				AJKA E QUMËSHITIT MURG BUDIST		
SHKRONJË GREKE (17)		I DIZAJNUAR PËR DOBISHMËRI AMERICAN OCEANIC AEROTRANS.				
BANOR I VENDEVE ARABE			DËMI, PRISHJA (vjet.) Z. A.			
MËSIMI MBI TAON				BAKËR NORVEGJIA		
SHKOVA			POROSIA E FUNDIT			

FJALËKRYO KLASIK



HORIZONTALISHT:

1. Vjedhës i gjërave të vogla, vjedhës xhepush; 5. Shkëmb i nënujshëm; 9. Trianëshe, trellojëshe; 12. Enë e drunjte si gotatë; 13. Shtet në Evropë; 14. Një kontinent (pashq.); 15. Mjeku i veshëve; 16. Toka e bukës; 17. Shkova; 18. Variant i fonemës, i kushtëzuar nga pozita (gjuh.); 21. Liman në Japoni; 23. Vigane; 25. Dhjetë (turq.); 26. E pjesërishtme, pjesore; 28. Rilindësi ynë, Frashëri; 29. Leverdia.

VERTIKALISHT:

1. Banor i brazilit; 2. Punë e regjisorit; 3. Birrë angleze; 4. Kalcium; 5. Izolim social; 6. Lumë në Rusi (shq.); 7. Malësori; 8. Lloj krokodili (shq.); 9. Lumë në Rusi; 10. Vigan; 11. Shenja ndërkombëtare për Ugandën; 15. Emër kodre, mali ose bjeshke; 16. Koha, vadia; 18. Adenozin-trifosfat (shkurt.); 19. Spango e trashë dhe e fortë; 20. Që ka ngjyrën e gjakut; 22. Nënë (turq.); 24. Xhez këngëtarja, Ficxherald; 27. Flori.

Djaloshi 10 muajsh që peshon gati 30 kg!

Djaloshi dhjetë muajsh Manuel Gonzales peshon sa mesatarja e një fëmije dhjetëvjeçarë, por prindërit dhe doktorët nuk po arrijnë të shpjegojnë misterin e peshës së tij. Nëna Isabel Pantoja, 24 vjeçare nga Colima e Meksikës, nuk ishte e brengosur për peshën e djalit në fillim, por ai tashmë ka kaluar Marion, vëllanë e tij trevjeçar. Familja foli për "DailyMail" ku tregoi stresin e tyre të përditshëm duke mos ditur se çfarë po ndodhë me djalin e tyre. Kur ai kishte lindur, ishte normal me 3.6 kilogramë, sikurse vëllai i madh, por pas vetëm pak kohe u kuptua se Luis ish-



te ndryshe. Ai pas dy muajsh peshoi dhjetë kilogramë dhe tani pas dhjetë muajsh është gati 30 duke çuditur mjekët. Doktorët kishin një teori në të cilën

shpjegohej se Luis mund të vuante nga Sindroma Prader-Willi, ku fëmija është vazhdimisht i uritur dhe ha shumë, megjithatë familja thotë se Luisi nuk

kërkon ushqim dhe han normal sikur moshatarët e tij. Familja tani është në pritje të një raporti nga Silvia Orozco, specialiste në të ushqyer, që ka marrë përsipër rastin. Ajo thotë se djaloshi mund të ndihmohet me injeksione të hormoneve. Sipas saj, problemi i Luisit mund të ishte shkaktuar si pasojë e ushqimeve të dobëta të nënës së tij gjatë shtatzënisë. Këto injeksione kush-tojnë rreth 551 dollarë, ndërsa babai i tij merr vetëm 197 dollarë në muaj. Familja tani ka hapur një faqe në Facebook ku kërkon ndihmë për trajtimin e Luisit.

Sa para kanë zviceranët?



Pasuria mesatare e një të rritur zviceran është 537.600 dollarë ose 528.000 franga, sipas Raportit Global të Pasurisë "Credit Suisse 2017", shkruan "swissinfo.ch". Zvicra vazhdon të kryesojë listën globale të "Credit Suisse" për pasuri për të rritur, e ndjekur nga Australia (402.600 dollarë), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (388.600

dollarë) dhe Zelanda e Re (337.400 dollarë), përcjell albinfo.ch. Që nga viti 2000, pasuria mesatare për të rritur në Zvicër është rritur 130 %, kryesisht për shkak të vlerësimit të frangut zviceran kundrejt dollarit amerikan midis vitit 2001 dhe 2013, thuhet në raportin e "Credit Suisse". Matur në franga zvicerane, pasuria

familjare në Zvicër është rritur 35% nga viti 2000 në 2017, duke përfaqësuar një normë mesatare vjetore rritjeje prej 1.8%. Zvicra u rendit e para edhe për pasurinë mesatare (229,000 dollarë për të rritur), e ndjekur nga Australia (195.400 dollarë). "Credit Suisse" ka bërë të ditur se mjetet financiare përbëjnë 54% të pasurisë bruto në Zvicër. Borxhet mesatare për një të rritur janë 140.500 dollarë, një nga nivelet më të larta absolute në botë. Mbi dy të tretat e të rriturve zviceranë kanë asete mbi 100.000 dollarë, dhe 8.8% e popullsisë prej 8.3 milionë janë milionerë. "Credit Suisse" vlerëson se 2780 banorë zviceranë kanë një pasuri prej 50 milionë dollarë e më lart, dhe 1070 kanë më shumë se 100 milionë dollarë.

Gratë menaxhojnë më mirë se burrat

Gjinia femërore e menaxhon në mënyrë më racionale buxhetin familjar. Kjo pasi gratë blejnë vetëm gjërat e nevojshme për shtëpi dhe ushqimet e përzgjedhura nga gratë dallojnë shumë nga blerjet e meshkujve. Kështu thotë një hulumtim i Institutit GAP. Hulumtimi nuk e përjashton mundësinë që gratë edhe mund të shpenzojnë më tepër se sa burrat, por për dallim prej



tyre, fokusohen në blerjen e produkteve që janë në dobi të familjes. Por, megjithatë, gratë thonë se me pagat e ulëta në Kosovë nuk është lehtë të menaxhohet buxheti familjar. Ndërsa, burrat janë më të rezervuar të tregojnë se çfarë atyre u kujtohet të kenë blerë më shpesh për shtëpinë. Sidoqoftë, e pranojnë se i blejnë gjërat për të cilat u thotë gruaja.

Harron ku kishte parkuar makinën, e gjen atë 20 vjet më vonë

Në vitin 1997, në qytetin gjerman të Frankfurtit, një burrë raportoi në polici se i kishin vjedhur makinën. Njëzet vjet më vonë, autoritetet kanë rënë në gjurmët e makinës së humbur. Ata zbuluan se makinën nuk ia kishte vjedhur njeri, por i zoti i saj thjesht kishte harruar ku e kishte parkuar. Sipas "The Independent" mjeti u gjet në një garazh në një ndërtesë



të vjetër industriale që pritet të shkatërrohet. Makina ishte drejt shkatërrimit kështu që u raportua në polici, e cila më pas hetoi se kush ishte pronari. Sipas gazetës rajonale gjermane "Augsberger Allgemein", burri, tani 76-vjeç, ishte drejtuar për në polici me vajzën e tij për të rimarrë makinën. Për fat të keq makina nuk ishte më funksionale.

KALENDARI HISTORIK 18 NËNTOR

- 326 - Bazilika e vjetër e Shën Pjetrit shpallet e shenjtë.
- 1307 - William Tell gjuan mollën mbi kokën e djalit të vet.
- 1494 - Mbreti francez Charl VIII okupon Firencën.
- 1497 - Vasko de Gama arrin në Kepin e Shpresës së Mirë.
- 1626 - Bazilika e Shën Pjetrit shpallet e shenjtë.
- 1738 - Franca dhe Austria nënshkruajnë marrëveshje të paqes.
- 1742 - Prusia dhe Anglia nënshkruajnë marrëveshje ushtarake kundër Francës.
- 1793 - Zyrtarisht hapet Luvri në Paris.
- 1803 - Beteja e Vertieres: Ushtria e Haitit mund francezët.
- 1820 - Zbulohet Antarktika nga Kapiteni amerikan Nathaniel B Palmer.
- 1833 - Holanda dhe Belgjika nënshkruajnë Traktatin e Zonhovenit.
- 1918 - Latvia shpall pavarësinë nga Rusia.
- 1936 - Gjermania dhe Italia njohin qeverinë e Françesko Frankos në Spanjë.
- 1956 - Maroku fiton pavarësinë.
- 1957 - Tunizia refuzon armët ruse.
- 1970 - Holanda dhe Shqipëria ndërtojnë marrëdhënie diplomatike.

A E DINI SE...



Në vitin 2015 në Zvicër kanë vdekur gjithsej 67.606 veta, që është për 6 për qind më shumë se në vitin paraprak. Gripi në fillim të vitit, vaka e vapës në korrik dhe rritja e numrit të të moshuarve, janë sipas Zyrës Federale për Statistikë, faktorët kryesorë. Vala e gripit në fillim të vitit kishte shkaktuar vdekjen e 2500 vetave ndërsa vaka e madhe që ka mbretëruar në korrikun e vitit 2015, u ka marrë jetën 500 personave më shumë se që vdesin në një korrik "të zakonshëm". Proporcionalisht me këto, shkalla e vdekshmërisë dhe vitet potenciale të humbura kanë shënuar rritje ndërsa moshën mesatare e llogaritur nga lindja ka shënuar përkohësisht rënie



BARSOLETA



ANALIZAT E GJAKUT

Dy fëmijë janë ulur në sallën e pritjes të një laboratorit në pritje për të bërë analizat. Një nga dy fëmijët qan me të madhe.

Pse qan? - e pyet tjetri

Sepse duhet të bëj analizat e gjakut, dhe do më shpajnë me një gjilpërë në gisht. Ma ka thënë vëllai im më i madh!

Në atë moment edhe fëmija tjetër fillon të qajë!

Po ti pse qan? - pyet tjetri!

Sepse duhet të bëj analizën e urinës!

THËNIA E DITËS

Nuk kam nevojë për një mik që ndryshon kur unë ndryshoj, dhe pohon me kokë kur unë pohoj me kokë. Hija ime e bën shumë më mirë këtë gjë! (Plutarku)

